NË KËTË NUMËR LEXONI


4 Intervistë me Bejtullah Destanin


10 Xhamia e Ibrit pret...


22 Shkolla Mevlevite


29 Janusi qindfytyrësh


35 Si ta organizosh ditën tënde

Lajme 2

Milazim Krasniqi: Ledhatimi i ariut 3

Intevistë me Bejtullah Destanin 4-6

Besim R. Cengu: Ese për mitet dhe "idhujt pa krena" 7

Avni Avdiu: Maqedonia dhe politika e saj e konfliktit 8-9

Florije Ademi: Xhamia e Ibrit pret vendimet politike 10-11

Sead Ujkani & Arber Zeka: Londra "kryeqytet" i botës 12

Fitim Veliu: Përdorimi i alkoolit...shqetëson BE-në 13

Lulzim Ahmeti: Pallati i shtypit përmendore e dështimit të autoriteteve 14-15

Emine A. Vezaj: Dialogu ndërfetar te shqiptarët 16-17

Demir Reshiti: Përfundojnë pa sukses edhe negociatat shtesë ... 18-19

Osman D. Gashi: Përdhunimi i shqipes në mbishkrime 20-21

Feti Mehdiu: Shkolla filozofike islame Mevlevije 22-23

Muhamed Jusufi–Kajolli: Paqja favorizon myslimanët ... 24-25

Mehmet Shkëmbi: Haxhi ligj i Krijuesit të botëve 26-27

Rexhep Suma: Kurbani - mjet që të afron me Zotin 28

Agron Tufa: Janusi qindfytyrësh 29

Flamur Maloku: Diskurs për tokën e braktisur 30-31

Poezi 32

Lajme nga kultura 33

Elda Cenalia: Si ta organizosh ditën tënde të punës 34

Ali Iljazi: Shpjegimi i ëndrrave... 35-36

Florentina Lata: Homoseksualizmi - çrregullim... 37

Artan Bejta & Iliriana Alloqi: Kariesi 38-39

Fjalëkryqi 40

REDAKSIA E REVISTËS "PAQJA", TË GJITHË LEXUESVE UA URON FESTËN E KURBAN BAJRAMIT DHE NDËRRIMIN E MOTMOTEVE



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË

Viti II / Nr. 13
19 Dhjetor 2007

Botues



O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor
Muhamed Jusufi - KAJOLLI
kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës
Demir RESHITI
demireshiti@hotmail.com

Redaktor gjuhësor
Flamur MALOKU
flamurmaloku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika
Osman D. GASHI
osmangashi@msn.com

Anëtarët e redakisisë:
Arber ZEKA
Gëzim QERIMI
Lulzim AHMETI
Mergim LUSHTAKU
Sead UJKANI
Shkelzen NUZA

e-mail:
revistapaqja@gmail.com
revistapaqja@yahoo.com
revistapaqja@hotmail.com

Adresa:
Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14, përballë teatrit Dodona, Prishtinë, Kosovë

ZGJEDHJET E 17 NËNTORIT E NXJERRIN FITUESE PDK-NË

Zgjedhjet e 17 nëntorit të organizuara në të dy nivelet dhe për kryetar komunash, kanë nxjerr fituese Partinë Demokratike të Kosovës (PDK), e cila në legjislaturën e ardhshme, do të përfaqësohet me 37 deputetë. E dyta për nga numri i vendeve të fituara është radhitur Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 25, e pasuar nga Aleanca Kosova e Re (AKR) me 13 deputetë, Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD) me 11 dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me 10. Ndërsa partia reformiste ORA me 4.1 % të votave të fituara, nuk ka arritur të kalojë pragun zgjedhor.
Partitë politike që përfaqësojnë komunitetet pakicë do t'i kenë 24 ulëse në Kuvendin e ri të Kosovës. Prej tyre, partitë politike të serbëve do t'i kenë gjithsej 10 ulëse, aq sa i kanë të rezervuara me Kornizë Kushtetuese, kurse pakicat tjera do t'i kenë 14 ulëse, meqë disa nga partitë e tyre kanë fituar ulëse shtesë nga ato që i kishin të rezervuara.
Zyrtarët e Komisioni Qendror të Zgjedhjeve kanë njoftuar se në zgjedhjet e 17 nëntorit të drejtën e votës e kanë ushtruar 628, 630 qytetarë ose 42.8 % e trupit elektoral. Nga ky numër rreth 34 mijë vota janë shpallur të pavlefshme.

Lista e deputetëve të rinj në Kuvendin e Kosovës

Deputetë nga radhët e PDK-së do të jenë:
Hashim Thaçi, Fatmir Limaj, Jakup Krasniqi, Enver Hoxhaj, Bajram Rexhepi, Hajredin Kuçi, Flora Brovina, Edita Tahiri, Vlora Çitaku, Rrustem Mustafa, Xhavit Haliti, Ramë Buja, Naim Rrustemi, Nait Hasani, Bajrush Xhemajli, Memli Krasniqi, Arsim Bajrami, Fehmi Mujota, Emrush Xhemajli, Gani Koci, Gani Buçinca, Berat Luzha, Zafir Berisha, Adem Grabovci, Ramadan Avdiu, Hajdin Abazi, Hydajet Hyseni, Teuta Hadri, Bahri Hyseni, Kaqusha Jashari, Sala Berisha – Shala, Safete Hadërgjonaj, Selvie Halimi, Nerxhivane Dauti, Drita Kadriu, Elheme Hetemi dhe Mimoza Ahmetaj.
LDK-në në përbërjen e re të Kuvendit do ta përfaqësojnë deputetët:
Fatmir Sejdiu, Sabri Hamiti, Nekibe Kelmendi, Eqrem Kryeziu, Lutfi Haziri, Alush Gashi, Kolë Berisha, Melihate Tërmkolli, Ismet Beqiri, Agim Veliu, Ali Lajçi, Haki Shatri, Skënder Hyseni, Bujar Bukoshi, Sanije Aliaj, Ramë Manaj, Zefë Morina, Fatmir Rexhepi, Naser Osmani, Adem Hajdaraj, Luljeta Shehu, Fatmire Berisha, Myrvete Pantina, Nurishahe Hulaj, Anita Morina.
AKR-ja do të përfaqësohet nga:
Behgjet Pacolli, Ibrahim Makolli, Ibrahim Gashi, Rita Hajzeraj, Riza Smaka, Driton Tali, Arsim Rexhepi, Njomza Emini, Suzan Novobrdaliu, Esat Brajshori, Heset Cakolli, Shkumbin Demaliaj dhe Myzejene Selmani.
Ndërsa koalicioni LDD-PSHDK do të përfaqësohet nga:
Nexhat Daci, Besa Gaxherri, Mark Krasniqi, Gani Geci, Berim Ramosaj, Naser Rugova, Lulzim Zeneli, Adem Salihaj, Synavere Rysha, Drita Maliqi dhe Qamile Morina.
Dhjetë deputetët e AAK-së janë:
Ramush Haradinaj, Ahmet Isufi, Naim Maloku, Bajram Kosumi, Ibrahim Selmanaj, Rasim Selmanaj, Ardian Gjini, Gjylnaze Syla, Donika Kadaj, Zylfije Hundozi
Nga partitë e minoriteteve joserbe, tri janë përfaqësuar nga tre deputetë: **KDTP-ja** (Enis Kervan, Mahir Jagxhilar, Mufera Shinik), **VAKAT**-i (Xhezair Murati, Sadik Idrizi, Shpresa Murati) dhe **PDAK**-ja (Sabit Rrahmani, Etem Arifi, Hafize Hajdini). **Partia e Aksionit Demokratik** (SDA) do të përfaqësohet nga Numan Baliqi dhe Vezira Emrushi; **PREBK**-ja nga Zylfi Merxha, **Iniciativa Qytetare Gorane** (GIG) nga Mursel Halili, dhe **IRDK**-ja nga Xhevdet Neziraj.
Nga Partitë serbe që kanë konkurruar në këto zgjedhje, dy prej tyre i kanë siguruar nga tri vende: **SDSKIM** (Vladimir Todoroviq, Slavisha Petkoviq, Radmila Vujoviq) dhe **SLS** (Bojan Stojanoviq, Slobodan Petroviq, Kosara Nikoliq), ndërsa dy të tjera do të përfaqësohen me nga 1 deputet **Dragan Dimiq** (SNSDKIM) dhe **Mihailo Sçepanoviq** (SNS).

PDK-ja më e suksesshme edhe në zgjedhjet lokale dhe për kryetar komunash

Partia Demokratike e Kosovës në këto zgjedhje ka qenë më e suksesshme edhe në nivel lokal, duke fituar në shumicën e komunave të Kosovës.
Kjo parti gjithashtu ka dalë fituese edhe në zgjedhjet për kryetarë të komunave.
Në balotazhin i cili është zhvilluar më 8 dhjetor në 23 komuna të Kosovës, PDK-ja ka fituar 14 komuna, LDK-ja 6, ndërsa AAK-ja 3 komuna.

Fituesit e balotazhit të mbajtur më 8 dhjetor:

Deçan: Musa Berisha AAK
Gjakovë: Pal Lekaj AAK
Gjilan: Qemal Mustafa PDK
Sharr: Salim Jenuzi PDK
Burim: Fadil Ferati LDK
Kaçanik: Xhabir Zharku PDK
Klinë: Sokol Bashota PDK
Fushë Kosovë: Burim Berisha LDK
Dardanë: Begzad Sinani PDK
Mitrovicë: Bajram Rexhepi PDK
Lipjan: Shukri Buja PDK
Kastriot: Rexhep Kelani LDK
Rahovec: Qazim Qeska PDK
Pejë: Ali Berisha AAK
Besianë: Ilaz Pireva LDK
Prishtinë: Isa Mustafa LDK
Prizren: Ramadan Muja PDK
Shtime: Naim Ismajli PDK
Therandë: Sali Asllanaj LDK
Ferizaj: Bajrush Xhemajli
Viti: Nexhmedin Arifi PDK
Vushtrri: Bajram Mulaku PDK
Malishevë: Isni Kilaj PDK
Drenas: Nexhat Demaku PDK
Skenderaj: Sami Lushtaku PDK
Kryetarët e komunave Albanik, Zubin Potok, Novobërdë dhe Shtërpcë, i ka emëruar shefi i UNMIK-ut, Joachim Ruecker.

Ana tjetër e medaljes

Ledhatimi i ariut



Milazim KRASNIQI

Data 10 dhjetor shënoi fundin e negociatave shtesë për statusin e Kosovës, po edhe fillimin e një koordinimi më serioz të qëndrimit të shteteve të Bashkimit Evropian për të ardhmen e saj. Ç'është e vërteta, negociatat shtesë edhe janë organizuar për të blerë kohë pikërisht, Bashkimi Evropian, sepse pas dorëzimit të planit të Marti Ahtisarit dhe rekomandimit të tij për një pavarësi të mbikëqyrur për Kosovën, në këtë organizatë pati mospajtime të dukshme. Zhurmën më të madhe e bënë disa shtete të pranuara rishtas në Bashkimin Evropian, si Qiproja, Rumania e Sllovakia, duke treguar sheshazi se ato vetë nuk kanë qenë të përgatitura për të marrë përgjegjësi serioze në një kontekst Evropian. Mirëpo, diversionin më të madh u përpoq ta luante Rusia, e cila, me çështjen e Kosovës, bëri përpjekjeje të mëdha që ta përçante Bashkimin Evropian, ta rikthente Ballkanin në një skenë jostabiliteti e konflikti, për ta mbajtur pastaj të gozhduar NATO-n në këto hapësira. Në tërë këto lojë gjeopolitike ruse, Serbia u përdor dhe po përdoret ende, si një figurë shahu, e cila në një moment edhe mund të sakrifikohet, për një pozicion më të mirë taktik. Serbia e ka pranuar dhe po e luan edhe më tutje këtë rol, ngaqë ideologjia mbizotëruese në atë vend është nacionalizmi irracional, i cili në rastin serb e ka një shtresë të theksuar antiperëndimore.

Edhe pse në këtë kontekst mjaft të komplikuar, takimi i 10 dhjetorit i ministrave të Jashtëm të shteteve të Bashkimit Evropian, konfirmoi se kjo organizatë tashmë pothuajse e ka miratuar një qëndrim unik lidhur me pranimin e pavarësisë së Kosovës, sipas planit të Marti Ahtisarit.

Ka mbetur vetëm Qiproja, që ta luajë edhe pak rolin e një Kali të Trojës. Por, mundësia e Qipros për ta penguar unitetin Evropian, vërtet është e papërfillshme.

Por, si edhe më herët, tash kanë dalë disa pengesa në formën e detajeve, të cilat ka rrezik të shndërrohen në shtyrjeje të afatit të shpalljes së pavarësisë së koordinuar të Kosovës.

Në këto detaje, bie edhe mbajtja e zgjedhjeve presidenciale në Serbi, që, sipas gjasave, do të mbahen gjatë janarit të vitit të ardhshëm (me mundësi që të barten edhe në shkurt, në rast të balotazhit.) Nëse është e vërtetë ajo që thonë mediet, se ministri i Jashtëm francez, Bernar Kushneri, ka propozuar që të priten edhe ato zgjedhje në Serbi, para se të pranohet pavarësia e Kosovës, kjo do të thotë edhe një komplikim i ri i situatës. Procesi negociator ka pasur në zhargitje disamujore, për shkak të zgjedhjeve parlamentare në Serbi, gjë që u tregua krejt e panevojshme, sepse në procesin e riaktivizuar negociator, e ashtuquajtura "qeveri demokratike" e Serbisë, të cilën Bashkimi Evropian e kishte ëndërruar si kalë gare, mbeti e lidhur me mijëra fije me Rusinë.

Akuzat e Vojisllav Koshtunicës, kreut të qeverisë serbe që doli nga ato zgjedhjeje, nuk kanë ndonjë dallim thelbësor nga akuzat që lëshon drejt Perëndimit Vojisllav Sheseli dhe fashistët e tjerë të sërës së tij.

Prandaj, kurrfarë shtyrjesh nuk do të ndihmojnë që Serbia të bëhet demokratike dhe kooperuese me Perëndimin. Përkundrazi, nëse i jepet ky favor i pamerituar Serbisë, gjasat më të mëdha janë që në zgjedhjet presidenciale të janarit 2008, të fitojë eksponenti i radikalëve serbë. Në atë rast, Bashkimi Evropian do t'ia lidhte vetes duart, sepse monstrumi fashist në krye të shtetit serb, do të ishte legjitim. Atëherë do të mund të kishte komplikime shumë më të mëdha, sepse një kryetar i mundshëm fashist në krye të Serbisë, do të vepronte në mënyrë radikale për destabilizimin e Kosovës dhe të rajonit. Prandaj, për rajonin dhe për Evropën, shumë më mirë është që në krye të Serbisë, nëse kjo është e pashmangshme, të vijë një kryetar fashist, pasi që Kosova të jetë pavarësuar, e jo para pavarësimit të saj. Ndërsa, rreziku që Serbia ta ketë fatkeqësinë që të udhëhiqet nga fashistët është real, ngaqë në zgjedhjet e fundit parlamentare, radikalët e Sheshelit kanë dalë partia më e madhe në Serbi. Ndërsa, Bashkimi Evropian duhet të mësohet të jetojë me këtë realitet, e mos ta përshpejtojë pranimin e këtij shteti problematik në gjirin e vet. Ledhatimi i ariut, sado i vogël e ulok që të jetë, nuk është një punë e urtë. Para se t'i hiqen të gjithë dhëmbët. Prandaj, Bashkimi Evropian tashmë duhet të ndjekë një agjendë më dinamike, të bazuar në unitetin e arritur në takimin e 10 dhjetorit e të mos hezitojë sërish, sepse hezitimi mund të sjellë komplikime të reja. Fjala vjen, pritja për zgjedhjet presidenciale në Rusi në mars të vitit 2008. Me këso logjike, zyrtarizimi i statusit të Kosovës mund të shtyhet derisa të mbahen edhe zgjedhjet "demokratike" në Kinë. Ndoshta edhe në Kubë!



Intervistë me politologun Bejtullah Destani, drejtor i Qendrës për Studime Shqiptare në Londër

Kosova ndoshta do të jetë e detyruar të bashkohet me Shqipërinë

- 17 vjet hulumtime nëpër arkivat britanike...
- Mungon përkrahja nga autoritetet dhe institucionet mbarëshqiptare...
- Edhe në 1913, roli i Rusisë kundër Shqipërisë ka qenë shumë i madh;
- Tirana dhe Prishtina zyrtare, duhet të zgjohen më në fund nga gjumi i tyre letargjik...

Intervistoi: Demir RESHITI

Njihet si shqiptari i arkivave britanike. Noel Malkolm e ka cilësuar si enciklopedi e gjallë. E vlerësojnë si "ambasador" të përjetshëm të shqiptarëve në Mbretërinë e Bashkuar, si librari shëtitëse, etj. Që prej 17 vjetësh jeton në Londër dhe vendet e preferuara ku e kalon pjesën më të madhe të kohës janë arkivat... Ai është Bejtullah Destani, me profesion politikolog, drejtor i Qendrës për Studime Shqiptare në Londër, autor dhe bashkautor i disa punimeve me rëndësi për historinë e shqiptarëve.

Në intervistën ekskluzive për revistën "Paqja", Destani flet për aktivitetet e tij dhe të qendrës që ai drejton.

Destani shpreh bindjen se, në një kohë të pacaktuar, Kosova do të jetë e orientuar dhe ndoshta e detyruar, të bashkohet më në fund me shtetin amë, Shqipërinë dhe thekson se Tirana dhe Prishtina zyrtare, duhet të zgjohen më në fund nga gjumi i tyre letargjik, në rast se duan vërtetë të ekzistojë kombi shqiptar.

17 vjet hulumtime nëpër arkivat britanike...

PAQJA: Pse e zgjodhët Londrën si vend të aktivitetit tuaj profesional?

Destani: Për aresyeje se Londra është një nga thesaret e arkivave me rëndësi botërore. Që në kohën kur isha student për shkenca politike, në Beograd, pata dëgjuar se në Londër ekziston një arkiv shumë i pasur dhe i pa lëvruar, me materiale mbi ballkanin. Kjo nxiti intuitën time si studiues që të ndërmarrë këtë udhëtim, pa planifikuar të qëndroj gjatë këtu. Megjithatë, vitet kaluan dhe unë mbusha plot 17 vjet në Angli.

PAQJA: Kur e filluat me hulumtime...

Destani: Hulumtimet i fillova menjëherë pas arritjes sime në Londër, në Qershor 1991. U mahnita nga fonoteka e pasur e materialeve që gjeta këtu dhe të gjitha ishin pothuajse të paprekura.

PAQJA: Çfarë keni zbuluar ne arkivat dhe bibliotekat britanike?

Destani: Materiale nga më të ndryshmet, që kanë lidhje me historinë dhe kulturën shqiptare, që nga shekulli i 16-të e deri në vitet 1974-75.

Mund të përmend këtu, dokumente që kanë të bëjnë me shqiptarët në shërbim të ushtrisë angleze, që në shek 16-të, gjatë kohës së Henrikut të 8-të dhe Elizabetës së I-rë. Po kështu vlen të përmendet se mjaft e pasur me materiale është dhe koha e Ali Pash Tepelenës. Dokumentet e kësaj kohe arrijnë deri në mijëra faqe të pabotuara akoma.

Kam gjetur gjithashtu dhe dokumente të ndryshme që kanë të bëjnë me kohën e kryengritjeve të shqiptarëve në vitet 30-të të shekullit të 19-të, një dosje mjaft interesante e cila dëshmon për vrasjen barbarisht të 500 feudalëve shqiptarë në Manastir, nga turqit. Dokumente mbi Lidhjen Shqiptare të Prizrenit e plot dokumente të tjera me vlerë historike që kanë lidhje me pavarësinë e Shqipërisë dhe okupimin e Kosovës nga Serbia.

Për periudhën e luftës së dytë botërore, kam gjetur dy dokumente mjaft interesante, që bëjnë fjalë për Luftën Civile në Shqipëri, bashkimin e Kosovës me Shqipërinë si dhe aneksimin dhe pozitën e shqiptarëve, në Jugosllavinë e re.

Një nga dokumentet më të rëndësishëm dhe me vlerë historike është një dokument me vulën origjinale të Lidhjes së Prizrenit.

Jam i binduar se, në një kohë të pacaktuar, Kosova do të jetë e orientuar dhe ndoshta e detyruar, të bashkohet më në fund me shtetin amë, Shqipërinë.

Mungon përkrahja nga autoritetet dhe institucionet mbarëshqiptare...

PAQJA: Ju jeni themelues i Qendrës për Studime Shqiptare Angli. A mund të na flitni lidhur me historikun e themelimit dhe aktivitetet që ka zhvilluar kjo Qendër?

Destani: Qendra është themeluar në Oxford në 1997 dhe është regjistruar si organizatë bamirëse dhe si kompani. Në bordin e Qendrës janë emra të shquar të historisë dhe kulturës shqiptare dhe asaj botërore, dashamirës të Shqipërisë. Mund të përmend këtu emrat e I. Kadaresë, N. Malcolm, Pëllumb Xhufit, Ferid Hudhrit, Emine Bakallit, Harry Norris, Odile Daniel etj.

Themelimi i Qendrës erdhi ardhur si rezultat i domosdoshmërisë së studimit dhe botimit të veprave serioze, mbi Shqipërinë dhe shqiptarët. Libri i parë i botuar nga kjo Qendër është një ribotim i studimit të Vaso Pashës, "E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët". Botimi i këtij libri daton në 1999. Pas tij u botuan një sërë veprash të tjera si; 'Skënderbeu" i Harry Hojkinson, "Selective corespondence" nga Faik Konica, "Një anglez në Shqipëri" nga Oakley-Hill, e plot botime të tjera kryesisht historike.

Përveç hulumtimit dhe botimit të librave, që përbëjnë dhe aktivitetin kryesor të kësaj Qendre, janë zhvilluar dhe një sërë aktivitetesh të tjera në planin e takimeve shkencore dhe historike, konferenca, pjesëmarrje në panaire të ndryshme të standardeve evropiane etj.

PAQJA: Me çfarë vështirësish jeni ballafaquar gjatë punës?

Destani: Vështirësia kryesore ka qenë dhe mbetet ajo financiare. Është shumë e vështirë për të kopjuar materialet që arrijnë në mijëra e mijëra faqe, dhe më pas për ti përgatitur ato për botim e për të përballuar shpenzimet e botimit. Shpesh më është dashur të paguaj nga paga ime mujore, edhe pse kurrë nuk kam patur ndonjë të ardhur nga Qendra. Kjo më ka vënë në vështirësi të mëdha financiare, personale, vështirësi me të cilat vazhdoj të përballem çdo ditë e më shumë. Për botimin e librave, kam kërkuar ndihmë nga autoritetet dhe institucionet mbarëshqiptare, qofshin ato politike apo shkencore, por nuk kam gjetur mbështetjen e duhur. Po kështu i jam drejtuar në mënyrë të vazhdueshme, për ndihmë dhe klasës së biznesmenëve shqiptarë, por duket se edhe këtë herë kërkesat e mia kanë rënë në vesh të shurdhët.

PAQJA: Çfarë bashkëpunimi keni me qendrat tjera?

Destani: Qendra për Studime Shqiptare në Londër, ka një bashkëpunim të gjerë me qendra dhe institucione të tjera kërkimore dhe studimore si me Universitete të ndryshme në Angli, me Institutin e Historisë në Tiranë, Arkivin e Shtetit Shqiptar si dhe me disa institucione në Gjermani, Austri, Francë etj.


Bejtullah Destani, njihet si shqiptari i arkivave britanike

PAQJA: Çfarë planesh keni në të ardhmen?

Destani: Planet janë të shumta, por nga ato afat shkurtra mund të përmend; ribotimin në tre vëllime të "Albanica" e Faik Konicës, një libër nga Willian Martin Leake që titullohet "Hulumtime në Greqi dhe Shqipëri", Dokumente mbi "Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës", "Një biografi letrare e Ismail Kadaresë" nga Peter Morgan, një libër mbi "Ali Pash Tepelenën" e plot të tjera.

Theksoj se realizimi i të gjitha këtyre projekteve varet nga mbështetja dhe përkrahja financiare që do t'i jepet Qendrës, pasi unë vetë tashmë nuk mundem të vazhdoj me sponsorizimin tim individual, për arsye të gjendjes së vështirë financiare me të cilën përballem.

PAQJA: Nga i siguroni fondet?

Destani: Siç e theksova më lart, një pjesë të librave e kam botuar me fondet e mia personale. Për disa projekte më kanë ndihmuar individë, dashamirës të kombit shqiptar, shqiptarë të diasporës, kryesisht asaj të Amerikës, dhe ndonjë ndihmë e akorduar nga ndonjë shoqatë bamirëse.

PAQJA: Historiani Noel Malkolm në librin e tij "Një histori e shkurtër për Kosovën", ju ka cilësuar si enciklopedi e gjallë. Ndërkohë ju vlerësojnë si "ambasador" të përjetshëm të shqiptarëve në Mbretërinë e Bashkuar, si librari shëtitëse, etj. Sa keni gjetur përkrahje nga Tirana dhe Prishtina zyrtare në punën tuaj?

Destani: Deri tani nuk kam gjetur asnjë përkrahje zyrtare nga institucionet shqiptare. Premtime kam patur shumë por, në realitet asgjë nuk është akorduar deri tani për këtë qendër. Është për të ardhur keq, kur mendon se përveç Greqisë, asnjë shtet tjetër nuk ka një qendër të ngjashme me Qendrën për Studime Shqiptare, këtu në Londër. Qendrat Greke, gëzojnë përkrahjen e plotë të Qeverisë dhe biznesmenëve grekë, ndërkohë që Qendra Shqiptare kalon një krizë të rëndë financiare. Mbetem me shpresë se Qeveria e Tiranës dhe ajo e Kosovës, do ta marrin seriozisht punën e sponsorizimit për daljen në dritë të këtyre materialeve, me vlera të patjetërsueshme për kombin tonë.

Edhe në 1913, roli i Rusisë kundër Shqipërisë ka qenë shumë i madh

PAQJA: Ju jeni me profesion politikolog. Si i vlerësoni zhvillimet politike rreth statusit te Kosovës nga

këndvështrimi i juaj?
Destani: Pavarësia e Kosovës do të realizohet, por koha e kësaj dhe ajo që sjell me vete pavarësia, mbetet në pikëpyetje. Duke marrë parasysh peshën dhe ndikimin politik të Rusisë mbi qarqet e politikës ndërkombëtare, çështja e kufijve territorialë të Kosovës, mbetet ende për t'u diskutuar. Jam i bindur se, në një kohë të pacaktuar, Kosova do të jetë e orientuar dhe ndoshta e detyruar, të bashkohet më në fund me shtetin amë, Shqipërinë.

PAQJA: Londra zyrtare historikisht ka luajtur rol të rëndësishëm në fatet e kombit shqiptar. Edhe sot kur zgjidhja e statusit të Kosovës ka hyrë në fazën përfundimtare, roli i Britanisë është i pamohueshëm. Cili është ndikimi i Qendrës që drejtoni ju në qëndrimin e Londrës zyrtare ndaj Kosovës?
Destani: Roli i Qendrës në këtë pikë, mbetet ai informues. Kemi bërë të gjitha përpjekjet e mundshme të informojmë Zyrën e Kryeministrit, Parlamentin Britanik dhe opinionin ndërkombëtar, lidhur me të vërtetën dhe situatën më të fundit në Kosovë. Qëndrimi i Londrës Zyrtare është pozitiv dhe në krah të pavarësisë. Nuk duhet harruar fakti se pavarësisht copëtimit të trojeve shqiptare dhe aneksimin e trojeve tona Malit të Zi, Serbisë dhe Greqisë, Shteti Shqiptar është themeluar, në Londër. Po t'i rikthehemi historisë, nga një këndvështrim i ri, do të gjejmë se edhe në 1913, roli i Rusisë kundër Shqipërisë ka qenë shumë i madh dhe, nuk ka qenë e lehtë të merren vendime pozitive, në favor të plotë të Shqipërisë.

Tirana dhe Prishtina zyrtare, duhet të zgjohen më në fund nga gjumi i tyre letargjik...

PAQJA: Serbët në vazhdimësi thirrën në të drejtën historike mbi Kosovën, dhe në këtë drejtim, sa kemi informacione Akademia e Shkencave të Serbisë ka botuar, dhjetëra mijëra faqe materiale në serbisht dhe anglisht për të argumentuar pse Kosova është pjesë e Serbisë. Çka ka bërë historiografia shqiptare në këtë drejtim?
Destani: Fatkeqësisht historiografia shqiptare ka qenë dhe mbetet pasive në këtë drejtim. Ka ardhur koha që e vërteta të thuhet ashtu siç është bardh e zi, paçka se ne nuk jemi mësuar të jemi kritikë ndaj vetvetes. Kjo neglizhencë e sferave akademike dhe politike shqiptare, ka ndikuar dhe vazhdon të ndikojë në dëm të kombit dhe vendit tonë. Tirana dhe Prishtina zyrtare, duhet të zgjohen më në fund nga gjumi i tyre letargjik, në rast se duan vërtetë, të ekzistojë kombi shqiptar.

PAQJA: Më 9 dhjetor është organizuar një tubim për Kosovën në "Downing Street" me moton "THANK YOU" Britani, ku ishit të pranishëm edhe ju. Çfarë mesazhi përcolli ky tubim, dhe a mendoni se një diasporë e organizuar mirë mund të ndikoj në shtyrjen përpara të proceseve?
Destani: Tubimi ishte shumë modest dhe më së shumti ishte një shenjë falënderimi për Qeverinë Britanike. Tubime të tilla ka patur jo vetëm në Londër, por edhe në SHBA e gjetkë.
Natyrisht që një diasporë e organizuar mirë, mund të ndikojë pozitivisht në shtyrjen përpara të proceseve, duke patur këtu parasysh edhe fondet që mund të sigurojë ajo. Dua të sjell këtu shembullin dhe ndikimin që ka diaspora armene ne Amerikë, e cila mbetet diaspora më e organizuar pas asaj Izraelite, jo vetëm në Amerikë, por dhe në mbarë botën. Të mos harrojmë se Shteti Shqiptar u krijua nga diaspora shqiptare. Sot Tirana zyrtare ka një mirëkuptim dhe bashkëpunim me diasporën shqiptare, më të madh se Prishtina. Jam i bindur se diaspora do të ketë ndikimin e saj pozitiv me rëndësi dhe në të ardhmen, për trojet mbarëshqiptare, kudo në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe trojet e tjera shqiptare.

PAQJA: Për fund, cili është mesazhi i juaj për lexuesit e revistës "PAQJA"?
Destani: Dëshiroj të ndihmojmë njëri-tjetrin dhe të nxisim kultivimin e vlerave pozitive të shoqërisë shqiptare. Të studiojmë thellësisht dhe të krenohemi me të kaluarën e kombit tonë dhe le të bëhet kjo e kaluar krenare, bazamenti i kombit të ri shqiptar.
I përshëndes të gjithë lexuesit dhe shpreh urimin e çdo shqiptari; për një pavarësi të shpejtë të Kosovës.


EDWARD LEAR IN ALBANIA
Journals of a Landscape Painter in the Balkans
Bejtullah Destani and Robert Elsie (Eds).
Foreword by Vivien Noakes
Lavishly illustrated with the artist's own paintings and suffused with a unique charm, Edward Lear in Albania catalogues his idiosyncratic observations of this beautiful and unknown land. Including vivid insights into the environment, culture and politics of the period, these Journals offer an intimate portrait of a wild yet captivating corner of Europe.
December 2007
246 x 189mm
232 pages Hardback
978 1 84511 602 6
~~£24.50~~
£17.20

2006
234 x 156mm
224 pages Hardback
978 1 84511 601 9
~~£45.00~~
£31.50

ALBANIAN LETTER[S]
Nationalism, Indepen[dence]...
Albanian League
Bejtullah Destani (Ed.)
In Albanian Letters, Evar...

TRIBES AND BRIGANDS IN THE BALKANS
A History of Northern Albania
T.J. Winnifrith
Tribes and Brigands in the Balkans traces the history of this ruggedly beautiful region, frequently disturbed by both invaders and internal strife yet retaining a distinct national identity and character. From its origins in the ancient kingdom of Illyria and the Roman province of Illyricum, through Byzantine and Ottoman rule, the granting of Albanian independence in 1912, the rise and fall of Communism to its current fragile democracy, Northern Albania can be seen as a cultural crossroads - especially remarkable given its mountainous and difficult landscape.
Tribes and Brigands in the Balkans is the first modern comprehensive history of Northern Albania and is a brilliantly accessible introduction to a remote and inaccessible
2008
234 x 156mm
320 pages Paperback
978 1 84511 79 5
~~£12.99~~
£9.10

2006
216 x 134mm
256 pages Hardback
978 1 84511 590 6
~~£25.00~~
£17.50

THE LAND OF THE MOUNTAINS
The Nineteenth-centur[y] Albanian National Ide[ntity]
Dora d'Istria
Translated by Morelle...

Disa nga Botimet e Qendrës për Studime Shqiptare Angli

"E vërteta mbi Shqipërinë dhe Shqiptarët", nga Vaso Pasha.
"Skënderbeu", shkruar Harry Hodgkinson. Është një biografi e ributuar disa herë dhe ka pasur shumë sukses.
"Korrespondenca të zgjedhura nga letrat e Faik Konicës 1896- 1942", nga Faik Konica.
"Lahuta e Malcisë" e Gjergj Fishtës, përkthyer nga Robert Elsie në anglisht, si përkthimi i tretë në një gjuhë evropiane. Promovimi i këtij libri është bërë në Parlamentin anglez, duke qenë një sukses i jashtëzakonshëm.
"Gjashtë muaj mbretëri", shkruar nga sekretari i Mbretit Vid, Duncan Heaton-Armstrong, i cili ka qenë në Shqipëri për gjashtë muaj si sekretar privat i Mbretit Vid.
"Albania today" (Shqipëria sot). Një libër shumë me rëndësi për antropologjinë e Shqipërisë, sidomos asaj veriore, kryesisht Mirdita, është shkruar nga Clarisa DE Wal, i cili është përfaqësues i universitetit të Kembrixhit. Libri është botuar edhe shqip dhe quhet "An Englishman in Albania" (Një anglez në Shqipëri), shkruar nga i D. R. Oakley – Hill. (D. R. Oakley - Hill ka qenë një kolonel që ka shërbyer në ushtrinë shqiptare në kohën e Mbretit Zog deri në vitet 1938. Ka lënë një dorëshkrim të kujtimeve të gjata, dhe që është botuar në vitin 2001 nga kjo qendër, duke u përkthyer në shqip).
"Letërsia shqipe një histori e shkurtër", shkruar nga Robert Elsie për historinë e letërsisë shqipe.
...

Ese për mitet dhe "idhujt pa krena"

Besim R. CENGU

Ditën e ftohtë të 17 Nëntorit u ndodhëm në autobusin e linjës Prishtinë-Gjilan. Do të vëzhgonim se si po shkonin zgjedhjet në atë qytet. Pluhuri i borës së rënë atë natë e bënte ditën edhe më të acartë nga ç'ishte. Dukej sikur edhe pankartat e fotografitë gjigande elektorale të vendosura gjithkund po mërdhinin. Përmes tyre përcillej mesazhi se po ndërronin epokat, psikologjitë, praktikat stereotipe të politikës, por nga ana tjetër edhe se të gjithë ata që po votonin atë ditë, për të zgjidhur problemin e vet madhor, ende kanë rrugë të gjatë për të bërë me gjithfarë pengesash e të papritura. Pengesa që i nxjerrim vetvetes, por edhe pengesa që na nxjerrin të tjerët.

Parada e pankartave gjigande

Ulur rastësisht me një studente gjilanase, kundronim grykën e Slivovës unë për hesapin tim, ajo për të vetin. Me shpejtësi kalonin si në radhë anash rrugës personazhe aktualë të politikës shqiptare. Secili prej tyre pozonte krenar dhe i vendosur në premtimet elektorale që kanë dhënë për të ardhmen e shqiptarëve. Mbi supet dukej se rëndonin këto premtime (shumica euforike) si fjala e dhënë e Halil Garrisë. Premtimet, apo fjalët e dhëna të politikanëve, që më së shumti nuk ishin në dorën e tyre për tu bërë realitet, duhet të bëheshin se kështu e ka rregulli i një fushate zgjedhore, sidomos kur ajo është e trefishtë.

Premtuan për pavarësinë. Folën shumë liderët e partive për aktin historik që duhet të kryhet kur të thonë të tjerët. Premtuan për rrymën 24 me 0, ndërkohë që burimet energjetike nuk administrohen prej tyre në këtë kapërcyell delikat të transformimit ekonomik. Premtuan për ngritjen e nivelit të sistemit arsimor, rritjen e pagave, pensioneve, depërtimin e interneteve nëpër shkolla. Premtuan luftën kundër korrupsionit…luftën kundër informalitetit, për një Prishtinë moderne e metropol të zhvilluar, për një Kosovë evropiane. Ç'ka nuk u premtua!

Në kulmin e kësaj daravitje mendore, anash rrugës u shfaq u shfaqën përsëri Thaçi, Sejdiu, Pacolli, Daci, Haradinaj, por edhe pankarta e madhe e Ibrahim Rugovës.

Një dialog krejt i rastësishëm

Për një çast mu duk i gjallë Ibra. Iu drejtova studentes me mirësjellje dhe e pyeta:

Më falni, Rugova ka kandiduar për deputet, a për kryetar komune në Prishtinë?

Vajza krejt e befasuar përballë pyetjes time shprehu habinë dhe më tha:

Jo zotëri, Rugova nuk jeton. Ai ka qe dy vjet që ka vdekur.

Po pse ai është në fotografi, pra? Apo ka mbetur që prej kohës kur ishte gjallë, si gjurmë e ndonjë fushate të asaj kohe?

Vajza rrudhi supet me ndrojtje, pa qenë e sigurt se si të sillej me mua dhe u zhyt përsëri në botën e vet. Ndoshta më mori për një njeri krejt të painteresuar për aktualitetin politik në Kosovë. Ose ndoshta e mori për provokim. Nejse.

Përgjatë rrugës hasëm përsëri në fotot e ish-presidentit të ndjerë, ndërsa mua mu duk se studentja tani vështronte me një interes tjetër portretet e tij. Megjithatë unë disi ia ngacmova ndërgjegjen e saj dhe hetova se deri diku e kuptoi nëntekstin e dialogut tim. Pak para se të zbritnim më tha:

Ju nuk jeni nga Gjilani. Më duket jeni nga Shqipëria.

Po, - i thashë. Jam nga vendi prej nga jeni edhe ju.

Vuri buzën në gaz dhe tha:

Po. Keni të drejtë.

Zbritëm. Ajo shkoi në punën e saj, ndërsa unë në punën time.

Mitet dhe idhujt

Pas kësaj ndodhie krejt të zakontë mu konsolidua edhe më shumë mendimi që kam për mitet dhe idhujt. Ndoshta nuk kam të drejtë, por ne shqiptarët ende nuk kemi zbritur prej besimit në mite, apo idhuj. Kjo nuk është gjë e keqe, por duhet të dimë t'i dallojmë ato, t'i klasifikojmë siç duhet e t'i vemë në pjedestalet që u takojnë. Tjetër gjë janë mitet, ndërsa krejt tjetër janë idhujt.

Në epokën e sotme ka shumë rëndësi "përdorimi" me vend i tyre në funksion të realizimit të qëllimeve. Jemi në epokën e prakticitetit e veprës. Profesor Rexhep Qosja në ditarin e Rambujesë "Paqja e përgjakshme", shënon diku se para se të vinte Medlin Ollbrajt në takim, ambasadori Krist Hill, porosit delegacionin tonë që të mos zgjaten shumë me historinë e figurat që e kanë bërë atë në epoka të ndryshme. Me një fjalë, asaj nuk i duhej shumë për rastin Batoja, Agroni, Skënderbeu apo dikush tjetër. Asaj, ashtu sikurse gjithë politikës euro-amerikane i interesonte zgjidhja e problemit në Ballkan. Inflacioni i fjalëve nuk është i dobishëm, përkundrazi.

Mitet, por edhe idhujt janë të vlefshëm, por ata nuk ndihmojnë për gjithçka. Në kontekstin e esesë time, edhe pse ata u "përdorën" nuk ndihmuan për fitoren e zgjedhjeve nga LDK-ja dhe që ta nxjerrin atë prej kolapsit politik. Humbja katastrofike e LDK-së në zgjedhjet e 17 Nëntorit e tregoi më së miri.

Por zbuloi edhe disa gjëra tjera shumë domethënëse, kundrejt të cilave politika postrugoviste duhet të ketë kujdes.

Së pari, LDK-ja po notonte dhe noton padyshim edhe tash në vakuum idesh. Kur një subjekt politik karakterizohet prej varfërisë së ideve, është i destinuar të dështojë. Partia e Rugovës nuk kishte dhe as nuk ka ç't'i thotë popullit, prandaj e thirri prej botës tjetër idhullin e vet, që gabimisht e ka quajtur dhe vazhdon edhe sot ta konsiderojë mit, me shpresë se do t'i ndihmonte për të fituar sadopak simpatinë e shqiptarëve të zhgënjyer e të lodhur prej tranzicionit pa fund.

Së dyti, Rugova edhe në të gjallë të vet, ishte e mbeti mit vetëm i një pjese njerëzish, vetëm i atyre që ishin dhe simpatizonin LDK-në. Domethënë ai ishte jo mit, por një idhull politik. Idhujt, sidomos ato politik nuk jetojnë gjatë, sepse në zemrën e tij nuk gjejnë veten gjithë njerëzit, të cilëve u përket, si në rastin e Skënderbeut, apo Adem Jasharit. (Miti ynë i Mesjetës, Skënderbeu dhe Miti ynë i Ri, Adem Jashari janë për krejt shqiptarët kudo që jetojnë, ndërsa për hir të së vërtetës, Rugova nuk e ka patur as kur ka qenë mes të gjallëve, as tash që është në botën e nëndheshme, një privilegj të tillë). Raste të idhujve politikë kemi boll ne shqiptarët përgjatë shekullit "politik" i cili ka ikë me të mirat e të këqijat e tij. Rugova nuk arriti të jetë i të gjithëve se i takoi atij shekulli. Prandaj nuk kishte si të frymëzonte e ndihmonte prej botës së amshuar ushtrinë e vet elektorale, ashtu sikurse nuk mundi të frymëzonte popullin në luftën për çlirim në të gjallë të tij.

Së treti, LDK-ja dhe liderët e saj aktualë nuk duhet të keqpërdorin idhullin e vet, pasi sipas të gjitha gjasave e zhvlerësojnë figurën e tij dhe meritat që ka për periudhën kur jetoi e punoi. Kam idenë se kjo humbje e thellë do të shërbejë që LDK-ja të vetëkorrigjohet. Nëse ec përsëri mbi këto hulli, zgjedhjet tjera ky formacion politik do t'i presë me një përqind.

Korrespodencë nga Shkupi

Maqedonia dhe politika e saj e konfliktit

Pozita e bekoi aksionin, opozitës i mjaftoi një deklaratë disa rreshta dënimi, që më shumë paraqet marketing politik; ndërsa "turma delesh" mblidhen e demonstrojnë për pavarësinë e Kosovës dhe Maqedoninë në NATO (një mishmash paradoksal) dhe nuk organizohet as për një protestë simbolike në shenjë solidarizimi me bashkëkombësit e tyre



Avni AVDIU

Maqedonia ndodhet në krizë të thellë politike. Problemi me emrin e shtetit ende nuk është zgjidhur përderisa kjo çështjeje kërkon zgjidhjeje imediate. Situata e rëndë sociale nëpër të cilën po kalon vendi nuk i justifikon përpjekjet e qeverisë në synimin e saj që t'i forcojë aspektet e tjera ekonomike në nivel shtetëror. Popullata në përgjithësi kohëve të fundit është dëshmitare e një rënie drastike të nivelit të standardit jetësor. Ngritja e çmimeve te të gjithë artikujt dhe stagnimi i pagave dhe ndihmave sociale janë indikatorë të mjaftueshëm për ta ilustruar gjendjen e krijuar.

Popullata maqedonase nuk është mësuar edhe aq të përjetojë një gjendjeje të tillë, prandaj qeveria maqedonase i frikësohet shpërthimit të mundshëm të pakënaqësisë.

Brodeci, rast i kurdisur...

Logjika e shpëtimit është gjetur dhe, edhe këtaj radhe si "kurban" i ngushëllimit është pikërisht populli shqiptar. Qeverisë i duhej një incident gjithqysh. Dhe ai duhej improvizuar. Për rrjedhojë u inskenua Brodeci, ashtu siç inskenohej më parë Bit Pazari, Gostivari, Reçica e vogël etj.

Fakti se Brodeci ka qenë rast i kurdisur, nuk do shumë mend për t'u kuptuar. Për çdo mendjeje të shëndoshë është e paparamendueshme se si është e mundshme që "një mbeturinë e bandave kriminale", siç quhen, e izoluar diku në male të paraqesë kërcënim për sigurinë e një shteti.

Sikur të ishte ashtu, si është e mundshme që ai grup i vogël e i dobët prej dy-tre vetash të dalë aq naivë e t'i shpallë luftë një njësie të sofistikuar policoro-ushtarake (serbo-maqedonase).

Nga zyrtarët e Beogradit u tha se forcave maqedonase u kanë dalë në ndihmë edhe forcat nga Serbia. Si u arrit vallë ai koordinim aq preciz në mes dy shteteve për një operacion të befasishëm?! Pastaj si është e mundur që një grup prej dy-tre vetash të jetë aq shumë i armatosur me një arsenal që do të ishte i tepërt edhe për një brigadë të tërë?!

Gjërat janë të qarta madje edhe për një fëmijë të mitur.

Po kalojmë në anën tjetër. Nëse vërtet paska tentativa të "grupeve kriminale shqiptare" për të shkaktuar situatë konfliktuoze në Maqedoni, shtrohet pyetja pse ndodhin gjëra të tilla? Sa janë integruar dhe sa janë risocializuar invalidët dhe ish-ushtarët e UÇK-së në Maqedoni?!

Lënia e tyre rrugëve pa perspektivë është potencë për mbledhjeje të vazhdueshme të pakënaqësive, aq më tepër kur idealet për të cilat luftuan nëpërkëmben çdo ditë (vendimi i Gjykatës Kushtetuese për mospërdorimin e flamurit shqiptar, moszbatimi i përdorimi të gjuhës shqipe në nivel komunal e shtetëror, zvarritja e implementimit të marrëveshjes së Ohrit etj).

Pra, gjithsesi si në një anë ashtu edhe në tjetrën del qartë se shqiptarët merren veçse si mjet stigmatizimi, për t'u shenjëzuar për arritjen e ndonjë objektivi që i duhet pushtetit për momentin e caktuar.



Përçarja e shqiptarëve i konvenon bllokut maqedonas

Kulminacioni i mjerimit është se "yryshit" maqedonas kalojnë pa therë në këmbë. Gjithçka reali-



zohet sikur të ishte thjesht përgatitjeje xhirimi për ndonjë film të Holivudit. Dhe spektatori më idiot në këtë "film" është faktori shqiptar si brenda, ashtu edhe jashtë Maqedonisë.

Le të mendohet vetëm pak sikur forcat e armatosura të Shqipërisë të sulmonin ngjashëm ndonjë fshat të banuar me maqedonas në Shqipëri! Apo çdo të ndodhte po të granatonin shqiptarët ndonjë kishë të tyre?

Sa bujë pompoze u ngrit në trazirat e marsit në Kosovë kur shqiptarët sulmuan objektet fetare? Nuk harrohet dot se kur shqiptarët të indinjuar nga e kaluara serbe ndaj tyre shfrenin pezmin e tyre, politikanët e "mençur" shqiptarë dilnin me idenë se sulmuesit janë fashistë. Kur ne e konsiderojmë veten ashtu, çdo të thoshin të tjerët atëherë për ne?

Sulmit në Brodec i parapriu rrahja e deputetëve shqiptarë ndërmjet vete në parlamentin e Maqedonisë.

Sulmit në Brodec i parapriu edhe vizita e kryeministrit Gruevski në xhami.

Këto dy momente janë të një rëndësie të veçantë për ta kuptuar thelbin e problemit.

Qeveria e Maqedonisë e ka kuptuar se shqiptarët janë të përçarë. Kjo i konvenon bllokut maqedonas për shumë arsye. Në raste të hakmarrjeve (për luftën e 2001) si në rastin e Brodecit, shqiptarët do të merreshin me fajësime reciproke. Komisionet që formohen sa për formalitet për të ashtuquajturat tejkalime të kompetencave do të jenë gjithnjë instrumente që nëpërmjet dënimit të dy-tre policëve ta paraqesë vendin si shtet ligjor që veprimet e tilla i merr veçse nga nevoja e ruajtjes së integritetit territorial. Pastaj me anë të ndihmës materiale të ofruar të dëshmohet gjoja karakteri human i veprimit.

Kjo lojë, kjo taktikë dhe kjo "filozofi" e mbrapshtë është një demagogji për t'i hedhur hi syve të botës se Maqedonia është tamam vend që vepron sipas standardeve evropiane. Kjo strategji i duhet për faktin se barazia e plotë e shqiptarëve është kusht i Maqedonisë për në Perëndim. Në këtë mënyrë Maqedonia tenton ta mashtrojë botën mu në kohën e internetit, kur realiteti nuk mund të shtrembërohet assesi.

Ajo çfarë është për ta vajtuar popullin e shkretë jo vetëm të Brodecit, është udhëheqja ose më mirë ta quajmë klasa politike shqiptare e të gjitha taborëve.

Pozita e bekoi aksionin, opozitës i mjaftoi një deklaratë disa rreshta dënimi që më shumë paraqet marketing politik, ndërsa "turma delesh" mblidhen të demonstrojnë për pavarësinë e Kosovës dhe Maqedoninë në NATO (një mishmash paradoksal) dhe nuk organizohet as për një protestë simbolike në shenjë solidarizimi me bashkëkombësit e tyre.

Maqedonisë duhet t'i bëhet e qartë nga faktori shqiptar se tash e tutje ecja triumfale mbi gjakun e popullatës së pafajshme civile do të jetë e patolerueshme.

Duhet të sinjalizohet Prishtina dhe Tirana që mos të jenë vetëm deklarative, por ta sensibilizojnë edhe Këshillin e Sigurimit të OKB-së që të paktën me rezolutë t'i dënojë veprimet e tilla të pamatura.

Maqedonia ka të drejtë si çdo shtet t'i luftojë elementet keqbërëse kriminale, por nuk ka të drejtë që në emër të kësaj lufte të improvizojë probleme të paqena. Tash kur Maqedonia ka probleme me emrin, politikisht nuk është veprim i mençur të inskenojë edhe probleme të natyrave të sigurisë. Në prag të zgjidhjes së statusit të Kosovës, kur ditët numërohen dhe priten edhe eskalime të elementit ultranacionalist serb, fryrja e zjarrit në Maqedoni ka tendencë t'i zgjerojë mundësitë e tendosjes së situatës edhe në shkallë më të gjerë.

Le të mendohet vetëm pak sikur forcat e armatosura të Shqipërisë të sulmonin ngjashëm ndonjë fshat të banuar me maqedonas në Shqipëri! Apo çdo të ndodhte po të granatonin shqiptarët ndonjë kishë të tyre? Sa bujë pompoze u ngrit në trazirat e marsit në Kosovë kur shqiptarët sulmuan objektet fetare? Nuk harrohet dot se kur shqiptarët të indinjuar nga e kaluara serbe ndaj tyre shfrenin pezmin e tyre, politikanët e "mençur" shqiptarë dilnin me idenë se sulmuesit janë fashistë. Kur ne e konsiderojmë veten ashtu, çdo të thoshin të tjerët atëherë për ne?

Xhamia e Ibrit pret vendimet politike

Kaluan tetë vjet të plotë që Këshilli i Bashkësisë Islame i Mitrovicës vazhdimisht ka kërkuar nga organet kompetente, UNMIK-u, KFOR-i dhe Kuvendi Komunal, leje dhe siguri për fillimin e punëve, por askush deri më tash nuk i ka përfillur kërkesat e tyre

Florije ADEMI

Tetë vjet pas përfundimit të luftës në Kosovë, ende nuk i është dhënë drita e gjelbër rindërtimit të Xhamisë së Ibrit që konsiderohet njëra nga xhamitë më të vjetra të qytetit të Mitrovicës, e cila daton nga viti 1842. Kjo xhami ishte në cepin e urës kryesore në anën veriore të qytetit, dhe gjatë luftës së fundit është djegur nga serbët, njëjtë si edhe shumë objekte të tjera fetare e kulturore, si dhe shtëpi banimi. Asllan Fazliu, kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame në Mitrovicë, njëherësh përfaqësues i besimtarëve islamë edhe për tri komunat veriore të këtij rajoni, pohon se qe tetë vjet në vazhdimësi Këshilli i Bashkësisë Islame i Mitrovicës ka kërkuar nga organet kompetente, UNMIK-u, KFOR-i dhe Kuvendi Komunal, leje dhe siguri për fillimin e punëve, por askush deri më tani nuk i ka përfillur kërkesat e tyre.

Dyshohet për varrezë masive në bodrumet e xhamisë

"Fillimisht kemi kërkuar që ai vend të gjurmohet pasi që supozohet se aty ka varrezë masive. Shumë qytetarë të cilët kanë qenë këtu gjatë luftës, sidomos ata të veriut, kanë thënë se pas djegies së xhamisë, aty ka kundërmuar një erë e rëndë dhe është hedhur dhe me kamionë për t'u mbushur ajo hapësirë", thekson Fazliu, sipas të cilit, xhamia ka qenë nën nivelin e urës dhe ka pasur edhe bodrume, kështu që ka mundësi që aty të jenë mbajtur kufoma dhe pas djegies së objektit serbët kanë dashur t'i humbin gjurmët e krimeve të tyre duke hedhur dhe në atë hapësirë.

"Neve patjetër na duhet ta pastrojmë terrenin dhe pastaj ta fillojmë rindërtimin e objektit. Mirëpo, ne vazhdimisht jemi injoruar nga institucionet që i përmenda dhe gjatë kësaj kohe ka pasur edhe tentime të serbëve për ta okupuar atë hapësirë, megjithatë ne jemi kujdesur që kjo mos të ndodhë", ka thënë Fazliu.

Sipas tij, para një kohësh është tentuar që aty të bëhet një treg, pastaj që të futen gypat për nxehje ku pastaj nuk do të lejohej asnjë rindërtim, por pas intervenimit të BI-së, UNMIK-u dhe policia kanë ndërprerë punimet.



Xhamia e Ibrit para vitit 1999


Vendi ku ka qenë xhamia

KFOR-i i ruan kishat, por jo edhe xhamitë!

Kryetari i KBI-së, Fazliu thotë se para një viti, atëherë kur është parë se nuk ka shenja për lejimin e ndërtimit të xhamisë, është kërkuar nga UNMIK-u dhe KFOR-i, që së paku të mundësojnë rrethimin e asaj hapësire, duke u ofruar atyre siguri për punë, ose duke e rrethuar vet. Mirëpo, zyrtarët e KFOR-it, sipas tij, kanë thënë se nuk merren me objekte fetare, derisa ata të UNMIK-ut nuk kanë dhënë kurrfarë përgjigje.
Nga ana tjetër, vetë ushtarët e KFOR-it janë ata që kanë vënë rrethojën e kishës ortodokse serbe në pjesën jugore të Mitrovicës, që dëshmon njëanshmërinë e tyre të veprimit.
Pierre Winckel, këshilltar për media i komandantit rajonal të KFOR-it në Mitrovicë, duke mos dashur të komentojë njëanshmërinë e KFOR-it sa u përket objekteve fetare, thotë se lidhur me çështjen e rindërtimit të xhamisë ekzistojnë dy aspekte, ajo e sigurisë dhe lejes për punë, e cila është në kompetencë të UNMIK-ut dhe Komunës së Mitrovicës.
“KFOR-i është në mbështetjeje të SHPK-së dhe UNMIK-ut dhe reagon në raste kur situatën nuk mund ta kontrollojnë këto dy institucione”, thekson Winckel, duke mos dhënë përgjigje konkrete në pyetjen pse KFOR-i s’ka ofruar siguri për zyrtarët e BI-së.

Kakuk: Vetëm çështja e sigurisë është ajo që pengon rindërtimin e xhamisë

Ndërkaq, zëdhënësi i Kuvendit Komunal të Mitrovicës, Hysni Syla, thotë se komuna ka diskutuar për problemin rreth rindërtimit të xhamisë shumë herë në takime me zyrtarët e UNMIK-ut, të cilët e administrojnë veriun e qytetit, por këta të dytët çdoherë kanë thënë se ende nuk janë pjekur kushtet e sigurisë për fillimin e rindërtimit të këtij objekti. Kështu është shprehur edhe për revistën “Paqja”, zëdhënësi i UNMIK-ut Georgy Kakuk. “Vetëm çështja e sigurisë është ajo që pengon rindërtimin e xhamisë”, ka theksuar Kakuk.
Ndonëse në cepin tjetër të urës dhe atë në pronë të Kuvendit Komunal të Mitrovicës, serbët me bekimin e UNMIK-ut kanë ndërtuar memorialin e gjoja viktimave të NATO-së, cepin e kundërt UNMIK-u e sheh si të pasigurt. Megjithatë, këtu shihet qartë edhe njëanshmëria e këtij institucioni i cili deri më tani ka privilegjuar minoritetin serb në raport me shqiptarët dhe minoritet e tjera që jetojnë në Mitrovicë. Kakuk, pa dashur të komentojë këtë, ripërsërit se çështja e sigurisë pengon rindërtimin e xhamisë.
Sidoqoftë, kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame (KBI) në Mitrovicë, Asllan Fazliu, shprehet i pakënaqur dhe thotë se KBI-ja është fyer dhe injoruar nga institucionet, por zyrtarët e saj kanë vepruar në përputhje me etiken fetare.
Duke iu referuar së ardhmes, ai shpreson se pas përcaktimit të statusit të Kosovës sikur qeveria lokale ashtu edhe ajo qendrore do të kenë mundësi që të bëjnë më shumë për qytetarët dhe në këtë rast edhe për Bashkësinë Islame.
Megjithatë, në emër të BI-së në këtë qytet, ai shpreh pakënaqësinë e këtij institucioni me planin e Ahtisaarit, i cili po përfolet si zgjidhja më e mirë për statusin e Kosovës. Vërejtja e tyre është veçmas në pjesën ku flitet për trashëgiminë kulturore fetare në Kosovë, gjegjësisht në Mitrovicë, ku parashihet siguri dhe eksterritorialitet për objektet fetare serbe, por jo edhe për ato të besimit islam, kur dihet se BI-ja në veri është pronarja më e madhe e tokave.


Asllan Fazliu, kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame në Mitrovicë, njëherësh përfaqësues i besimtarëve islam edhe për tri komunat veriore të këtij rajoni, pohon se që tetë vjet të plotë Këshilli i Bashkësisë Islame i Mitrovicës vazhdimisht ka kërkuar nga organet kompetente, UNMIK-u, KFOR-i dhe Kuvendi Komunal, leje dhe siguri për fillimin e punëve, por askush deri më tani nuk i ka përfillur kërkesat e tyre

Londra - "kryeqytet" i botës

Londra paraqet një nga qytetet më tërheqëse të botës bashkëkohore. Londra, kryeqyteti i Anglisë dhe Mbretërisë së Bashkuar është një nga metropolet kryesore botërore, e cila shtrihet buzë lumit *"Thames"* në juglindje të Anglisë dhe është qyteti i nëntë për nga madhësia në botë. Vetëm gjatë ditës rreth 2 milion banorë hynë dhe dalin nga ky qytet

Sead UJKANI & Arbër ZEKA

Gjatë muajit shtator në një vizitë dyjavore qëndruan në Londër 20 studentë të Universitetit të Prishtinës, përkatësisht përfaqësues dhe anëtarë të parlamentit të studentëve të UP-së. Studentët pjesëmarrës gjatë kësaj vizite përveç që patën mundësi të vizitojnë dhe njihen me qytetin e Londrës, ata gjithashtu vizituan edhe qytetin universitar të Kembrigjit.

Kjo vizitë në Londër ishte e rëndësishme edhe për faktin se studentët pjesëmarrës për dy javë rresht vijuan edhe një kurs intensiv të gjuhës angleze në një nga shkollat më prestigjioze të Londrës, "Stanton school of english", që ishte shumë domethënëse në drejtim të përvetësimin të gjuhës angleze për studentët përkatës.

E veçantë e gjithë kësaj vizite ishin takimet me bashkatdhetarët tanë atje, ku vlen të përmendet mikpritja shumë e ngrohtë nga ana e tyre. Studentët pjesëmarrës ishin pjesë e disa aktiviteteve të organizuara nga mërgata jonë atje enkas për ta. Duke folur rreth kësaj vizite, kryetari i Parlamentit të studentëve, Gëzim Qerimi me theks të veçantë në emër të gjithë studentëve pjesëmarrës shprehi mirënjohje dhe falënderimet më të thella për mikpritjen e bërë nga ana e mërgatës shqiptare në Londër.

Më poshtë do t'i paraqesim disa përshtypje nga qëndrimi në Londër, që paraqet një nga qytetet më tërheqëse të botës bashkëkohore. Londra, kryeqyteti i Anglisë dhe Mbretërisë së Bashkuar është një nga metropolet kryesore botërore, e cila shtrihet buzë lumit "Thames" në juglindje të Anglisë dhe është qyteti i nëntë për nga madhësia në botë. Vetëm gjatë ditës rreth 2 milion banorë hynë dhe dalin nga Londra, ndërsa ajo është e ndarë në gjashtë zona të cilat janë: "Qyteti i Londrës"; "The west end"; "Londra lindore"; "Londra veriore"; "Londra Perendimore"; dhe "Londra Jugore".

Historia e qytetit

Historia e Londrës përfshin një periudhë prej 2000 viteve, duke filluar me ardhjen e romakëve pas invazionit në Britani. Londra është ndërtuar nga bashkimi i dy qyteteve të lashta, të cilat së bashku e bëjnë një regjion të njohur si "Londra e Madhe", këto dy qytete janë:

Qyteti i Londrës, i njohur thjeshtë si "The city", i cili është zemra e biznesit dhe financave të Mbretërisë së Bashkuar. Ky qytet është i njohur edhe si "Square Mile".

Qyteti Westminster, ku gjenden Parlamenti dhe shumica e zyrave të qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. Në këtë pjesë të qytetit të tanishëm të Londrës gjenden edhe Pallati Buckingham, rezidenca zyrtare e Mbretëreshës si dhe familja mbretërore.

Fakte për qytetin e Londrës

Londra është qyteti më i madh në Britani dhe në Evropë. Ky qytet shtrihet në pjesën jug-lindore të Anglisë dhe përfshin një sipërfaqe prej 620 mile në katror. Londra ka një popullsi prej diku rreth 8 milion banorë. Rreth 12 % e popullsisë së Britanisë jeton në këtë qytet, i cili e ka dendësinë më të madhe të popullsisë në Britani, me 4. 699 banorë në 1 km2.

Është qyteti ku gjendet Qeveria qendrore e Britanisë. Ndërtesa më e gjatë në Londër është "Canary Wharf Toëer".

Londra është qyteti i parë në botë që kishte një hekurudhë nëntokësore të njohur si "Tube".

Njerëzit më të famshëm nga e gjithë bota vizitojnë mbrëtrëshën në Pallatin Buckingham që gjendet në Londër.

Londra është qytet i cili karakterizohet me mjaft elemente të veçanta, të cilat e bëjnë atë një nga qendrat më të vizituara botërore. Popullata shumënacionale, metrotë e famshme të saj, rrjeti karakteristik i autobusëve publik, qendrat tregtare dhe pallatet me një arkitekturë të shkëlqyer, janë vetëm disa nga këto elemente të cilat e bëjnë Londrën një qytet shumë tërheqës.

Pallati i Buckinghamit është shtëpia zyrtare e Mbretëreshës, pallat i cili ka qenë edhe rezidenca zyrtare e mbretërisë së Britanisë së Madhe, që nga viti 1837. Mbretëresha Viktoria ishte e para që ka jetuar në te. Ky pallat poashtu është shfrytëzuar edhe për punët administrative të mbretërisë, ndërsa në të gjenden gjithashtu edhe dhomat, ku mbretëresha pranon dhe gostit mysafirët e ftuar në saj.

Pjesa kryesore e rrjetit të transportit publik dhe një nga karakteristikat kryesore me të cilën veçohet Londra, është Undergroundi (metrotë ose hekurudhat nëntokësore) i saj, i cili në vete ngërthen 12 linja lidhëse. Ky underground që daton nga viti 1863, paraqet sistemin më të vjetër dhe më të shtrenjtë të metrove në botë. Është gjë mahnitëse se në rrjetin e Undergroundve të Londrës në ditë bëhen rreth 3 milion udhëtime, ndërsa afërsisht 1 miliardë gjatë një viti.

Rrjeti i autobusëve të Londrës është në shërbim 24 orë dhe shfrytëzohet për shumicën e udhëtimeve lokale. Çdo ditë të javës rrjeti i autobusëve bartë rreth 6 milionë pasagjerë



në mbi 700 linja të ndryshme.
Është e pamundur që ndonjë njeri të vizitojë Londrën dhe të mos parakalojë nëpër rrugën " Oxford Street" të gjatë rreth 2 km, që paraqet vendin më të ngarkuar për shoping në mbarë Evropën, përkatësisht rrugën më të gjatë të blerësve në botë, ku gjenden zyrat përfaqësuese të disa prej firmave më të njohura botërore si: "Selfridges", "John Lewis", "Marks&Spencer", etj.
Me gjithë bukuritë dhe karakteristikat e tjera, të cilat e bëjnë Londrën të veçantë, ajo gjithashtu nuk mbetet mbrapa as sa i përket ofrimit të ushqimeve të mrekullueshme. Duke ju falënderuar popullatës multikulturale e cila vjen si rezultat i llojllojshmërisë etnike të popullsisë përbërëse të saj, në Londër keni mundësi të gjeni më shumë se 60 lloje të ndryshme të kuzhinave, duke filluar nga ajo frënge e deri tek ajo japoneze. Ushqimi indian është posaçërisht shumë popullor në Londër.
Kohët e fundit është duke u zhvilluar debat mjaft i madh, nëse Londra do të duhej apo jo të merrte epitetin e "Kryeqytetit të botës". "Kundërshtar" i saj në këtë aspekt është Nju Jorku, gjithashtu qendër e njohur botërore. Fitimi i së drejtës për organizimin e lojërave olimpike verore 2012 dhe investimet që do bëhen për mbarëvajtjen e mirëfilltë të tyre, vetëm sa i japin një avantazh qytetit të Londrës. Fitoi apo jo mund të përfundojmë se Londra mbetet edhe më tej një nga metropolet kryesore botërore.

Në mesin e studentëve pjesëmarrës në këtë vizitë, ishin edhe gjashtë anëtar të organizatës "Paqja Studentore": Gëzim Qerimi-Kryetar i Parlamentit të studentëve të UP-së, Sead Ujkani-anëtar i senatit të UP-së, Shkelzen Osmani- anëtar i senatit të UP-së, Artan Spahiu- sekretar i parlamentit të studentëve, Arbër Zeka- Kryeredaktor i revistës së studentëve "Bota e Re"
Ernest Kerçeli-Kryetar i këshillit të studentëve në Fakultetin Elektros në UP
Fatbardh Dragusha - Nënkryetar i këshillit të studentëve në Fakultetin e Elektros në UP.

Përdorimi i alkoolit nga të rinjtë shqetëson BE-në

Në bazë të disa sondazheve të bëra nga "Buletini", - botim i Fakultetit Mbretëror Britanik, del se shumica e të rinjve të cilët e konsumojnë alkoolin janë nga Anglia, mirëpo kjo dukuri është bërë praktikë edhe në vendet e tjera si: Gjermani, Francë, Belgjikë...

Fitim Veliu

Problemi i pirjes së alkoolit, i cili ka përfshirë të gjithë të rinjtë e vendeve evropiane, me theks të veçantë Anglinë, është mjaft shqetësues, sidomos për faktin se këtu përfshihen të rinjtë nën moshën 15 vjeçare. Kur këtij fakti i shtohen edhe të dhënat, se konsumimi ndodh më se shumti të femrat e reja dhe ato nën moshën 20 vjeçare, kjo dukuri jep tragjedi të dyfishtë të binomit të rinj dhe të reja.
Bashkimi Evropian është institucioni më i lartë brenda të cilit inkorporohen të gjitha vendet-shtetet evropiane. Ky institucion është unik në tërësinë e veprimeve, të cilat ndërmerren për lejimin apo parandalimin e çfarëdo dukurie, e cila ka të bëjë me këto shtete. Fokusimi i BE-së deri tash ka qenë shumë evident në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, krimit të organizuar, drogës, etj.

Të rinjtë dhe alkooli

Në bazë të disa sondazheve të bëra nga "Buletini", - botim i Fakultetit Mbretëror Britanik, del se shumica e të rinjve të cilët e konsumojnë alkoolin janë nga Anglia, mirëpo kjo dukuri është bërë praktikë edhe në vendet e tjera si në: Gjermani, Francë, Belgjikë...
Disa të rinj që janë pyetur nga "Buletini" se përse e përdorin alkoolin, kanë dhënë përgjigje të njëjtë: nga egoja për të gjetur kënaqësi.
Ky hulumtim tregon se numri i fëmijëve të rritur në Britani që pinë alkool është rritur në përmasa, që brengosin njerëzit për mbrojtjen sociale e shëndetësore.
Ajo që brengos është se mosha e këtyre fëmijëve që janë shndërruar në gjysmë-alkoolist, sillet rreth 12-13 vjeç. Të tillët thonë se pinë alkool derisa e humbin vetëdijen.
Ky hulumtim që ka përfshirë 2519 fëmijë të rritur dhe adoleshent në Angli dhe Uells dhe 2389 në Skoci, po ashtu, nxjerr përfundimin se pirja e alkoolit sjell pasoja fatale në humbjen e jetëve të njerëzve. Gjithmonë, sipas këtij hulumtimi, nën ndikimin e alkoolit në vitin 1992 janë bërë 458 krime të natyrave të ndryshme.
Tani pirja e alkoolit të këta të rinj ka kaluar në shprehje dhe eksperiencë. Shumica e këtyre fëmijëve vijnë nga Uellsi, pastaj Anglia, Franca, Belgjika dhe Gjermania.
Pirja e alkoolit nga të rinjtë shkakton simptoma të ndryshme të sëmundjeve si i thati në stomak dhe në zorrë, dhe po ashtu vërehen shenja të delikuencës si vjedhje, keqtrajtim trupor dhe mashtrim etj.
Në "Buletin" thuhet se alkooli është shkaktar i 3000 rasteve të vdekjes për çdo vit në Britani. Raporti më tej thotë se britanikët shpenzojnë më shumë në alkool se sa në fëmijët e tyre. Më tej ky raport përmend faktin se, problem i alkoolit është paraqitur edhe në parlamentin britanik, ku thuhet se shpenzimet për alkool paraqesin 7, 5% të shpenzimeve të përgjithshme.
Pra, nga rreziku i këtij sindromi tragjik, nuk kalojnë më lehtë as vendet e tjera Evropiane. Në Gjermani bie fjala, përqindja e aksidenteve në trafik të shkaktuara si pasojë e konsumimit të alkoolit është rritur ndjeshëm, ndërsa në Francë dhe Belgjik mbi 60% e rasteve të incestit ndodhin për shkak ndikimit të alkoolit.
Problemi i konsumimit të alkoolit është bërë temë qendrore në instancat më të larta botërore si: qeveritë, organizatat për shëndetësi, shoqëritë civile, mediat dhe tani edhe nga Bashkimi Evropian. Organizata për Shëndetësi Botërore thotë se, në Evropë mbi 50% e rasteve në trafik vijnë si rezultat i ndikimit të alkoolit dhe mbi 80% e rasteve kriminale vijnë si shkak i alkoolit, ku sipas raportit të po kësaj organizate 99, 5% e meshkujve dhe 97, 2% e femrave, nga të cilat 95% janë vajza më të reja se 18 vjeç.

BE-ja në kërkim të ligjeve që do të ndalonin alkoolin për të rinjtë

Të gjitha vendet e BE-së janë unike, se duhen marrë masa parandalimi me ligj, të cilat do të hynin në fuqi së shpejti dhe do të sanksiononin përdorimin e alkoolit në tërësi. Është mbledhur seancë e veçantë e BE-së, ku është shprehur qëndrimi se duhet ndalur kjo dukuri. Mbetet të shihet se cilat do të jenë ato ligje, si do të aplikohen dhe deri, ku do të jetë shtrirja e tyre gjeografike, pasi që dihet se vendet e Ballkanit ndodhen jashtë BE-së, por shpresojmë që të njëjtat praktika do ti ndjekin edhe këto vende, në mënyrë që kjo dukuri të zhduket në tërësi.

PALLATI I SHTYPIT, PËRMENDORE

Gazeta Rilindja e ka paditur MSHP-në, si pasuese e Departamentit Transitor të Shërbimeve Publike, që para pesë vjetësh vendosi të nxjerrë nga mjediset e saj të punës gazetën "Rilindja" sepse këto mjedise, e shihte si të përshtatshme për institucionet e përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës



Lulzim AHMETI

A fër gjashtë vjet pas dëbimit të "Rilindjes", Pallati i Rilindjes vazhdon të mbetët si një gërmadhë, i zbrazët, si një përmendore e dështimeve të autoriteteve!

Me mbylljen dhe shkatërrimin e gazetës "Rilindja", që ishte edhe abetare e parë, me ngujimin në bunker me urdhrin-ultimatum, si alternativë të vetme e kishte hedhjen në bërllok të Arkivit të Rilindjes, të gjithë atij thesari nacional, është bërë edhe kulturocid, i cili në "Rilindje" po vazhdon edhe sot.

Pallati i Shtypit "Rilindja" dikur krenaria e Kosovës, është ndërtuar nga Ndërmarrja "Rilindja" në vitin 1977. Këtë pallat së paku zyrtarisht e menaxhon Ministria e Shërbimeve Publike (MSHP), ndonëse zëdhënësi i kësaj ministrie Avdullah Bytyqi thotë se ministria menaxhon vetëm me disa kontejnerë dhe garazhe të Rilindjes.

Sipas ligjeve në fuqi, autoritet i vetëm për menaxhim me ndërmarrjet shoqërore në Kosovë është Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM), por në rastin "Rilindja", AKM-ja, ende nuk ka ndërmarrë asgjë.

Zëvendësdrejtori i AKM-së, Ahmet Shala, ka thënë se AKM-ja është e përgatitur dhe shumë e interesuar, që sa më parë të bëhet pranim-dorëzimi i pallatit të shtypit, dhe ai të merret në menaxhim të AKM-së.

Nga ana tjetër, Behlul Jashari, kryetar i Këshillit Drejtues dhe kryeredaktor i gazetës, "Rilindja", thotë se pallati është pronë e Rilindjes. "Rilindja mundohet të kujdeset për të pjesërisht, përndryshe pallati dhe gjithë kompleksi i Rilindja, ka një truall rreth pesë hektarësh që menaxhohen kundërligjshëm nga Ministria e Shërbimeve Publike (MSHP), ndërsa, autoritet i vetëm për menaxhim është Rilindja dhe Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM)", ka thënë Jashari.

Pallati 18 katesh, ndërtesa më e lartë e Kosovës

Gazeta Rilindja e ka paditur MSHP-në, si pasuese e Departamentit Transitor të Shërbimeve Publike, që para pesë vjetësh vendosi të nxjerrë nga mjediset e saj të punës gazetën "Rilindja" sepse këto mjedise, e shihte si të përshtatshme për institucionet e përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës. "Në atë kohë, Departamenti u angazhua që gazetës t'i japë mjedise të tjera pune. Por, as pas pesë vjetësh institucionet nuk u vendosën në Pallat e as 'Rilindjes', nuk iu sigurua ambient tjetër pune", thekson Jashari.

Sipas tij, pallati 18 katesh, që është ndërtesa më e lartë e Kosovës, mbeti e zbrazët, duke u shkatërruar dhe kthyer pothuaj në gërmadhë nga 'zhveshja e brendshme', që iu bë sipas projektit që synonte t'i ndërronte destinacionin.

Më 15 shkurt 2005, Qeveria e Kosovës, vendosi të ndërpresë punimet për rinovimin e Pallatit, për shkak të çështjes pronësore të pazgjidhur. Ata, thotë Jashari, e kanë lënë Pallatin, si një gërmadhë, si një përmendore të dështimit të tyre.

Sipas Jasharit, të drejtën e menaxhimit të Pallatit të Shtypit, e ka Rilindja si ndërmarrje shoqërore, sepse ajo është financuese edhe udhëheqëse e punimeve në pallat, dhe ka të drejtën e menaxhimit me statusin që ka deri në privatizim të tij.

Në fillim të vitin 2006 gazeta "Rilindja" u lejua të rihyj në Pallatin e saj, por, mjedisi duhej të kthehej në gjendje pune dhe për këtë arsye, Këshilli Drejtues i gazetës kishte kërkuar t'i kompensohen dëmet, duke përfshirë dhe shkatërrimin e arkivit, të mbajtur për disa vite në një mjedis të papërshtatshëm, në bunkerin e errët e me lagështi.

Ky kompensim i dëmeve të "Rilindjes" sipas Jasharit, përkrahet nga AKM-ja, dhe kjo është një e drejtë e ligjshme. "Më shumë se 100 dokumente dëshmojnë të drejtën e "Rilindjes", që është edhe investuese dhe drejtuese e punimeve për ndërtimin e Pallatit të saj.

"Përkundër kërkesave, Ministria e Shërbimeve Publike, ende nuk e ka bërë pranimdorëzimin zyrtar të Pallatit të Shtypit te AKM-ja dhe Rilindja, por vazhdon që shumë pjesë dhe oborrin t'i shfrytëzojë kundërligjshëm. Ajo është vetëm duke keqmenaxhuar", thotë Jashari, duke i bërë ata fajtorë për shkatërrimin e pallatit.

"AKM-ja e ka të drejtën ligjore me menaxhimin me ndërmarrjet publike dhe është autoritet i vetëm në Kosovë, andaj

> Në fillim të vitin 2006 gazeta "Rilindja" u lejua të rihyj në Pallatin e saj, por, mjedisi duhej të kthehej në gjendje pune dhe për këtë arsye, Këshilli Drejtues i gazetës kishte kërkuar t'i kompensohen dëmet, duke përfshirë dhe shkatërrimin e arkivit, të mbajtur për disa vite në një mjedis të papërshtatshëm, në bunkerin e errët e me lagështi. Ky kompensim i dëmeve të "Rilindjes" sipas Jasharit, përkrahet nga AKM-ja, dhe kjo është një e drejtë e ligjshme. "Më shumë se 100 dokumente dëshmojnë të drejtën e "Rilindjes", që është edhe investuese dhe drejtuese e punimeve për ndërtimin e Pallatit të saj.

E DËSHTIMIT TË AUTORITETEVE

ajo duhet ta përdorë autoritetin ligjor dhe t'i dëbojë uzurpatorët, duke i detyruar me gjyq të bëjnë kompensimin e dëmeve, të cilat arrijnë vlera milionëshe", ka thënë Jashari, sipas të cilit, vetëm tenderi për ndërprerjen e punëve rreth renovimit të pallatit, Qeverisë së Kosovës i ka kushtuar afër 13 milionë euro.
Gjithashtu gazetës "Rilindja" ia kanë shkatërruar të gjithë teknikën, po ashtu edhe "Radio Rilindjes", të cilën e kanë plaçkitur në vlerë rreth 130 mijë euro, ndërsa gjithçka, që ka shpëtuar nga plaçkitja e kanë ngujuar në një "bunker" të errët me lagështi, ku është shkatërruar, edhe arkivi i Rilindjes, një pasuri e madhe kombëtare me një vlerë të pa kompensueshme. "Kjo është një kultorocid i llojit të vetë, është diçka e tmerrshme që kjo të ndodhë në Kosovë", ka shtuar Jashari.

Qeveria e Kosovës është "uzurpatore" e pallatit

Këtë shkatërrim të Pallatit të Shtypit, e ka filluar Departamenti i Shërbimeve Publike, duke e vazhduar Qeveria e Kosovës, gjegjësisht MSHP-ja. Jashari thotë se, Qeveria e Kosovës është "uzurpatore" për faktin, se me asnjë ligj ajo nuk ka të drejtë të menaxhoj dhe të uzurpojë pronat shoqërore.
Sipas kryetarit të Këshillit drejtues dhe kryeredaktorit të "Rilindjes", Behlul Jashari, të gjithë ata që kanë bërë këto shkatërrime duhet të bëjnë kompensimin, dhe gazeta tradicionale e Kosovës "Rilindja", duhet ta ruajë emrin dhe traditën.
I pyetur se pse Pallati i Shtypit, nuk jepet me qira deri në privatizim, Behlul Jashari thotë se për fat të keq pallati është i shkatërruar deri në atë masë sa që nevojitet një investim shumë i madh për ta sjellë në gjendje të përdorshme.
"Ne kërkojmë që sa më shpejtë të bëhet pranim-dorëzimi i Pallatit të Shtypit nga i Ministria e Shërbimeve Publike, te menaxhuesit ligjor, përkatësisht AKM-ja dhe Rilindja, dhe pas një auditimi, dhe vlerësimi të dëmeve që duhet të kompensohen, pallati të kthehet në gjendjen siç ka qenë, dhe të hyjë në procesin e privatizimit. Shpresoj se qeveria e re, do ta ketë parasysh që "Rilindjen", ta kthej në rrugë ligjore aty ku e ka vendin.

Rasti "Rilindja", për Libër të Ginisit

Sipas Jasharit, "Rilindja" është e vetmja gazetë e përditshme e botës, që gjatë tërë një viti del vetëm një ditë!. Ajo do të dalë edhe këtë vit historik të ndërrimit të qeverisë, siç bëri edhe më 2003, dhe 2006, dhe si e tillë mund të jetë rast edhe për Libër të Ginisit. "Është e vetmja gazetë e përditshme e botës, që gjatë tërë një viti del vetëm një ditë, për shkak të shkatërrimit të saj, të ngujimit të saj, të dëbimit të saj, shkeljes më të rëndë në botën e lirë, e demokratike të së drejtës dhe lirisë së shtypit, të drejtës njerëzore dhe ekzistenciale!", ka cekur ai.

Pak histori...

Historiku i gazetës "Rilindja", është sa i lavdishëm, aq i dhimbshëm për kohën.
Numri i parë i gazetës Rilindja ka dalë në Prizren më 12 shkurt 1945, në frymën e vendimeve të Kuvendit të Bujanit, me shkronjat shqipe prej plumbi që u sollën nga Tirana. Rilindja është gazeta që mbijetoi edhe në kohët më të vështira të Kosovës, madje edhe kur u ndalua dhe u mbyll me dhunë nga regjimi i Milloshevigit, ajo nuk e ndërpreu punën: gazetarët dhe punonjësit e tjerë të saj, që nga 18 janari 1991, filluan të nxjerrin gazetën "Bujku" e cila në të vërtetë ishte vetë gazeta "Rilindja". Ndërkohë, gjatë kësaj periudhe, gazeta me emrin e vet "Rilindja" botohej në Zvicër dhe në Tiranë, dhe kishte tirazh mjaft të madh.
Para se të mbyllej në vitin 1990, për "Rilindjen" punonin më se 200 gazetarë e punonjës të tjerë, ndërsa tirazhi arrinte deri 70 mijë kopje të shitura në ditë. Rekordin e tirazhit ajo e arriti në një numër festiv të vitit të ri në vitet e '80-ta, kur u shtyp në 240 mijë kopje. Në atë kohë ajo shpërndahej edhe në Maqedoni, në Preshevë, Mal të Zi, dhe në shumë qytete të ish-federatës jugosllave, ku jetonin a punonin shqiptarët.
Më 7 gusht të vitit 1990, regjimi i Milloshevigit ndaloi me dhunë veprimtarinë e ndërmarrjes gazetare botuese "Rilindja", me ç'rast është ndërprerë edhe dalja e rregullt e gazetës të përditshme "Rilindja". Mirëpo, kolektivi i gazetës duke bërë përpjekje që ta mposht terrin informativ të krijuar nga regjimi i dhunshëm i Milloshevigit, një muaj më vonë fillon me botimin e gazetës "Bujku" që kishte tiparet e "Rilindjes". Më pas, "Rilindja" vazhdon të botohet në Zvicër deri në prag të luftës në Kosovë. Gazeta "Bujku" në vitin 1998 është ndërprerë për shkak të gjendjes së keqe financiare. Gjatë luftë "Rilindja" është botuar në Shkup prej 2 ose 3 numrave, për tu aktivizuar përsëri në Pallatin e Shtypit menjëherë pas përfundimit të luftës. Më 20 korrik 1999 del numri i parë i pas luftës i gazetës "Rilindja".
Dhe kjo gazetë e përditshme në gjuhën shqipe që ishte pioniere e gazetarisë në Kosovë pati fatin e keq, sepse me vendimin e OSBE-së Pallati i Shtypit u shpronësua duke u përvetësuar nga OSBE-ja.

Dialogu ndërfetar te shqiptarët

Feja në përgjithësi ndër shqiptarë si në të kaluarën ashtu edhe tani asnjëherë nuk ka qenë në përpjekjeje për ta legjitimuar veten e saj si doktrinë fetare, por ajo gjithherë ka luftuar si edhe në ditët e sotme për ruajtjen e kombit si dhe integrimin e saj në strukturat më të larta në familjen e madhe evropiane.
Të tri fetë të cilat sot janë aktuale, gjithherë janë konsideruar si shtylla të forta që kanë ndihmuar mos të shemben para çdo sunduesi apo tirani

Emine A. VEZAJ

Do të ishte pak e çuditshme për shqiptarët ballkanas sikur të pyetej ndonjëri prej tyre se cilës përkatësi konfesionale i përket, pasi që të gjithë bashkëjetojnë dhe bashkëveprojnë së bashku pa qenë inferiorë në asnjë aspekt.
Kjo ndodh vetëm me shqiptarët e Ballkanit. Nga një shqiptar qoftë ai i përkatësisë islame, katolike apo edhe ortodokse është normale të dëgjoshë nga fjalori i tij fjalë të besimit islam apo edhe atij katolik.
Një shqiptar i besimit Islam përdor fjalën "O Zot", në ndërkohë që edhe një katolik përdor frazat "Allah Allah", "InshaAllah" si edhe të tillë që përdorin edhe përshëndetjen Islame "Selam alejkum" dhe pa u keqkuptuar ndër vete asnjëherë; por edhe tjetra se te një shqiptar mund të hasësh në emra me të cilët emërtohen besimtarët islamë, por edhe ata katolikë. Të tillë mund të përmend emrat: Kamber, Hajdar për një katolik ndërkaq, Robert për një mysliman.
Për shqiptarët nuk është aspak befasues edhe ky realitet, kur një shok i tij katolik hyn në xhami apo edhe kur një mysliman i bashkohet shokut të tij në festën e krishtlindjeve.
Besimtarët e të dyja konfesioneve pa asnjë fanatizëm festojnë të dy festat si atë të Bajramit por edhe atë të Krishtlindjeve, madje ato festohen së bashku në një ambient, shpesh edhe familjar.
Krejt e njëjta gjë ndodh edhe në festën e Pashkëve dhe anasjelltas festa e Bajramit, sidomos kjo qartë vërehet kur është fjala në familjet e përziera për nga besimi. Për familjet që jetojnë së bashku në një shtëpi që kanë çdo gjë të përbashkët, përpos besimit, sepse një pjesë prej tyre janë myslimanë, ndërsa pjesa tjetër katolikë.
Janë aktuale rastet kur një grua katolike gjatë muajit të Ramazanit qëndron zgjuar për ta përgatitur syfyrin për familjarët e tjerë myslimanë, por edhe familjarja tjetër kur shërben për festë të Pashkëve.
Shkas nga kjo frymë toleruese dhe bashkëjetese me jep edhe shembulli i një familje me besim të përzier ku një vëlla të jetë i një besimi tjetër, kurse tjetri në besim tjetër. Rast të ngjashëm të kësaj laramanie kemi në fshatin Zhegër të Gjilanit, nga të cilët dy prej vëllezërve janë shkolluar njëri për prift, tjetri për hoxhë.
Në këtë tolerancë, kuptohet, se ndikim kanë fetë, pra mësimi i tyre, sipas të cilit, të gjithë njerëzit janë të barabartë para Zotit, pra në instancë të fundit ata janë vëllezër, dhe si të tillë duhen të kenë dashuri dhe të jenë respektues ndaj besimit të secilit. Zaten kjo është edhe pikëpamja e fesë e cila predikon bashkimin e njerëzimit.
Së këndejmi, Kur'ani thekson vazhdimisht unitetin e njerëzimit dmth. ata vijnë nga të njëjtët prindër: "Njerëzit nuk ishin tjetër pos të një feje, por u përçanë..." (10:19)...
Kurani e pranon realitetin e ndryshimit dhe diversitetit brenda njerëzimit. Ai të jep përshtypjen se larmia është pjesë e planit hyjnor: "Sikur të dëshironte Zoti yt do t'i bënte njerëzit të një feje...". (11:118)



Koekzistenca trikonfesionale ndër shqiptarë, e verifikuar ndër shekuj

E çuditshme, por e vërtetë. Koekzistenca trikonfesionale ndër shqiptarë, e verifikuar ndër shekuj, me dialog dhe paqe edhe me besimtarët e tjerë me një ekumenizëm dhe dialog shembullor, është shtyllë e qytetërimit shqiptar. Kjo dukuri padyshim se nuk ka ardhur aq lehtë, megjithëse mund të këtë pasur edhe faza kur urrejtja ka qenë e pranishme, por marrë në përgjithësi toleranca fetare ndër shqiptarë konsiderohet si njëra ndër epitetet më të pasura që përmban ky popull.
Në Kosovë ekzistojnë tre komunitete të konsiderueshme fetare. Komuniteti mysliman, katolik dhe ortodoks; dhe këto komunitete me kohë kanë ruajtur dialogun ndërfetar. Gjithsesi, dialogu ndërfetar te shqiptarët në Kosovë mund të përmendet si një fakt që ka gjallëruar prej kohësh dhe ende është aktual.
Edhe toleranca shqiptare ndaj popujve të tjerë është dhuratë kuranore, sepse evroperëndimorët nuk e kanë. "Nuk ka përparësi arabi ndaj joarabit as i bardhi ndaj të ziut përveçse në dronë dhe devotshmërinë ndaj Zotit" (Hadith).

Si kanë arritur shqiptarët deri këtu për ta ruajtur këtë dialog?

Shqiptarët, ashtu sikurse edhe popujt e tjerë të botës, kanë fetë e tyre; atdheun, kombin, gjuhën dhe historinë e tyre. Për shkak të pozitës strategjike të vendit të tyre, si urë që lidh Lindjen me Perëndimin, nëpër trojet shqiptare gjatë historisë kanë kaluar shumë ushtri të perandorive të ndryshme.
Për këtë ata pësuan edhe në aspektin kombëtar, fetar e kulturor.
Siç na mëson historia, të parët tanë në aspektin fetar kaluan nga paganizmi në krishterim dhe, më në fund, në islamizëm. Kështu që në kohën e sotme, shumica dërrmuese e shqiptarëve u përkasin fesë Islame dhe pjesa tjetër asaj të krishterë me dy ritet, atij lindor-ortodoks dhe atij perëndimor-katolik.
Mr. Qemajl Morina, në një shkrim të titulluar "Mbi fenë, atdheun dhe kombin", ka vlerësuar se falë vetëdijes së tyre të lartë, si dhe interpretimit të drejtë të misionit të fesë nga ana e prijësve fetarë, ndër shqiptarë nuk pati asnjëherë përçarje në baza fetare. Secili prej tyre me liri të plotë e predikonte dhe e praktikonte fenë e vet, e kur atdheut i kanosej rreziku nga armiqtë e jashtëm, ata të gjithë ishin unikë në mbrojtje.
Feja në përgjithësi ndër shqiptarë si në të kaluarën edhe tani, asnjëherë nuk ka qenë në përpjekje për ta legjitimuar veten e saj si doktrinë fetare, por ajo gjithherë ka luftuar si edhe në ditët e sotme për ruajtjen e kombit si dhe integrimin e saj në strukturat më të larta në familjen e madhe evropiane.
Të tri fetë të cilat sot janë aktuale, gjithherë janë konsideruar si shtylla të forta që kanë ndihmuar mos të shemben para çdo sunduesi apo tirani. Shembuj të tillë kemi kur feja krishtere ka ndihmuar mbijetesën në lashtësinë romake, ortodoksizmi në atë bizantine, si dhe feja Islame që konsiderohet një shtyllë shumë e fortë e mbijetesës së shqiptarëve nga asimilimi latin, grek e sllav.
Kjo formulë e koekzistëncës në mes feve mund të konsiderohet si një lidhjeje e fortë e cila krahas besimit lidh edhe atdhetarizmin, por më shumë edhe si një lidhjeje bashkëjetese me fqiun në rrethanë lufte dhe paqeje. Jo vetëm kaq, por shqiptarët janë i vetmi popull në botë që përjetoi sanksionim me kushtetutë të mohimit të ushtrimit të kultit.
Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, në Shqipëri pushtetin e marrin komunistët, të cilët do ta zyrtarizojnë ateizmin si ideologji të tyre për të luftuar deri në ekstrem polimonoteizmin fetar, që me shekuj kishte mbizotëruar në shtetin shqiptar. Shqiptarët prej 1976 jetuan si ateistë. Gjithashtu duhet përmendur edhe faktin se për fat të keq kjo frymë ateizmi ishte përhapur edhe në Kosovë, në mënyrë të veçantë, mes inteligjencës. Si rezultat i kësaj ishte që nga kjo periudhë të dalin edhe gjenerata të cilat ishin të edukuara në frymën ateiste dhe që kur pyeteshin për përkatësin fetare të tyre si kartë identifikimi përdornin me të madhe sintagmën e njohur të rilindësit tonë të njohur Vaso Pasha "se feja e shqiptarit është shqiptaria", e cila ishte thënë në një moment të caktuar që kishte për qëllim mobilizimin e shqiptarëve pa dallim feje apo krahine kur ishte në pyetje mbrojtja e atdheut. Madje një konstatim të tillë përfundon edhe akademik Mark Krasniqi: "Këto vargje shumëkush i keqkuptoi si shprehje të mendimit ateist, antifetar. Poeti ynë ka qenë besimtar katolik dhe patriot, ai nuk ishte kundër fesë, por ishte i mendimit se për shqiptarët sikurse edhe te popujt e tjerë mbi të gjitha duhet të jetë interesi kombëtar, duhet ta duam kombin me një dashuri të ngritur në shkallën e dashurisë ndaj religjionit dhe feja mos të jetë element ndasie në asnjë mënyrë në mes të shqiptarëve, por kusht i vetëm për ekzistencën kombëtare shqiptare", ka thënë Krasniqi.
Pas gjithë këtyre trazirave që ndodhën në mesin e shqiptarëve, mbetet që marrëdhëniet ndërfetare për ta mos të reduktohen vetëm te dialogu mes feve monoteiste, por tashmë te dialogu i fesë dhe jo fesë gjithashtu, mes besimtarit dhe ateistit. Tashmë kjo tregon edhe një frymë më të gjerë mirëkuptimi mes pjesëtarëve të fesë, tashmë në frymë bashkëjetese edhe me atë që beson, por edhe atë që nuk beson.
Rrjedhimisht është fakt të thuhet, se dialogu fetar dhe kuptimi ndërfetar është i qenësishëm në mesin e shqiptarëve, por duhet bërë çmos që ta ruajmë dhe kultivojmë edhe më tutje këtë frymë toleruese me komshinjtë tanë me të cilët takohemi, bisedojmë dhe ndajmë ndonjë pjesë të ditës bashkë me ta.
Si nga e kaluara që kemi ruajtur këtë frymë bashkëjetese, duhet që edhe tani institucionet tona fetare dhe ato edukativo-arsimore ta fusin te njeriu ndjenjën e dashurisë, në radhë të parë për Zotin, e më pas edhe për Kombin, Atdheun, edukatë kjo e mirëfilltë fetare e familjare, sepse pa një edukatë të tillë nuk mund të ketë as Komb e as Atdhe. Të parët tanë në të gjitha periudhat e historisë bashkuan të gjitha këto elemente duke çmuar edhe fenë, atdheun, gjuhën dhe kombin.
Feja Islame është fe e paqes dhe dialogut, ne shqiptarët ballkanas kemi ditur ta ruajmë këtë amanet edhe me fqinjët tanë të krishterë e ortodoks. Këtë precedent tonin le ta ndjekin edhe bashkëjetuesit tanë, ngaqë këtë e kanë edhe shembull nga vet kleri i tyre Papa Gjon Pali i II-të, tashmë i ndjerë, kur vizitoi xhaminë Emevite në Damask.
Pa dashur të hyj në hak të lexuesit në interpretim të drejtë të asaj që desha të përfundoj në këtë punim, do të sjellë edhe atë që deklaroi Mario Scialo, kryetar i komunitetit mysliman të Italisë, i cili tha se: "Edhe Papa Gjon Pali i II-të në fillim ishte më i ngurtë, por më vonë u bë Papa i parë që vizitoi një xhami zyrtarisht. Kjo ndodhi në vitin 2001, kur Papa Gjon Pali vizitoi xhaminë Emevite në Damask. Të shpresojmë se edhe Papa Benedikti XVI do ta ndryshojë qëndrimin e tij dhe, për hir të Fjalës së Vërtetë, do të nisë dialogun me myslimanët dhe do t'u kërkojë falje atyre për krimet kryqtare të Mesjetës. E nëse nuk dëshiron të ballafaqohet me një sfidë të këtillë, ne myslimanët për këtë e kemi përgjigjen kaherë: "Ju keni fenë tuaj (së cilës i përmbaheni), e unë kam fenë time (së cilës i përmbahem)". (Kur'an, 109/6).

> Shkas nga kjo frymë toleruese dhe bashkëjetese më jep edhe shembulli i një familjeje me besim të përzier, ku një vëlla të jetë i një besimi tjetër, kurse tjetri në besim tjetër. Rast të ngjashëm të kësaj laramanie kemi rastin e fshatit Zhegër të Gjilanit, në një familjeje të këtij fshati dy prej vëllezërve janë shkolluar njëri për prift, tjetri për hoxhë.

Reflektime ndërkombëtare për Kosovën

PËRFUNDOJNË PA SUKSES EDHE NEGOCIATAT SHTESË

Demir RESHITI

Bisedimet shtesë për statusin e Kosovës të ndërmjetësuara nga treshja ndërkombëtare kanë përfunduar pa ndonjë rezultat. Gjatë muajit nëntor janë mbajtur tri takime: më 5 nëntor në Vjenë, më 20 nëntor në Bruksel dhe në Baden afër Vjenës nga data 26-28 nëntor. Pas takimit të fundit që ka zgjatur tri ditë, palët negociuese dhe treshja ndërmjetësuese kanë pranuar se edhe ky raund negociatash ka përfunduar me qëndrime diametralisht të kundërta ndërmjet palëve.

Për Kosovën më 19 nëntor kanë diskutuar në Bruksel edhe ministrat e Jashtëm të BE-së, kanë diskutuar në Bruksel, për statusin e ardhshëm të Kosovës, prej nga është informuar se mbi 20 shtete anëtare të BE-së e mbështesin njohjen e pavarësisë së Kosovës.


Ndërkohë, SHBA-ja dhe vendet kryesore të Evropës me përjashtim të Rusisë, kanë vazhduar me deklaratat e tyre pro pavarësisë së Kosovës...

Në vazhdim po e paraqesim një kronologji të ngjarjeve dhe deklaratave më të rëndësishme lidhur me Kosovën, gjatë muajit nëntor 2007.

(2 nëntor) Moska: Kosova një kohë të gjatë të mbetet nën kontrollin e OKB-së

Moskë-Moska zyrtare është duke menduar rreth propozimit që Kosova një kohë të gjatë të mbetet nën kontrollin e Kombeve të Bashkuara, shkruan e përditshmja ruse "Vreme Novosti", duke u thirrur në burime të paemëruara të Kremlinit.

(5 nëntor) Në Vjenë, mbahet edhe një raund i bisedimeve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit


Frank-Walter Steinmeier

Vjenë- Në Vjenë, është mbajt edhe një raund i bisedimeve ndërmjet delegacionit të Kosovës dhe atij të Serbisë, me ndërmjetësimin e Treshes ndërkombëtare, e cila kishte paraqitur një kornizë prej 14 pikash. Anëtari i Treshes, Wolfgang Ischinger, ka theksuar se plani 14 pikësh do të mbetet bazë për negociatat e mëtejme, që vazhdojnë në Bruksel, më 20 nëntor. Por, siç raporton agjencia 'Reuters', delegacioni i Serbisë e ka hedhur poshtë këtë propozim, duke e vlerësuar si "tërësisht të papranueshëm".

(6 nëntor) Zgjidhja e statusit të Kosovës sfida kryesore e Komisionit Evropian

Bruksel-Komisioni Evropian publikon raportin vjetor për vendet e Ballkanit Perëndimor. Zgjidhja e statusit të Kosovës është identifikuar si sfida kryesore. Komisioni Evropian ka shprehur vërejtje për korrupsionin, luftën kundër krimit të organizuar, trafikimin e qenieve njerëzore dhe mosfunksionimin e gjyqësisë në Kosovë.


Dora Bakoyannis

(8 nëntor) McCormack: SHBA-ja për zgjidhje të afërt të statusit

Uashington- Shtetet e Bashkuara punojnë ngushtë me palët e përfshira në bisedimet për statusin e Kosovës, me qëllim që kjo çështje të zgjidhet në një të ardhme të afërt, ka thënë zëdhënësi i Departamentit të shtetit, Sean McCormack.

(10 nëntor) Steinmeier: Evropa duhet të jetë unike në çështjen e statusit të Kosovës

Pragë- Evropa duhet të jetë unike në çështjen e statusit të Kosovës, ka deklaruar ministri i jashtëm i Gjermansië, Frank-Walter Steinmeier. Ai këto komente i ka bërë në Pragë, pas takimit me homologun e tij çek, Karel Schwarzenberg.

(12 nëntor) Bakoyannis: Greqia kërkon qëndrimi unik evropian për statusin e Kosovës

Athinë-Greqia angazhohet për një zgjidhje të çështjes së Kosovës që do sjellë stabilitet në rajon, ka deklaruar shefja e diplomacisë greke, Dora Bakoyannis. "Na duhet të kërkojmë harmonizimin sa më të madh të mundshëm dhe duhet të formulohet qëndrimi unik evropian për një çështje evropiane siç është statusi i ardhshëm i Kosovës, ka thënë Bakojanis pas takimit me përfaqësuesin rus në treshen ndërkombëtare Aleksandër Botsan Harcenko.



Sean McCormack

(14 nëntor) Lavrov: Është kundërproduktive të pohohet se pavarësia Kosovës nuk ka alternativë

Lubjanë-Bashkësia ndërkombëtare duh-et t'u lejojë Serbisë dhe Kosovës që vetë të arrijnë një zgjidhje për statusin e Kosovës, pa caktuar ndonjë datë për përfundimin e negociatave, tha ministri i Jashtëm i Rusisë, Sergei Lavrov. "Është kundërproduktive të pohohet se në kërkim për statusin final të Kosovës, pavarësia nuk ka alternativë", ka thënë Lavrov në një konferencë shtypi me homologun slloven, Dimitrij Rupel.

(15 nëntor) McCormack: Qëndrimi ynë për Kosovën nuk ka ndryshuar

Uashington-"Qëndrimi ynë për Kosovën nuk ka ndryshuar", tha zëdhënësi i Departamentit amerikan të shtetit, Sean McCormack, duke komentuar idenë e të dërguarit të Bashkimit Evropian, Wolfgang Ischinger, për zgjidhjen neutrale të statusit të Kosovës. "Mund të them se qëndrimi ynë ndaj Kosovës nuk ka ndryshuar...", ka thënë McCormack.


(17 nëntor) McCormack: Propozimet e BE-së për Kosovën përputhen me

qëndrimin e SHBA-së
Uashington- Propozimet rreth zgjidhjes së statusit të Kosovës, që i dërguari i BE-së, Wolfgang Ischinger, i paraqiti gjatë vizitës në Uashington, janë plotësisht konsistente me politikën e Shteteve të Bashkuara, ka deklaruar zëdhënësi i Departamentit të shtetit, Sean McCormack... "Ne punojmë ngushtë me BE-në dhe mendoj se ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian ka vizion të njëjtë se në çfarë drejtimi duhet të shkojë kjo çështje", ka thënë McCormack.

(19 nëntor) Murphy: Më shumë se 20 shtete anëtare të BE-së e mbështesin njohjen e pavarësisë së Kosovës
Bruksel-Ministrat e Jashtëm të BE-së, kanë diskutuar në Bruksel, për statusin e ardhshëm të Kosovës. "Kosova duhet ta ketë pavarësinë e saj, por ajo nuk duhet të jetë pavarësi e njëanshme e pa menaxhuar. Shpallja duhet të bëhet në koordinim me bashkësinë ndërkombëtare", ka deklaruar para takimit ministri britanik për Evropën, Jim Murphy.
Murphy deklaroi se kjo është "një sfidë evropiane", zgjidhja e së cilës "nuk mund të kërkohet nga Shtetet e Bashkuara". Ai tutje tha se më shumë se 20 shtete anëtare të BE-së e mbështesin njohjen e pavarësisë së Kosovës, por, sipas tij, nuk duhet harruar se "BE-ja ka 27 anëtarë".

(20 nëntor)
Bruksel- Në Bruksel ka përfunduar pa rezultate konkrete raundi i radhës i bisedimeve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit me ndërmjetësimin e Treshes ndërkombëtare.


(21 nëntor) Rehn: Statusi i ardhshëm i Kosovës duhet të vendoset shpejt dhe të jetë i qartë
Bruksel-Statusi i ardhshëm i Kosovës duhet të vendoset shpejt dhe të jetë i qartë, për shkak të stabilitetit dhe zhvillimit të rajonit, ka thënë komisionari për zgjerim i BE-së, Oli Rehn, duke folur para Këshillit për Politikë të Jashtme të Parlamentit Evropian.


Jim Murphy

(24 nëntor) BE-ja parasheh 160 milionë euro për misionin në Kosovë
Bruksel- Bashkimi Evropian ka paraparë të paktën 160 milionë euro për misionin në Kosovë. Diplomatët në Bruksel thanë se "të paktën 160 milionë euro do të nevojiten" për shpenzimet e misionit të BE-së në Kosovë, ku do të angazhohen 1500 deri 2000 njerëz.

(25 nëntor) Holbrooke: SHBA-ja dhe shumica e vendeve të BE-së, shpejtë pas 10 dhjetorit do ta njohin pavarësinë e Kosovës
Uashington- Ish i dërguari amerikan për Ballkanin, Richard Holbrooke në një shkrim për të përditshmen "Washington Post" ka vlerësuar se SHBA-ja dhe shumica e vendeve të BE-së, shpejtë pas 10 dhjetorit do ta njohin pavarësinë e Kosovës, por jo edhe Rusia.

(26 nëntor) Lavrov e ka akuzuar Perëndimin se po nxit një "klimë psikologjike të pritjes se Prishtina duhet të fitojë pavarësinë"
Moskë - Ministri i Jashtëm rus Sergei Lavrov e ka akuzuar Perëndimin se po nxit një "klimë psikologjike të pritjes se Prishtina duhet të fitojë pavarësinë". Ai e ka ripërsëritur kundërshtimin e Moskës ndaj njohjes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës, duke thënë se kjo do të ishte precedent për vendet tjera, përfshirë ato të ish-Bashkimit Sovjetik.


Richard Holbrooke

(28 nëntor) Përfundojnë pa sukses bisedimet Prishtinë- Beograd
Vjenë - Në Baden afër Vjenës kanë përfunduar bisedimet për status ndërmjet delegacionit të Kosovës dhe atij të Serbisë, me ndërmjetësimin e Treshes ndërkombëtare. "Ne na vjen keq që delegacionet nuk ishin në gjendje të gjejnë zgjidhje të pranueshme për të dy palë, përkundër punës së tyre të madhe dhe shqyrtimit të kujdesshëm të opsioneve", ka thënë anëtari amerikan i Treshes, Frank Wisner. Ndërkaq përfaqësuesi i Bashkimit Evropian në Treshen ndërkombëtare, Wolfgang Ischinger ka theksuar se "të dy palët na e kanë bërë të qartë se ata janë të përkushtuar për t'ju shmangur dhunës dhe ky përkushtim për paqe duhet të vazhdojë".



Hillary Clinton

(29 nëntor) Amado: OSBE-ja duhet ta ripërtërijë misionin e saj për një vit
Madrid - Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kanë kërkuar nga OSBE-ja që ta vazhdojnë misionin e saj në Kosovë dhe kanë ftuar Rusinë që të mos e realizojë kërcënimin për tu tërhequr nga Marrëveshja për kontrollin e armatimit. Ministri i jashtëm i Portugalisë, Luis Amado, vendi i të cilit e kryeson presidencën e Bashkimit Evropian, ka thënë se OSBE-ja duhet ta ripërtërijë misionin e saj për një vit "pavarësisht nga përfundimi i negociatave aktuale për Kosovën".

(30 nëntor) Hillary Clinton mbështet pavarësinë e Kosovës
Nju Jork - Senatorja amerikane Hillary Clinton ka deklaruar se mbështet fuqishëm njohjen e pavarësisë së Kosovës nga Shtetet e Bashkuara nëse qeveria në Prishtinë vendos të shpall pavarësinë. "Derisa Rusia kërcënon me veto në Këshillin e Sigurimit, ne duhet të jemi të gatshëm që të mbështesin fuqishëm vullnetin e shumicës në Kosovë. Nëse qeveria në Prishtinë vendos të shpall pavarësinë, fuqimisht do të mbështes njohjen nga ana e Shteteve të Bashkuara të pavarësisë dhe do të ftojë Bashkimin Evropian të bëjë të njëjtën gjë", ka deklaruar Hillary Clinton.

Përdhunimi i shqipes në mbishkrime



Osman D. GASHI


Çdo ditë e më tepër jemi dëshmitar të përdhunimit që po i bëhet gjuhës shqipe nga individë dhe subjekte të ndryshme.

Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe, nuk zbatohen as në tabelat e institucioneve e të mos flasim për mbishkrimet e lajmërimet e tjera që ndesh rrugës. Një tmerr i vërtetë gjuhësor. Megjithatë, në sy bien sidomos mbishkrimet publike, qofshin ata të institucioneve private apo publike. Shkronja "ë" dhe shkronja "ç" nuk përdoren drejt. Në të shumtën e rasteve shkronja 'q' zëvendësohet gabimisht me "ç", dhe anasjelltas...


Më poshtë po i paraqesim disa nga gabimet e shumta që i fokusuam me syrin e fotoaparatit tonë nëpër rrugët e kryeqytetit.



'shumic' e 'pakic' shkruhet në vend të 'shumicë' e 'pakicë'.



Gabojnë edhe studentët! Do të duhet të ishte "Nëse ti hesht, Pavarësia prapë do të shtyhet..."



Ka ndoshta ndonjë arsyetim për firmat private të kenë gabime në reklama, ama kjo kur ndodh në institucione, nuk di se si shpjegohet.
Ky mbishkrim gjendet në parkingun e gjykatës komunale në Prishtinë. Siç po shihet në vend të '...policisë' është shkruar 'policis'!



Një mori gabimesh t'i zen syri në reklamën e një dyqani që tregton mallra kineze në qendër të Prishtinës! Është e shkruar 'qanta' në vend të 'çanta', 'të mbrendshme' në vend se 'të brendshme', 'qarshafa' në vend të 'çarçafa'.



Dyqani "T&T" që shet veshje për gra që janë në shtatzëni, e kanë shkruar gabimisht "shtatzani".



Duhet të shkruhet 'dhëmbëve', e jo "dhëmbëve"...



Dy gabime në një mbishkrim fare të shkurtër. Shkruhet "frizer" e jo "ffrizer", pastaj "meshkuj" e jo "mashkuj".



Duhet të dihet nga çdokush, pas shenjës së pikësimit duhet të ketë një hapësirë. Dhe ndajfolja përballë nuk përfundon me shkronjën 'll', 'përball'.




Mungon shkronja 'ë', do të duhet të ishte servis i çelësave, jo çelsave.




"jepet" me qira e jo "ipet'!



Kur në reklamë ka gabime në gjuhën amtare, mos të flasim për gjuhë të huaj! Në gjuhën tonë emri ndriçim shënohet me 'ç' e jo me 'q', edhe emri accessoires duhet te shkruhet accessories.



Në shqip shkruhet "mushkëri", e jo 'mushkeri', dhe 'dispanseri' e jo 'dizpanzeri'.



Ështe shkruar 'mbules' e jo 'mbulesë', pastaj emri 'kauq' nuk është shqip...

Për fund të themi se mbrojtja e gjuhës u përket, në radhë të parë, shtetit dhe institucioneve shtetërore e shoqërore që varen a lejohen prej tij. Në çdo vend të qytetëruar ka ligje për mbrojtjen e gjuhës, dhe shteti merr masat e nevojshme për studimin e mësimin e saj në shkolla, si dhe për zbatimin e drejtshkrimit të njësuar në të gjithë praktikën shkrimore e botuese zyrtare.

Çdo subjekt, qoftë shtetëror, qoftë privat, duhet të zbatojë rregullat e alfabetit të gjuhës shqipe në mbishkrimet publike. Në çdo vend të qytetëruar, bëhet kjo. Madje, në Francë vendosen edhe gjoba, nëse përdoren fjalë të huaja ose bëhen gabime drejtshkrimore"

Në 800 vjetorin e lindjes së Xhelaludin Rumiut

Shkolla filozofike islame Mevlevije

Me rastin e shënjimit të 800 vjetorit të lindjes të sufiut, njëherësh poetit të njohur iranian Xhelaluddin Rumiut, të cilin në vitin 2007, UNESCO e ka shpallë vit të Rumiut, për lexuesit tonë kemi zgjedhur këtë kontribut nga vepra e autorit boshnjak Xhemal Qehajiq

Themelues i këtij tarikati konsiderohet Xhelaluddin Rumiu, i quajturi "Mevlana", sipas të cilit, ky tarikat mori edhe emrin Mevlevi.

Xhelaluddin Rumiu nuk themeloi e as që e kishte ndërmend të themelojë tarikat të ri, pavarësisht faktit se atij i vishet ky veprim, por ai personalisht ndoqi rrugën e babait të vet Bahauddin Veledit, kurse pas vdekjes së tij ky ishte nxënës i mësuesit të babait të tij Burhanuddin Muhakkik Tirmizij. Mirëpo, nxënësit dhe pasuesit e Mevlanas, pasi që ky ndërroi jetë, formuan një grup të veçantë dhe zhvilluan e kultivuan disa tradita dhe rituale periferike dhe në këtë mënyrë themeluan tarikatin (vëllazërinë) i cili në Perëndim është i njohur me emrin "Dervishët vallëzues".

Rumiu kishte averzion. Atij nuk i pëlqente imitimi dhe nënshtrimi verbërisht jetës religjioze. Si për ironi të fatit të tij, ai u bë viktimë e asaj forme kundër të cilës luftoi vazhdimisht me sa pati fuqi. Vallja ekstatike e Mevlanas, e përcjell spontanisht me këngë lirike, ishte shprehje e njëfarë shqetësimi të thellë shpirtëror. Mevlevijët e adaptuan këtë shprehje të jashtme si praktikë fetare me qëllim që t'i ngjallin emocionet religjioze, duke besuar, me vetëdije jo të plotë, se adaptimi i shprehjes së emocioneve fizike do të krijojë emocion të mirëfilltë.

Tarikati Mevlevi ka kaluar rrugë bukur të gjatë në zhvillimin e vet deri në formën përfundimtare – duke filluar nga vdekja e Mevlanas deri në gjysmën e parë të shekullit 15. Me ndërtimin e tyrbes së Rumiut nga ana e begut selxhuk Alaudin Kajseri (vdiq me 1284) formohet qendra ku mblidheshin ithtarët Mevlanas. Merita shumë të mëdha për konstituimin e tarikatit Mevlevi ka pasur djali i Rumiut, Sulltan Veledi (vdiq më 1312), një njeri me aftësi të jashtëzakonshme në organizimin e masës, i cili u përpoq që ideologjisë së Mevlanas t'ia japë formën e tarikatit...

Sulltan Veledi dërgon mëkëmbës (halife) në Amasja, Kirshehir dhe Arzingjan në të cilat vende themelon teqe që janë të lidhura me qendrën, dhe kjo është dëshmi e parë se ka filluar të përhapet tarikati. Të njëjtin kurs ndoqi edhe djali i Sulltan Veledit, Ulu Arif Çelebi (vdiq me 1320), në kohën e të cilit u themelua nga një zavije në çdo vend të përshtatshëm. Mirëpo, në kohën e Divan Mehmed Çelebiut (vdiq pas vitit 1544) themelohen zavijet jashtë Anadollit – në Siri, Irak, Iran, Egjipt, Algjer dhe rajone të tjera. Pikërisht në këtë periudhë – fundi i shekullit 14 deri në gjysmën e parë të shekullit 15, tarikati Mevlevi mori formën përfundimtare, sa i përket traditave dhe parimeve rituale.

Në krye të këtij tarikati ka qëndruar Çelebiu në Konja, i cili ka qenë, sipas traditës pasardhës, ose farefis i Mevlanas me përjashtim të dy halifeve të parë Mevlana Salihudin Zerkuba (vdiq më 1263-4) dhe Çelebi Husamudin (vdiq më 1284) Çelebijt i caktonin, venin, shehët duke iu dhënë atyre diploma (ixhazetname) dhe me këtë sigurohej karakteri centralist i tarikatit. Praktika e trashëgimisë në pozitë nga baba tek i biri, sipas modelit të Çelebijve në Konja, u instalua edhe te shehët e teqeve jashtë qendrës.

Në tarikatin Mevlevij janë zhvilluar dy rryma. Njërën e përfaqëson Ulu Arif Çelebi dhe ithtarët e tij, të cilët janë shmangur bukur shumë nga normat e sheriatit dhe e pinin verën. Këta janë të njohur me emrin "Shems kolu"– Krahu i Shemsiut. Kanë pasur lidhje të ngushtë me bektashinjtë, përvetësuan disa tradita dhe praktika të tyre, kultivonin tendencën e fortë alevite, vizitonin Horasanin etj. Jeta e Mevlevijve e harmonizuar me bektashinjtë ka shkuar aq larg sa Dervish Musa Ibn Ali, i cili në vitin 1440 shkroi librin "Haxhi Bektash Veli Vilajetnamesi", e konsideroi Shemsiun dhe Mevlana Xhelauddin Rumiun halifë të Haxhi Bektashit.

Tendenca e dytë është e orientuar në devotshmëri dhe asketizëm që është i njohur me emrin "Veled kolu" – "Krahu i Veledit".

Paralelisht me këto janë zhvilluar edhe dy silsile – trashëgimi gjenealogjike, të shehëve, varësisht nga ajo se a mbizotëron ndikimi i gjenealogjisë shiite-alevite, e lidhur pas halifit Ali, apo ndikimi i sunive, gjenealogjia bekrite e lidhur me Ebu Bekrin. Me insistimin e sunive janë themeluar lidhje gjenealogjike që pasojnë Ebu Bekrin, Umerin dhe sahabe tjerë të Pejgamberit a.s.

Mevlevijt, kryesisht janë nën ndikimin e gjenealogjisë alevite, e cila nga Xhunej Bagdadai shtrihet: Muhammed - Ali (vdiq 661) Hasan Basri, vdiq 799, Habib Axhemi vdiq më 768, Davud Tai vdiq më 800, Maruf Karhi vdiq më 815, Sari Saltëku vdiq më 855, Xhuneid Bagdadi vdiq më 910 a 911.

Krahas Mevlevijve edhe tarikate të tjera, sikur që janë helvetijt dhe Suhraverdijt e pranojnë këtë lidhje zinxhir gjenealogjik.

Mirëpo, mevlevijt të cilët kanë qenë nën ndikim të fortë të shiizmit përvetësojnë këtë zinxhir gjenealogjik: Muhammed – Imam Ali (661), Imam Hasan Ibn Ali, (678), Imam Husein Ibn Ali, 680, Imam Ali Ibn Husein al-Saxhad, 712, Imam Muhammed Ibn Ali al-Bakir, 733, Imam Xhafer ibn Muhamed al-Sadik, 765, Imam Musa ibn Xhafer al-Kazim, 799, Imam Ali ibn Musa al-Rida, 818, Maruf Karhi-Sari Sakati –Xhuneid Bagdadi.

Zinxhiri mevlevij, pas Xhuneid Bagdadit është: Xhuneid Bagdadi, Ebu Bekr Shibli (946), Muhamed Sexhaxh, 1091, Ebu Bekr Nessaxh, 1094, Ahmed Gazali, 1123, Ahmed Hatibi, 1113, Shemsul-Aimme Sarhasi, 1090, Muhamed Bahaddin Veled, (babai i Mevlana... 1231, Sejjid Burhanuddin Muhakkik Tirmizi, 1326, Mevlana Xhelaluddin Belhi – Rumi. E njëjta vazhdon më tutje: Xhelaluddin Rumi-Sulltan Veled-Ulu Arif Çelebi, etj. Krahas këtyre, ka edhe modifikime të tjera të zinxhirit mevlevij. Tëra këto silsile – zinxhir gjenealogjikë kanë vetëm vlera tradicionale.

Në periudhën e parë të zhvillim të vet, derisa akoma ishte pa formuar si tarikat, vëllazëria mevlevije përhapej dhe mbështetej në masat popullore. Mevlana gëzonte autoritet dhe ka qenë shumë i çmuar jo vetëm nga ana më e madhe e inteligjencies dhe aristokracisë, por edhe masat popullore islame e patën pranuar si udhëheqës "Pir" të vetin. Marrëd-

hëniet e tij me aristokracinë mongole dhe me mongolët kanë qenë përgjithësisht dashamirëse sepse Rumiu shpresonte që pas mbizotërimit definitiv, ajo masë e pastër mongole, e padjallëzuar, do të themelojë një qytetërim më të përparuar. Këtë rrugë dhe këto përpjekje i ndoqi edhe i biri i tij Sulltan Veled, i cili njëlloj ishte i lidhur sa me selxhukët aq edhe me aristokracinë mongole, dhe u shkruante panegjirikë, gjë që pati si rezultat pjesëmarrjen e beglerve dhe vezirëve në themelimin e teqeve Mevlevije.

Këta gjithashtu lanë vakëfe të pasura për këto teqe me të cilat sigurohej përhapja e tarikatit Mevlevij nëpër masa. Pikërisht në atë kohë janë themeluar fshatra të tëra mevlevije – Kozluk dhe Vakif, në Lazikije, Sikk në Bursa dhe Çakir në rrethinën e Kutahjes.

Sa ishte gjallë Xhelaluddin Rumiu, si edhe në periudhën e parë të zhvillimit të tarikatit Mevlevi, në seancat e zierit merrnin pjesë me shumë vullnet edhe femrat. E bija e sulltan Veledit, Sheref Hatun ka pasur shumë dervishë të vet, kurse në Tokat halife ka qenë një femër, Arife Çelebiu. Vajza me emrin Destina, pas Mehmed Çelebiut, ishte muteveli në teqenë mevlevije në Kara – Hisar. Mirëpo, më vonë, diku në shekullin 17, femra ndahet dhe nuk merr më pjesë në tubimet e përbashkëta të zikrit.

Pasi që në pikëpamje politike kanë qenë pasivë, mevlevijt ishin të kursyer nga represaliet dhe ndjekjet që osmanlinjtë, pas kryengritjes së Shejh Bedreddin në gjysmën e parë të shekullit 15, i ndërmorën kundra tarikateve heterodokse me pikëpamje teorike e praktike në kundërshtim me Islamin burimor tradicional, me gjithë faktin se në atë kohë mevlevijt nuk i shikonin si një forcë e cila i përkrah osmanlinjtë.

Mirëpo, në shekullin 15 dhe 16, kur tesavvufi heterodoks me tendenca shiite-alevite e përfshiu Anadollin, sidomos Rumelinë, kur bektashinjtë në Anadoll dhe Rumeli bënin propagandë në dobi të Safavidëve dhe e pranonin shahun e Iranit si sundimtar të tyre natyror, të cilin e ndihmonin dhe i besatoheshin, si edhe në rrethana të përshtatshme ata ngriheshin në kryengritje në emër të tij, duke filluar nga Javuz Selimi i I, (1512-1520) u inaugurua politika e shkatërrimit të sekteve e vëllazërive heterodokse bektashije dhe të ngjashmëve me ta siç janë: hurufijt, kalenderejt, hamzevijt(bajramij-melamij).

Megjithëse mevlevijt e krahut Shemsije, për të cilët bëmë fjalë më parë, pasonin tendencat shiite-alevite, dhe megjithëse mbanin lidhje të ngushta bashkëpunimi me bektashinjtë dhe shoqëroheshin me ta, edhe pse përvetësuan mendimet e hurufijve, prapë se prapë nuk e konsideronin, nuk e mbanin, veten të besueshmit e shahut të Iranit, e as që ndërmorën ndonjë veprim me qëllim që ta pengojnë pushtetin. Krahas tërë kësaj që e thamë lidhur me ta, në fund të fundit, mund të themi se ata janë sunit me bindje.

Krahu i dytë me tendencë të pastër sunite dhe asketike, me numër shumë më i madh se ata të parët, u lidh me pushtetin Osman dhe aristokracinë, për ç'arsye tarikati mevlevij me teoritë e tyre mistike-idealiste, me humanizmin dhe tolerancën u bë ideologji e aristokracisë së arsimuar dhe e shtresës së pasur qytetare. Atëherë u tërhoq nga fshatrat dhe qytezat, u përqendrua në qytete dhe u nda nga populli.

Mevlevijt që më parë ishin joaktivë nga aspekti politik, e përkrahën Abas Mehmed pashë, i cili u ngrit kundër jeniçerëve në shekullin XVII. Edhe sulltan Selimi i III (1789-1807) dhe Mahmudi i II, (1808-1839) u bënë anëtarë të tarikatit mevlevij dhe e përkrahën këtë tarikat me qëllim që të kenë sukses në luftë kundër jeniçerëve, ithtarë të Haxhi Bektashit. Tani tarikati mevlevij u bë si njëlloj partie politike e qeverisë osmane në luftë kundër bektashive dhe rrymave të tjera mistike me tendenca shiito-alevite.

Mevlevijt i bënin lajka pushtetit, nuk merrnin qëndrim të kundërt me pushtetin lidhur me zbatimin e reformave (tanzimati). E konsiderojnë si hap pozitiv pjesëmarrjen e tyre për largimin e sulltan Abdulazizit (1861-1876) dhe të sjellin në pozitë Abdulhamitin e II (1876-1909), i cili bëhet shumë i përshtatshëm e i preferuar për ta.

Një rrethanë shumë më fatlume për mevlevijt ishte ardhja në pushtet e mevleviut Mehmed Reshatit (Mehmet Reshati i V, 1909-1918), i cili renovon teqetë e vjetra dhe ndërton teqe të reja. Nga ana tjetër, mevlevijt kanë marrë pjesë në lëvizjen e xhonturqve, siç janë: Shehu mevlevij në Izmir, Nuri dede dhe Tokatizade Shekib (vdiq më 1932). Në parlamentin e parë nacional deputet i Konjës ishte Abdulhalim Çelebi, kurse deputet i Jozgotës dhe Kastamunit ishte Veled Çelebi, që të dy i takonin tarikatit mevlevi.



Në secilën teqe mevlevije në ditë të caktuara organizohej mukabele, dhe semaja (vallja)... Në kohën e Xhelaludin Rumiut dhe në periudhën e parë, mukabela, përkatësisht sermaja, nuk kishin formën përfundimtare e as nuk organizohej në ditë të caktuara. Më shumë ishte e karakterit të rastësishëm dhe bëhej kurdo që tubohej ndonjë grup.

Formën përfundimtare mukabelja e mori në kohën e Divane Mehmed Çelebiut (vdiq pas vitit 1545)...

Në mevlevizëm ka katër shkallë të cilat mund t'i arrijë dhe të gëzojë ithtari i tarikatit: myhib, dede, sheh dhe halif.

Myhib (simpatizues, ai që dëshiron të bëhet...) nxënës i ndonjë shehu, personi që hyn në Sema dhe ven kapuçin e mevlevijve – sikke.

Dede (ose dervish) personi që ka kryer shërbimin dhe stërvitjen e paraparë prej 1001 (një mijë e një ditësh), në dergah (teqe).

Sheh (me kuptimin i vjetër, i parë, udhëheqës) është personi që ka marrë ixhazetname (diplomë) nga ndonjë sheh (zakonisht me gradën e halifes mevlevi), dhe ky zëvendëson pirin.

Halif (zëvendës; mëkëmbës,) është dervishi më i pjekur dhe më me përvojë, i cili ka marrë hilafetnamen nga halifi Mevlanas dhe që plotëson vendin e zbrazët të sheshit.

Shehët që nuk janë nga familja e Pejganberit a. s. (sejjid) bartin shall të bardhë, pasardhësit e Muhammedit, a. s. bartin shall të gjelbër, kurse halifi bart shall me ngjyrë të errët ose ngjyrë të kaltër në të zezë.

Krahas ritualeve të lartpërmendura, ka qenë edhe ceremonia e quajtur "Ajn-i xhem", që zgjaste prej mbrëmja deri në mëngjes.

Gjatë kësaj kohe hanë, pinë, recitojnë këngë e poezi, luajnë dhe bëjnë muzikë. Ceremoniali përfundon me këndimin e sures Fatiha të cilën e këndon shehu.

Përktheu: Feti Mehdiu
(Fusnotat i ka hequr redaksia)

Histori Islame (13)

Paqja favorizon myslimanët

Përderisa mesazhi hyjnor është për mbarë botën dhe për të gjitha gjeneratat, Muhammedi s.a.v.s. do t'i informonte shokët e vet, se cila ishte gjendja politike në kohën e tij, cila do të jetë në të ardhmen e afërt dhe cila do të jetë në kohën e largët. Ai gjithashtu do t'i paralajmërojë ata edhe për ndryshimet që do të ndodhin brenda, në shtetin islam etj



Muhamed Jusufi – KAJOLLI

Historia ka dëshmuar se zëri i myslimanëve gjatë periudhave të paqes përhapet shpejt. Islami pengohet nga shumë faktorë, por, në ditët e para të paraqitjes së tij, ai hasi në injorancën e thellë dhe në sistemin shumë të kufizuar fisnor. Këto nuk i jepnin hapësirë Muhammedit s.a.v.s. të shpjegohej para të pranishëmve. Këtë më së miri e shpjegon sjellja e myslimanëve gjatë dhe pas marrëveshjes së Hudejbijes.

Ata vërtet ishin myslimanë, vërtet ia kishin dhënë besën se do të qëndrojnë me të deri në njeriun e fundit, por marrëveshja e Hudejbijes ishte mbi nivelin e të kuptuarit të tyre. Kjo marrëveshjeje, shikuar nga këndvështrimi fisnor, konsiderohej turp shumë i madh, dhe, nga hidhërimi i madh në Muhammedin s.a.v.s., ata, vetëm sa nuk u vetëvranë.

Ndërsa, në anën tjetër, mekkasit këtë marrëveshjeje e konsideruan si fitoren tjetër, e dyta me radhë pas betejës së Uhudit. Myslimanët, përveç Muhammedit s.a.v.s., nuk mund ta merrnin me mend se si lejuan të "humbnin" kaq lehtësisht, pasi kishin dalë fitues para disa muajve kundrejt paganëve gjatë rrethimit që ua bëri Medinës, ushtria kurejshite me aleatët e tyre. Ishte e paimagjinueshme për ta, ata nuk besonin se Muhammedi s.a.v.s. nuk do ta plotësojë premtimin e tij, për të bërë urren!

Prandaj Muhammedi s.a.v.s. u gjend përpara një vështirësie të madhe, si të pajtohej turma, si kishte për t'i bindur ata. Ai në heshtje filloi ta presë kurbanin e tij dhe t'i qethë flokët. Të pakënaqur edhe të tjerët vepruan sikur ai. Kur ai u pyet, pse nuk u realizua ëndrra tij, ai u përgjigj se nuk ju kisha premtuar këtë vit. Në kthim për në Medinë, Muhammedit s.a.v.s iu shpallën ajetet e fitores. Këto ajete bënë që myslimanët t'i kërkojnë falje Muhammedit s.a.v.s. për mosdurimin e tyre.

Kjo marrëveshjeje sikur të studiohet sot me ide të kohës sonë (globaliste) universale, themi se ka qenë shumë e qëlluar. Shumëkush nga analistët e sotëm, përveç myslimanëve që e konsiderojnë Muhammedin s.a.v.s. Pejgamber të All-llahut, e konsiderojnë si strategun më të madh të të gjitha kohërave, por njëkohësisht kemi edhe prej atyre, që thonë se Muhammedin e ndihmoi fati nëpër errësirën e injorancës së asaj kohe.

Kjo marrëveshje nga analistët myslimanë krahasohet me Betejën e Bedrit. Nëse fitorja e Bedrit ishte beteja vendimtare për myslimanët, marrëveshja e Hudejbisë konsiderohet si fitorja më e madhe për instalimin e paqes në rajon. Këtë marrëveshjeje si duket shumë analistë perëndimorë (krishterë) nuk duan ta lexojnë, prandaj vazhdojnë edhe më tutje ta quajnë Muhammedin njeri të ashpër dhe pushtues të "pangopur". Realiteti për Muhammedin dhe Islamin në tërësi flet krejt ndryshe, nga sa informohen perëndimorët nga analistët e tyre. Ai, fatkeqësisht përpara këtyre studiuesve mësohet si njeri arrogant, i etur për toka dhe i pasionuar në gra. Ndërsa ne ju themi se ai, nuk duhet të shikohet vetëm si ushtarak, por atë duhet studiuar në tërësi. Le të shikohet si burrë shteti, si në kohën e luftërave po ashtu edhe në kohë të paqes.

Historia dëshmoi

Muhammedi s.a.v.s., gjithmonë ka qenë në favor të marrëveshjeve paqësore edhe pse në të shumtën e rasteve i hidhëronte bashkëshoqëruesit, e tij. Këtë sjelljeje të tij e vërtetojnë shumë burime, por, e keqja qëndron se dikush qëllimisht i mbulon këto të vërteta. Tani është më se e qartë, se, sa herë në botë mbretëron paqja, kemi rritje të shpejtë të pranimit të fesë islame. Këtë rritje dikush e kupton si kërcënim, prandaj intrigojnë, duke e njollosur figurën e Pejgamberit të All-llahut s.a.v.s.. S'ka dyshim se këto sjelljeje shkojnë në dëm të tyre, dhe në dëm të njerëzimit. Askush nuk mund t'i fajësojë myslimanët për prishje të rendit, sepse kjo çoroditjeje buron nga vetë ata që e mohojnë këtë realitet.

Kështu hidhëroi Sallahudin Ejubi ushtarët e tij, kur bëri marrëveshje me kryqtarët. Ai kishte kërkuar të ndërpritet lufta kundër kryqtarëve, mu në kohën kur ushtria e tij nuk kishte të ndalur. Ushtria e kryqtarëve të udhëhequr nga mbreti anglez Rikardi (zemër luani), nuk po kuptonte se nga mbinë këta luaj të vërtetë. Ushtarët myslimanë të hidhëruar ia kujtoni Sallahudinit masakrat që kishin bërë të krishterët gjatë marshimit të tyre për në Palestinë, por ai, ua kujtoi atyre se falja është më e mirë te All-llahu sesa derdhja e gjakut.

Kështu kishte vepruar edhe Sulltan Murati i II-të, në kohën kur kishte rrethuar keshtjellën e Krujës. Ai u kthye në Edrene, jo se iu frikua ushtrisë shqiptare, por për hir të mos derdhej gjaku pa nevojë. Ai kishte vlerësuar se kështjellat, që udhëhiqeshin nga shqiptarët shumë shpejt do t'iu nënshtroheshin, prandaj u kthye pa derdhur gjak. Por, thënë të vërtetën, marrëveshja Hudejbjes myslimanëve u solli shumë të mira, por ajo që është më e mira ndër të gjitha këto, është se pas kësaj kohe myslimanët filluan ta kuptojnë më qartë e mirë misionin e tyre. Kjo bëri që ata të jenë më të kujdesshëm në veprime, dhe gjithsesi tani e tutje do ta ruanin me fanatizëm secilin dokument dhe do të regjistrohej secila ngjarje.

Letrat dërguar mbretërve të botës

Muhammedi s.a.v.s. u kthye në Medinë, me vete kishte një marrëveshjeje paqeje, gjë që i mundësoi atij, të merrej me përhapjen e fesë lirshëm. Ai tani e tutje nuk ndihej i rrezikuar nga paganët kurejshit të Mekkës. Në qetësi po vështronte botën përreth tij, sigurisht, ai shumë shpejt do ta paraqiste platformën e tij para shokëve të tij. Ai do t'i tregonte prioritet e kësaj platforme dhe cilët hapa duhen të merreshin në mënyrë urgjente. Meqenëse kishte mbaruar punë me paganët mekkas, pritej dhe duhej t'iu jepte një mësim të mirë edhe çifutëve të veriut të cilët vazhdonin me intrigat e tyre. Më herët kemi theksuar se çifutët kishin filluar të kuptojnë se rreziku i vetëm i tyre tani ishin bërë myslimanët e pathyer. Interesi tyre ishte që sa më shpejt e sa më efikas të ishin në përçarjen e myslimanëve.

Mirëpo Muhammedi s.a.v.s. me të arritur në Medinë, nga marrëveshja e Hudejbisë, nuk kishte vlerësuar si prioritet të tij çifutët, por ai ditët e para të tij, u shkroi letra mbretërve të rajonit dhe perandorëve të dy superfuqive të botës. Ai do t'i informonte mbretërit e botës për ekzistimin dhe veprimtarinë e tij, si Pejgamber i fundit për njerëzinë. E menjëherë pas dërgimit të këtyre letrave, mobilizoi vullnetarët e tij për në veri të gadishullit.

Burimet perëndimore nuk e paramendojnë Muhammedin si Pejgamber të All-llahut, prandaj edhe nuk i pranojnë disa fakte historike të myslimanëve. Ata nuk e perceptojnë dot se Muhammedi paska qenë kaq vizionar saqë ta konsideronte veten mbi mesazhet e Popullit të Librit. Kështu mendon edhe Karen Armstrong kur thotë:

"Kjo nuk do të thotë se ai kishte ndonjë

ëndërr për nënshtrimin e botës, por thjesht se kërkonte t'u përcillte Kuranin në arabisht fiseve veriore dhe ndoshta, gjithashtu arabëve të Sirisë dhe Irakut, të cilët ishin përfshirë në sistemin politik dhe fetar te Bizantit. Ekziston një hadith, që nuk përmendet në burimet e hershme se rreth kësaj periudhe Muhamedi i dërgoi letra dhe dhurata të shtrenjta perandorëve të Bizantit dhe të Persisë, Negrusit të Abisinisë dhe Mukavkisit të Egjiptit, duke i ftuar të hynin në Islam. Kjo patjetër që është pothuajse apokrifale (e pavërtetuar), sepse nuk ka të dhëna se Muhamedi e konsideronte Islamin një fe universale, e cila mund të qëndronte mbi mesazhet e Popullit të Librit".

Në anën tjetër, po në këtë libër ajo pohon se Islami nuk duhet shikuar vetëm nga këndi historik, por detyrë jona është që Kur'ani të studiohet paqësisht: "Nuk është e vërtetë se Islami predikon papajtueshmëri totale dhe frymëzon një fanatizëm të verbër. Përkundrazi, Kurani zhvillon një teologji të plotë mbi luftën dhe paqen, të cilën shumica e të krishterëve nuk e kanë të vështirë ta kuptojnë".

Fatmirësisht, edhe sot e kësaj dite ekzistojnë disa prej letrave që Muhammedi s.a.v.s. ia dërgoi personaliteteve të atëhershëm që ishin më me ndikim në botë. Myslimanët e parë, falë shpalljes së Kur'anit e dinin saktësisht, kohën kur Persia mundi ushtarakisht Bizantin, ata gjithashtu e përjetuan këtë mrekulli të Kur'anit, i cili i kishte parainformuar myslimanët se Bizanti do të korrë fitore të shpejtë kundër Persisë.

Duke qenë se Muhammedi ishte mirë i informuar prej Krijuesit të Tij, ai asnjë veprim nuk e bënte kokë në vete. Sigurisht i inspiruar nga All-llahu, ai, iu shkroi letra personaliteteve (mbretërve) të cilët do të duhej, secili në mënyrën e vet ta informonte popullin e vet për Pejgamberin e fundit të njerëzimit. Kjo ishte një përgjegjësi shumë e madhe. Ai gjithashtu e dinte mirë, se dy perandoritë ishin të vjetruara dhe kishin pësuar humbje të mëdha, prandaj ishin shumë të lodhur. Në brendi të tyre kishte plasur sherri, sikur që, Shirevahi, djali i perandorit të Persisë, i cili mbyti babanë e vet, Kisranë, gjatë një proteste e cila ishte shkaktuar si pasojë e humbjes së tyre kundër Bizantit. Gjendja hiç më e mirë nuk ishte edhe në oborrin perandorak të Bizantit.

Disa prej tyre (mbretërve) e kuptonin mirë mesazhin, dhe, e pranonin islamin si fe të tyre. Kishte prej tyre që vështronin dhe dëgjonin ngjarjet, nuk refuzonin por edhe nuk mohonin, ishin në pritje të rrjedhave. Por kishte edhe prej atyre që i përçmonin, i kundërshtonin ose edhe i mbytnin të dërguarit (konsujt) e Muhammedit s.a.v.s..

Pra, këto dy vjet për aq sa qëndroi marrëveshja e paqes së Hudejbijes, i Dërguari All-llahut Muhammedi s.a.v.s. do t'i përdorte për davet, thirrje të përgjithshme. Gjithashtu, do t'i luftonte çifutët e veriut të gadishullit të cilët nuk ndalonin komplotet e tyre.

Kjo marrëveshjeje, ose ky armëpushim rezultoi me sukses të plotë të myslimanëve. Numri myslimanëve u shumëfishua. Ibni Is'haku thotë se numri i myslimanëve për një kohë të shkurtër u dy ose trefishua. Nëse për tetëmbëdhjetë vjet numri i besimtarëve ishte 5 deri në 6 mijë, tani numri tyre për dy vjet arriti mbi njëzet mijë. Kjo dëshmohet me numrin e madh të ushtarëve myslimane që hynë në Mekkë. Tani le të shohim formën e disa prej letrave të Pejgamberit s.a.v.s. që ua dërgoi mbretërve:

Letrat drejtuar Ithtarëve të Librit ndryshojnë nga letrat e të tjerëve

Muhammedi s.a.v.s. secilit mbret i shkruante aq sa ta emociononte për të mirë. Secili prej tyre duhej ta ndiente veten se kishte të bënte me një njeri të thjeshtë, por, i cili në esencë, dallon nga të tjerët me shpalljen që i vjen nga Qielli. Secili mbret do të angazhohej që ta informonte popullin e vet, për të dërguarin e njerëzimit. Në të kundërtën do të përballet me ushtrinë myslimane!

Përderisa mesazhi hyjnor është për mbarë botën dhe për të gjitha gjeneratat, Muhammedi s.a.v.s. do t'i informonte shokët e vet, se, cila ishte gjendja politike në kohën e tij, cila do të jetë në të ardhmen e afërt dhe cila do të jetë në kohën e largët. Ai, gjithashtu do t'i paralajmërojë ata edhe për ndryshimet që do të ndodhin brenda, në shtetin islam...etj.

Kështu, myslimanët ishin mirë të informuar për rajonin. Ata dinin se në shekullin e katërt, perandoria e Bizantit, pasi kishte modifikuar dhe përshtatur fenë krishtere, kishte shpallur atë, fe zyrtare. Mesazhet e Isaut, nuk i plotësonin nevojat e sistemit perandorak, prandaj të nxituar për të shpëtuar perandorinë, ata kishin ofruar ndryshime të rrënjësishme. Këto ndryshime nuk ishin kundërshtuar nga shumë priftërinj të asaj kohe. Por, kishte prej tyre që nuk kishin pranuar asnjë ndryshim. Të gjithë ata që nuk ishin pajtuar me ndryshimet kishin pësuar keq, me përjashtim të atyre shteteve që ishin larg kufijve të perandorisë. Një prej shteteve që kishin ruajtur me shekuj shpalljen hyjnore të Isait, ishte Abisinia. Në shekullin e shtatë ky shtet vazhdonte të ishte sferë e interesit Bizantin, ndërsa marrëdhëniet rreth besimit ishin të ngrira, përderisa ata i përgjigjeshin tatimeve të parapara si të gjitha shtetet vasale.

Prandaj, Muhammedi s.a.v.s. e dinte mirë gjendjen dhe statusin e Abisinisë. Për këtë arsye kohë më parë kishte kërkuar nga Negusi që të ishte mikpritës i besimtarëve të dërguar nga ai. Negrusi, kishte gjithashtu një parandjenjë për kohën e shpalljes të Pejgamberit të fundit të paralajmëruar nga Isau, prandaj ishte shumë i qetë në marrjen e vendimeve. Ai akoma qëndronte fuqishëm, ai nuk i kishte ndryshuar dispozitat fetare të Isaut a.s. Feja e tij ishte e pastër. Prandaj vërejmë se letra e Muhammedit s.a.v.s. dërguar Negusit, ndryshon nga letra e dërguar Herakliut. Mënyra se si i shkroi Muhammedi s.a.v.s. le për të analizuar shumë, por akoma më interesante e bën analizën përgjigjja e Nexhashiut.

Letra dërguar Negusit, mbretit të Abisinisë

Bsimilahir Rahmanir Rahim

Nga ana e Muhammedit, të Dërguarit të All-llahut, Nexhashiut, zotërut të madh të Abisinisë, "paqja qoftë mbi atë që e pason udhëzimin e All-llahut!",

Pastaj,

"Unë falënderoj All-llahun. Ai është që s'ka hyjni tjetër përveç Tij, Sundues i shenjtë, Ai është i pastër nga të metat, Ai e furnizon çdo kënd. Ai është që mbikëqyr të gjitha, dhe, dëshmoj se Isai i biri i Merjemes. Është shpirti i All-llahut dhe Fjala e Tij, të cilin ia ka dërguar Merjemes së virgjër, të mirë e të pastër, e cila mbeti shtatzënë me Isain. Krijoi atë prej shpirtit të Vet, sikur krijoi All-llahu Ademin me Fuqinë e Vet. Unë të thërras ta besosh All-llahun, një të vetmin i cili nuk ka shok tjetër. Të thërras me miqësi në emër të All-llahut dhe të shkosh rrugës sime. Të besosh në shpalljen që më ka zbritur mua, sepse unë jam Pejgamber i All-llahut. Unë të thërras ty, dhe, ushtrinë tënde në besim të All-llahut të Lartësuar. Unë të kumtova thirrjen dhe të këshillova mirë, andaj pranoje këshillën time.

Paqja qoftë mbi atë që pason udhëzimin e All-llahut."

Përgjigja e Negusit (Nexhashiut)

Bismilahir Rahmanir Rahim

Muhammedit, të Dërguarit të All-llahut nga Nexhashiu As'hamet.

Selamun Alejke, o Pejgamber i All-llahut, shpëtimi i All-llahut, mëshira dhe bekimi Tij qofshin mbi ty. All-llahu është i Vetmi Zot dhe nuk ka Huyjni tjetër përveç Tij.

E mora mesazhin tënd, o Pejgamber i All-llahut, ku e ke përmendur çështjen e Isait. Pasha Sunduesin e Qiellit dhe të Tokës, me të vërtetë Isai nuk është asgjë tjetër nga ç'e ke përmendur. Ai është ashtu siç ke thënë. E kuptuam se çfarë na ke porositur. Na e lexoi djali i xhaxhait tënd dhe shoku yt. Unë dëshmoj se me të vërtetë ti je Pejgamber i sinqertë i All-llahut. Po të zotohemi në besnikëri, e këtë ia kemi thënë edhe djalit të xhaxhait tënd. Në praninë e tij pranova Islamin dhe iu dorëzova All-llahut, Krijuesit të botëve".

(Letrat janë marrë nga: El Mubarekfuri, Safijurrahman, Prishtinë 2004 f. 414 -416)

Haxhi ligj i Krijuesit të botëve

Për të gjithë ata që kanë mundësi materiale, haxhi është detyrim fetar. Me të, plotësohet urdhri që All-llahu Lartëmadhëruar ia ka kërkuar njerëzimit, gjegjësisht myslimanëve. Haxhi është një prej pesë shtyllave të qëndrueshme të islamit, prandaj duhet të jemi të vëmendshëm, të mos e anashkalojmë atë

Mehmet SHKËMBI

Njeriut i kërkohet që në jetën e tij t'i përmbushë disa detyrime universale. Ai fillimisht nuk e di, pse i kërkohet të falet pesë herë në ditë, por nëse është i rregullt në to, do të kuptojë se sa e ndihmon namazi atë në jetë. Gjithashtu njeriu në shikim të parë nuk e kupton arsyen e agjërimit, por me të do t'i kuptojë të mirat e tij, si në rrafshin social ashtu edhe atë shëndetësor. Kështu është edhe me ata që e japin zekatin, ndihen të qetë dhe të lirë vetëm atëherë kur e kryejnë këtë detyrim të tyre. Kështu, duhet shikuar edhe shkuarjen në haxh. Këtë do të mundohemi ta shkoqisim më gjerësisht.

Ç'është haxhi?

Për të gjithë ata që kanë mundësi materiale, haxhi është detyrim fetar. Me të, plotësohet urdhri që All-llahu Lartëmadhëruar ia ka kërkuar njerëzimit, gjegjësisht myslimanëve. Haxhi është një prej pesë shtyllave të qëndrueshme të islamit, prandaj duhet të jemi të vëmendshëm, të mos e anashkalojë atë. Dëgjojmë zëra të ndryshëm të cilët thërrasin në solidarizohet kinse me të varfrit, por në dëm të shkuarjes në haxh. Kërkojmë që të mos i përziejmë detyrimet tona, tjera janë detyrimet tona karshi Krijuesit dhe të tjera janë detyrimet tona karshi të varfërve dhe shoqërisë.

Para se ta shkoqisim temën rreth haxhit, mendoj se fillimisht duhet të mësojmë për vendet që vizitohen nga haxhinjtë, sikur historikun e objektit të kultit (Qabja), arafat, Muzdelifa etj.

Qabja, faltorja e parë njerëzore

Qabja është një objekt kulti, vendndodhja e saj është në një vend shkretinor të botës, në qytetin e Mekkës të Arabisë Saudite të sotme. Asgjë të veçantë nuk ka në të, por vallë, çfarë e bën atë kaq të rëndësishme, sa që, miliona njerëz njëherësh falen në te? Për nga arkitektura, Qabja është një ndërtim shumë i thjeshtë, ajo aspak nuk mund të krahasohet me ndërtesat e vjetra të tjera të botës. Piramidat egjiptiane, jugamerikane, objektet e ndryshme të kultit në Azinë qendrore, jugore e lindore, kanë arkitekturë shumë më mahnitëse, por sot janë të harruara. Ato frekuentohen vetëm nga turistët e interesuar dhe të pasionuar për antikitete. Nga kjo mësojmë se njeriun nuk e lëvizin objektet madhështore, por idetë.

Padyshim asnjë njeri, nuk do të dinte t'i përgjigjej kësaj pyetje sikur të mos ishte një historik rreth Qabes. Ne bazohemi në këshillën e Zotit që ia dha njerëzimit, këto i gjejmë në Kur'an sepse aty është i tërë programi Tij. Prej këtu dalin ide të ndryshme, dhe këto bëjnë që të kemi lëvizje dhe kreativitet. Gjithsesi nuk do të dinim për këtë vend sikur të mos ishin ruajtur edhe hadithet e Muhammedit s.a.v.s. prej të cilit doli e tërë kjo shkollë e madhe në shërbim të mbarë njerëzimit.

Këto dy burime janë të vetmet që i kanë ngelur njerëzimit, prandaj duhet të përqendrohemi në çdo thënie që i është ruajtur njerëzimit. Rreth qëllimit të këtij objekti dhe për formën ose mënyrën se si duhet të kryhet haxhillëku më shumë na mësoi praktika e të Dërguarit të All-llahut, Muhammedi s.a.v.s.

Sipas Kur'anit, Ibrahimi së bashku me të birin Ismailin e kanë ngritur Qaben, këtë të dhënë nuk e jep Dhjata e Vjetër.

Fjala e ngritur për njerëzit ka kuptim të dyfishtë. Kuptimi parë, lë të kuptohet se Ibrahimi me të birin e tij Ismailin ishin ata dy që ngritën gurthemelin e parë të kësaj faltoreje, ndërsa kuptimi dytë, lë të kuptohet se Ibrahimi me të birin e tij Ismailin kishin ngritur muret e Qabes mbi gërmadhat e rrënuara shumë kohë më parë. Këtij kuptimi i ndihmon edhe fjala e All-llahut, i Cili kërkoi nga këta dy, që ta pastrojë Shtëpinë e Tij.

Padyshim, askush nuk do të mundte të thoshte se kuptimi i dytë është i saktë, sikur të mos të na kishte dhënë Muhammedi s.a.v.s. të dhënat e tij rreth Qabes. Në një prej haditheve të tij thotë: Allahu kishte urdhëruar melekët për ta ngritur faltoren e parë të njerëzimit, pastaj, pas dyzet viteve të tjera ishte ngritur xhamia (faltorja) e dytë, Aksaja, e cila sot qëndron që qytetin e Kudsit (ose Jerusalemit) në Palestinës.

Ky hadith, është i saktë dhe nuk dyshohet në të. Ky na mëson se faltorja e parë në botë është ngritur nga melekët të urdhëruara nga All-llahu, për t'i treguar njerëzimit se si duhet ta falënderojë Atë. Se cila është lidhja midis faltores së parë, dhe faltores së dytë Aksasë mbase ka shpjegime matematikore ose astronomike, por unë nuk jam i thirrur të komentoj këtë lidhje. Thuhet se të gjitha lidhjet midis qiellit dhe planetit tokë, kalojnë nëpërmes kësaj spirale. Ajo, çka i bën besimtarët të mendojnë kështu, është numri i madh i të dërguarve të All-llahut të cilët janë nga kjo pjesë e tokës, si dhe udhëtimi Muhammedit s.a.v.s. brenda një nate nga Qabja, deri në Aksa, dhe pastaj, prej aty është ngritur në qiellin e shtatë dhe më lartë.

Vërtetë, nëse studiohet ky rrugëtim sipas metodologjinë së re, do të kishim mësuar shumë më shumë se sa dimë tani. Fatbardhësisht, Muhammedi s.a.v.s. e ka përshkruar hollësisht këtë rrugëtim, dhe kështu iu ka lënë mundësinë të gjithë atyre që janë ithtarë të historisë, arkeologjisë dhe astronomisë për hulumtime të mëtutjeshme. Këtë rrugëtim të tij, e kanë shpjeguar hoxhallarët, por shpjegimet e tyre mbase iu mjaftonin myslimanëve, por thënë realisht, ky shpjegim duket qartë se nuk i ka ndihmuar jo myslimanët. Me këtë udhëtim duhej të merreshin edhe shkencëtarë të shumtë të fushave të ndryshme, por fatkeqësisht pak është hulumtuar nga shkencëtarët mysliman.

Personalisht besoj se, sikur t'i kishin këto përshkrime kaq të hollësishme shkencëtarët perëndimorë, do të na jepnin të dhëna shumë interesante. Shumë nga filmat me karakter fantastik që shfaqen në Holivud kam përshtypjen se idetë i kanë nxjerrë nga literatura islame. Për sa i përket udhëtimit të Muhammedit s.a.v.s., myslimanët kanë besuar dhe aspak nuk kanë dyshojnë në vërtetësinë e këtij përshkrimi, por do të ishte shumë më mirë sikur të kishim të dhëna shkencore.

Pa dyshim, bashkimi i të dhënave të Muhammedit s.a.v.s. me të dhënat shkencore

do t'i afronte më shumë jo myslimanët. Atyre do t'iu jepej ndihma e parë të mendonin edhe për anën tjetër të botës. Kam përshtypjen se ndryshe do të zhvilloheshin edhe ngjarjet e historisë njerëzore, sikur të derdhej një buxhet i mirëfilltë për këto përshkrime.

Sipas statistikave që sillen në botë, kemi mbi 25 % mysliman, që të gjithë duan ta kryejë ritin e haxhit, ose të paktën ta vizitojnë këtë vend të bekuar, por ç'të bëjmë, kur kjo mbetet vetëm përkushtim, e nuk është shndërruar në dije bindëse mbarënjerëzore. Ndërsa Kur'ani thotë se Muhammedi është i Dërguar dërguari fundit dhe i përket njerëzimit mbarë.

Uroj që myslimanët të vetëdijesohen dhe të hulumtojnë shkencërisht sipërfaqen tokësore, nëntokësore dhe atë ajrore të këtij vendi, pra, të bëhen hulumtime gjenerale që nga Mekka e deri në Kuds (Jerusalem)... Ky është vendi në të cilën do të tubohen të gjitha gjallesat, dhe prej aty, do të fillojë një botë e re ndryshe nga kjo që jemi ne tani... e shumë gjëra të tjera interesante që jepen nga të dërguarit e Krijuesit tonë. Prandaj është interesant të dihet më shumë, të jepen shpjegime më të hollësishme, dhe, ky vend duhet të jetë gjithnjë atraktiv. Ne, i detyrohemi gjeneratës sonë njerëzore, të dijë më në detaje rreth faltoreve të para në planeti tokë.

Vendi njohjes (Arafati)

Për të mësuar edhe më bindshëm rreth haxhit, paraprakisht duhet të dimë edhe më shumë rreth vendit Arafat. Ky është vendi, që secili haxhi domosdoshmërish duhet të qëndrojë në të. Nëse një haxhi, nuk qëndron në të, nuk e ka kryer misionin për të cilin është nisur. Muhammedi s.a.v.s. thotë: Haxhi është Arafe. Atëherë, çfarë e bën interesant këtë vend?

Ky vend larg Qabes është vetëm tetë kilometra. Sikur të mos kishim tregimin e Muhammedit s.a.v.s. për këtë vend, askush nuk do të dinte asgjë për rëndësinë e këtij vendi.

Në një hadith të Muhammedit s.a.v.s. thuhet: Kur All-llahu xh.sh. dëboi nga xheneti Ademin dhe Havanë (Adamin dhe Evën), këta të dy, paskan qenë të ndarë edhe fizikisht pra, larg njëri tjetrit në planetin tokë. Ata pas një periudhe kohore qenkan takuar sërish. Arafati qenka vendi në të cilin janë ribashkuar për herë pas ndarjes midis tyre. Në këtë vend e njohu Ademi, Havanë. Prej këtij vendi (Arafat-vendi njohjes) ka filluar prejardhja njerëzore. Se kur ka filluar kjo, ne nuk mund të manipulojmë me shifra dhe nuk jemi të thirrur në të. Kur'ani e as Muhammedi s.a.v.s. nuk na japin këto të dhëna.

Ky vend, pra Arafati njihet gjithashtu edhe vendi në të cilin Ibrahimi a.s. e njohu birin e tij Ismailin, pas shumë vitesh që e kishte braktisur atë dhe nënën e tij Haxheren. Pastaj pason tregimi i shkuarjes deri tek vendflijimi. Ismaili a.s. ishte "viktima" i cili do të ekzekutohej nga babai tij Ibrahimi a.s.. Këtë rrugëtim e ka bërë Muhammedi s.a.v.s., dhe praktikisht ka treguar se si duhet të kryhet ky ritual. Që nga ajo kohë, secili haxhi e ka për detyrë ta bëjë këtë rrugëtim duke medituar për këtë ngjarje, krahas meditimit duhet simbolikisht të goditen tri vendet në të cilat Shejtani ka bërë përpjekje ta mashtrojë Ismailin a.s.

Haxhillëku ndër shqiptarë

Që nga koha kur shqiptarët islamin zgjodhën fenë e tyre, kanë praktikuar të gjitha vendimet e fesë. Në të nuk kanë përjashtuar as haxhillëkun. Islami ndër shqiptarë nuk dallon aspak nga vendet tjera myslimane të botës. Laramanitë që herë pas here shihen midis popujve me fe islame, në esencë nuk kanë dallim.

Karvani i haxhilerëve të hershëm shqiptarë përgatitej në mënyrë solemne. Ai dukshëm ndryshonte nga përgatitjet e rrugëtimeve të tjera të rëndomta. Përveç përgatitjes në ushqim për shkak të rrugës së gjatë, shumica dërmuese e haxhilerëve do të merrnin me vete edhe dhurata të ndryshme. Këto dhurata i dedikoheshin pasardhësve të familjes së Muhammedit s.a.v.s. Shqiptarët i njihnin disa familjarë të lozes së Pejgamberit s.a.v.s. në Mekkë dhe Medinë, ata nuk i shkëputnin lidhjet me ta, i vizitonin dhe iu jepnin dhuratat të cilat i mbanin me mija kilometra larg.

Më ka ngelur në mendje tregimi i nipit të Ataullah efendiut të Shkupit, haxhi Shukri Kurtishi kur tregonte për mënyrën e përgatitjes së haxhilerëve. Ai tregonte përshtypjet e veta kur kishte qenë i vogël. I përshkruante ato shumë bukur. Ai gjithashtu tregonte edhe përshtypjet e hoxhallarëve të vjetër. Përgatitjet bëheshin disa muaj më herët, hoxhallarët do t'ua mësonin haxhilerëve të rinj lutjet e veçanta që duhej t'i thonin në haxh. Para nisjes do të tuboheshin në xhaminë kryesore të qytetit, dhe me dua, do të merrnin drejtimin e tyre për në Shtëpinë e Zotit, në Mekkë. "Lebejke Allahumme Lebejk. Lebejke la Sherike leke lebejk, Innel Hamde ve Ni'meta leke vel Mulk, la sherike lek"- "Si urdho O Lartëmadhëri, si urdhëro. Si urdhëro, o Ti, që nuk ke shoqërues, si urdhëro. Pa dyshim se Lavdi dhe të gjitha mirësitë burojnë nga Ti, O Sundues, që je i Vetëm dhe i pa shok".

Kështu do të recitohej me zë të lartë, të gjithë të pranishmit, hanxhinjtë të ri, e të vjetër. Këto lutje i këndonin edhe të gjithë ata që kishin dalë në përcjellje të tyre. Ky recital do të vazhdojë gjatë tërë kohës derisa do të arrinin në Medinë ose në Mekkë.

Një prej lutjeve e preferuara dhe që recitohej nga vetë Muhammedi s.a.v.s. i cili një herë tha: "Prej lutjeve më të mira, është ajo e Ditës së Arafatit, ndërsa lutja më e preferuar është kjo të cilën tani e bëra. Këtë lutje e kanë bërë edhe pejgamberet para meje: "Nuk ka Hyjni tjetër përveç All-llahut Një, të Vetmit, dhe të pa shoq. I Tij është sundimi, dhe Atij i takon Lavdërimi. Ai është që i ngjallë dhe që i vdesë, Atij asgjë prej gjëje nuk i pengon".

Shkuarja në haxh është organizuar gjithmonë nga kryemyftiu i shqiptarëve. Tani kjo Kryemyftini mbarëshqiptare nuk është, por kjo organizohet nga Myftinjtë e Bashkësive Islame të kryeqendrave shqiptare sikur ajo e Tiranës, Shkupit dhe Prishtinës. Këto myftinj përcaktojnë kohën e shkuarjes, ose mos shkuarjes në haxh. Në vitin 1998-të, Myftinia e Prishtinës kishte lajmëruar popullin të mos shkohet atë vit në haxh në formë të organizuar për shkak të luftës që kishte plasur në Kosovë. Por, vetë jam dëshmitarë se edhe nga Kosova atë vit ka pasur shumë haxhinj.

Shumëkush nga shqiptarët (ateistë, besimligë ose jo myslimanë) janë munduar ta njollosin këtë institucion, por pa rezultat.

Haxhi është një prej pesë shtyllave të fesë, dhe shqiptarët nuk e mënjanojnë dot këtë shtyllë të përcaktuar nga All-llahu xh.sh. për njerëzimin. Secili mysliman i vërtetë i di dobitë dhe përfitimet shpirtërore, që mund t'i marrin në këtë vend. Këto mirësi dhe përfitime nuk arrihen me fjalë, por me vepër. Prandaj, nuk kanë sukses përfituesit e situatave (profiterë të luftërave ose tragjedive popullore). Shumë prej tyre janë përpjekur që paratë e haxhit t'ua "dedikonin" shtresave të varfra të popullit, ose personave që merreshin me organizim. Të gjithë ata, që apelonin të mos shkohej në haxh, nuk ndalonin së piri alkool dhe së shkuari nëpër klube të natës dhe vende dëfryese, edhe pse populli tyre vuante!

Kurbani-mjet që të afron me Zotin

Kurban në kuptimin etimologjik do të thotë "të afërohesh, mjet që të afron me Zotin", kurse në aspektin terminologjik ka kuptimin "të therësh një kafshë të përshtatshme sipas kushteve të caktuara të fesë islame me qëllim adhurimi". Sipas traditës Kurbani kryesisht theret në ditët e Kurban Bajramit…

Rexhep SUMA

Kurbani është një adhurim në të gjitha fetë hyjnore. Zoti çdo populli i ka caktuar kurbanin. Krahas kësaj, librat hyjnor, por edhe Kur'ani flet edhe për ngjarje dhe shembuj të ndryshëm që kanë ndodhur në periudhat e mëparshme: p.sh., flitet për kurbanet që dy djemtë e Ademit i paraqitën Zotit dhe që njëri prej tyre u pranua e tjetri jo.

Kurbani është shprehje e lartë e heroizmit, sakrificës dhe bindjes së njeriut në rrugën për fitimin e kënaqësisë së Zotit. Kjo bindje dhe sakrificë është simbolizuar me Ibrahimin dhe Ismailin, duke arritur majat. As mishi dhe as gjaku nuk shkojnë të Zoti, por, ajo që arrin tek Ai është devotshmëria që ushqen në zemrat tuaja, dhe respektin ndaj Allahut.

Shikuar nga këndvështrimi historik, sakrifica ka qenë një prej elementeve themelore në besimet e ndryshme, ku njerëzit dhe shoqëritë e ndryshme nëpërmjet sakrifikimit të realizuar në forma të ndryshme, janë munduar t'i afrohen qenies hyjnore dhe të arrijnë grada të larta shpirtërore...

Një prej formave të sakrifikimit në Islam është institucioni i kurbanit, i cili është prej karakteristikave më të theksuara të festës së dytë në Islam. Duke festuar Kurban Bajramin dhe duke përkujtuar këtë ngjarje me therje të kurbanit ne si shoqëri shqiptare e konfirmojmë dhe i përtërijmë këto porosi dhe qëllime të larta, duke sakrifikuar çdo gjë, për të mirën, paqen, harmoninë dhe mirëqenien ndërnjerëzore të përgjithshme.

Përkufizimi i Kurbanit

Kurban në kuptimin etimologjik do të thotë "të afrohesh, mjet që të afron me Zotin", kurse në aspektin terminologjik ka kuptimin "të therësh një kafshë të përshtatshme, sipas kushteve të caktuara të fesë islame me qëllim adhurimi". Sipas traditës Kurbani kryesisht theret në ditët e Kurban Bajramit (në tre ditët e para të tij).

Ibrahimi ishte i shtyrë në moshë, i vetmuar e plotë shqetësime që, nuk kishte fëmijë, dhe dëshira që të kishte një fëmijë i shtohej me kalimin e viteve. Në moshë të thyer Ibrahimi lutet për një fëmijë: "Zoti im, më dhuro mua (një fëmijë) prej të mirëve!" Perëndia iu përgjigj duke e sihariqtar se "Ne e gëzuam atë me një djalë që do të jetë i butë (i sjellshëm)".

Për Ibrahimin, Ismaili nuk ishte vetëm bir i një babai që nuk kishte fëmijë, ai ishte fundi i një jete duke pritur, shpërblimi për një shekull plot vuajtje, fruti i jetës se tij, shpresa e tij. Është shumë e vështirë që të komentohet premtimi i Ibrahimit për të sakrifikuar djalin e tij të vetëm, Ismailin, por gjithsesi e pamundur të thuhet me fjalë se çfarë do të thoshte kjo për Ibrahimin që u urdhërua nga Allahu ta sakrifikojë birin e tij të vetëm Ismailin.



Dhimbja, ndjenjat janë shumë të mëdha të imagjinohen, e si do të kuptohej sikur ajo të përjetohet. Por vullneti Zotit duhej të bëhej edhe Ibrahimi e realizoi premtimin, por Zoti në vend të djalit të tij solli dashin që edhe u bë simbol i sakrificës së tij.

Kurbani mund të theret me mbarimin e namazit të Bajramit deri në perëndimin e ditës së tretë. Pra, kurbani është institucion fetar i cili qëllim dhe objektiv parimor ka humanizmin e njeriut, pastrimin e tij shpirtëror, begatimin e tij me vlera dhe aspirata të larta, edukimin dhe kalitjen e tij. Kurbani është simbol i devotshmërisë, nënshtrueshmërisë dhe dorëzimit ndaj Allahut të Madhërishëm.

Kurbani dhe tradita shqiptare

Kur jemi te tradita jonë shqiptarët si një popull me shumicë dërmuese të fesë myslimane, kurbani ka arritur të kuptohet njëlloj sikur është transmetuar ndër popujt e tjerë. Praktikimi i therjes së kurbanit, ka simbolikën e vetë dhe kjo e lidhë me këto troje, dhe te shoqëria shqiptare, Kurbani rrit shpirtin bindës ndaj Allahut. Në këtë mënyrë, njeriu shfaq përkushtimin e tij të vërtetë dhe mundohet të kryejë detyrën e falënderimit; afrohet me Allahun dhe kurbani kryen rolin e afrimit të tij me të.

Gjithashtu kurbani ka shumë urtësi, porsa i përket jetës sociale të vetë shqiptarëve pasiqë duke therur kurbanin, shqiptarët si mysliman mbjellin dhe manifestojnë në shoqëri shpirtin vëllazëror, bashkëpunimin, ndihmesën dhe shpirtin e sakrificës.

Natyrisht, jo të gjithë kurbanin e kanë borxh. Për varfrit, ose për të gjithë ata që nuk kanë mundësi të blejnë mish, për këtë ditë festive kurbani është i mirëpritur.

Therja e kurbanit edukon njeriun e pasur, të jep nga pasuria e tij për të fituar kënaqësinë dhe bekimin e Zotit, por edhe falënderimet e të varfërve. E nxit atë të ndihmojë të tjerët dhe të ndiejë thellë në ndërgjegje kënaqësinë që të jep kjo ndihmë që u ofrohet të tjerëve.

Ese letrare

JANUSI QINDFYTYRËSH

Agron TUFA

Që në muzgun e fëmijrisë së hershme mbaj mend një përrallë me moral didaktik, të cilën gjyshja ime ma rrëfente pambarimisht, por njëditëzaj, papritmas ma rrëfeu me finale të ndryshuar dhe s'hoqi dorë nga varianti i ri, sado që unë prisja zemërngrirë finalen e variantit të parë. Është fjala për historinë e babait plak të tre djemve që vdes në shtrat. Para se t'i mbyllë sytë e të niset për atje ku shkojnë e s'kthehen, djemtë e pyesin atin e tyre:
- Çfarë pasurie na ke lënë baba?
- Gërmoni në kopsht, - u thotë ai, - gërmon thellë e më thellë dhe do të gjeni një qyp me florinj.
Bijtë i përvishen punës. Edhe sot ndjej ritmin monoton të kallzimit të gjyshes: "Gërmo e gërmo, gërmo e gërmo, gërmo e gërmo...". E shquaja qartë vizllimin metalik të kazmave që nguleshin në dheun e butë, ritmin e goditjeve, shpatullat dhe ballët e tyre të djersitur nën diellin pranveror, duke u fundosur kokëngjeshur në gropën e madhe të alegorisë së plakut, i cili, pa pikë mëshire i priste përskej, matanë paravolisë. Çdo vit, mandej, kopshti i vëllezërve jepte prodhime të bollshme dhe s'di se cili prej vëllezërve rrahu i pari ballin ndërmjet rreshtave të tekstit për "floririn" e nënkuptuar me vonesë. Mirëpo ime gjyshe u tregua më mizore se plaku i rrëfenjës. Ajo i shfarosi të gjitha nëntekstet dhe pa asnjë aludim ndërmjet rreshtash më çoi gjithëherë në një finale të pashmangshme, duke ruajtur nga kallzimi i mëparshëm veçse monotoninë e zbërdhylët të përsëritjes së rrëfimit: "Gërmo e gërmo, gërmo e gërmo, gërmo e gërmo...". Si në një fil të marrtë qëmtoja deri në imtësi harkimin e vrullshëm të krahëve, nguljen nervoze të kazmës dhe lugët e lopatave që pastronin përmbrapa. Por gjyshja përsëriste acarueshëm kallzimin, teksa ndërronte me shkathtësi shtizat e çorapeve që thurte, gjersa, befas, kazma pushoi, lopatat nuk u ndjenë. Nuk po gërmohej më. Epo shyqyr, thashë.
- E gjetën qypin?
- Qypin e gjetën, po thuaj sa e thellë shkoi gropa!
- E thellë, sa?
- E thëllë sa nuk mjaftonin litarët e gjithë kuajve të katundit për t'i nxjerrë prej andej ku qenë rraposë.
- Po qypin, gjyshe?
- E hapën dhe qypin dhe e gjetën të mbushur rrafsh e buzë për buzë me....
- Florinj! – brita triumfator.
- As mos të të rrejë mendja! – tha, duke kërcënuar ashpër me gishtin tregues, duke mbajtur një shtizë ndër dhëmbë.
- Po me çfarë pra? – pyeta pështymëtharë nga ankthi.
- Me mut! – tha vrazhdë dhe heshti një copë herë.
- Prandaj, mos të të rrejë mendja të gjesh florinj me kazëm, por mesohu t'i ikësh asaj, - sosi ftohtë ajo.

***

Them se gjyshja më shpërfaqi për herë të parë, në stilin e saj, fytyrën e prapme të përrallës, aspak ngushëlluese. Realiteti në shtëpi ishte krejt i ndryshëm nga ai jashtë pragut. Shkolla, librat, slloganet, këngët që na vinin në gojë t'i këndonim, nuk përputheshin kërkund, nuk kishin pikë lidhjeje me mizerjen e përditshme në shtëpi, me varfërinë, urinë, zhelet me të cilat mbulonim shtatin, me harenë fëmijnore që reduktohej trishtueshëm. Përtej pragut, gjithë e më qartë shpërfaqej një botë e ndërlikuar, e huaj, deri diku – armiqësore. Këtë e ndjenim unë, vëllezërit e mi dhe motra, kur bashkëmoshatarët tanë dhe ndonjë nga mësuesit zunë të na thërrisnin në çaste nervozizmi "bir reaksionari", "të deklasur", "armiq të klasës". Jashtë pragut të shtëpisë, në oborrin e shkollës, për pushim të gjatë, nuk e harroj mallëngjimin e beftë që më kapte kur shihja vëllezërit e mi apo motrën.

Ka qenë një ditë dimri me dëborë e tufan kur shkolla e pezulloi mësimin. Vocërrakët nuk mund të dilnin në oborr se i përlante shtjella që trandte hatullat dhe çatinë. Një nga një mbërritën prindërit, i ngarkuan në shpinë bijtë e tyre dhe u larguan. Kisha mbetur vetëm unë, mësuesi kujdestar i fillores dhe dy-tre mësues të tjerë.
- Po këtij, si do t'ia bëjmë? – pyeti të tjerët mësuesi im kujdestar.
- Nuk erdhi kush ta marrë! – shprehu ai habinë dhe zhgënjimin e tij.
- Kush është i ati? – mërmëriti një mësuese e re me një skelet të hollë syzesh që i vizlloi pikëllueshëm.
- Lëre krahëthatin... E ka në burg, - tha ai për tim atë.
- Mor, si nuk u kujtua asnjëri prej komshinjve...! – psherëtiu mësuesja e re.

Pa gjetur kurrfarë zgjidhjeje tjetër, mësuesi im i fillores vendosi të më marrë në shpinë. Ngula këmbë se nuk doja, por ai as që më pyeti: më ngarkoi si qengj flije kaliqafë dhe më urdhëroi të mbahesha. Më lëshoi para portës së shtëpisë sonë. Hyra brenda dhe qava. Im atë ishte në burg. Na kishte lënë të deklasuar dhe në ditë tufani, s'kishte kush të na sillte në shtëpi.



Studim

DISKURS PËR TOKËN E BRAKTISUR (1)

Bilal Xhaferri, në shtresimin esencial të humbjes së tokës-etnisë, tani, si shenjë dhe si përjetim, e jep, padyshim, edhe nivelin e rrëfimit po edhe atë të vetërrëfimit. Shkurt, gjendja personale në figurën e konceptimit njësohet, identifikohet vazhdimisht nëpërmjet braktisjes, e cila zmadhon plagën dhembjen shpirtërore



Flamur MALOKU

Shtresimi dramatik

Të flasësh për poezinë e Bilal Xhaferrit, domethënë, ta njohësh dhe ta perceptosh botën e ndjeshmërisë së tij të thellë, përballë një situate të vështirë kohore, historike dhe atë jetësore padyshim. Prandaj, poezia e tij, s'është gjë tjetër, pos artikulim i një ndjeshmërie të thellë, që në këtë rast shënjohet me dhembjen e gjakuar karshi realitetit çamë.

Kështu, poezia e Bilal Xhaferrit shtreson dhe nënshtreson në kodin tematik dhe në atë figurativ, një fat të rëndë kombëtar dhe subjektiv, të cilët artikulohen e identifikohen nga një ligjërim dramatik, përballë realitetit të hidhur.

Ky realitet i hidhur përkufizohet mbi humbjen, largimin, arratisjen nga atdheu i dashur. Pra, humbja e atdheut bëhet normë e tërë diskursit, për dëshpërimin, vajin subjektiv. Dëshpërimi në strukturën e poezive lidhet me tokën e humbur si shënjim i këtij vaji, çdoherë në shtresimin e brendësisë, që në poezi bëhet shumë identifikues-personal. Andaj, atdheu tipologjizohet në trajtën e ndjeshmërisë e të situatës por edhe të argumentimit. Sepse tani, humbja, largimi nga toka e shtrenjtë çame, evidentohet, por që tani vetëm komentohet si diçka e përgjakur gjatë tërë tekstit, çdoherë në rrafshin e sprovimit personal po edhe në atë kombëtar.

Personalja realizohet gjithmonë në kodin e identifikimit me Çamërinë, e cila shënjohet dhe pranohet çdoherë në poezitë, si: "Baladë çame", "Natë çame", "Janinë vjeshtë".

Në këto tri poezi shtrohet dhe argumentohet çështja dramatike e atdheut të braktisur. Braktisja nga atdheu krijon situatën e gjakimit, e cila shtreson dhembjen personale, ku diskursi i brendshëm jepet me plot emocionalitet përballë kodit nacional, si shënjim dhe si njohje e tij. Shtresimi identifikues karakterizohet me një figurshmëri; tani toka e braktisur mbetet si kujtim, e cila, para së gjithash, mbetet vetëm e lidhur me brendinë e flakëruar shpirtërore, aspak e zbehur në kujtesë, sepse përjetimi i situatës është fokusuar si diçka e rëndë:

Matanë largësive u zhduk e përflakur Çamëria
Dhe të gjitha rrugët tona shpien në veri.
Ulërin era e Mesdheut mbi trojet e lashta epirote,
Mbi të shtrenjtat troje tona stërgjyshore.
Në kullotat e braktisura kullosin rrufetë.

Ndarja nga atdheu jepet si njohje e rëndë, si shënjim i një jete të përflakur, nga një trishtim i krijuar për tokën, të cilën tani e mbulojnë rrufetë. I tillë është kuptimi, kur njeriu arratiset nga atdheu, më i vështirë bëhet, kur largimi është i shoqëruar me përdorimin e dhunës nga tjetri, i huaji.

Figura e rrufesë në idenë autoriale del e perceptuar, si fatalitet për tokën e mjerë çame. Kjo tragjikë e rrufesë, tani në figurë vjen dhe bëhet më e ndjeshme, e cila del në trajtën e asgjësimit, zhbërjes së një toke amë, që tani ka mbetur e vetmuar.

Andaj, duke theksuar e mbindërtuar tragjiken e asgjësimit, zhbërjes, teksti merr ngjyrimin emocional, i cili shpërthen nga mllefi, që vjen si rezultat i mospajtimit.

Fati çam në shenjën personale, bëhet edhe më i ndjeshëm kur bëhet përshkrimi i lemerisë, shtresim ky që bëhet esencial i tërë strukturës së tekstit.

Bilal Xaferri, në këtë shtresim esencial të humbjes së tokës-etnisë, tani si shenjë dhe si përjetim, e jep, padyshim, edhe nivelin e rrëfimit, po edhe atë të vetërrëfimit. Shkurt, gjendja personale në figurën e konceptimit njësohet, identifikohet vazhdimisht nëpërmjet braktisjes, e cila zmadhon plagën, dhembjen shpirtërore.

Ullishtat e pavjela gjëmojnë si dallgë bregore.
Dhe kudo toka çame,
mbuluar nga retë
rënkon e mbytur në gjak e lot,
e mbetur e shkretë
pa zot.

Duke dhënë shprehjen e pakënaqësisë dhe duke mos u liruar asnjëherë nga dhembja dhe nga shqetësimi, përshkrimi bëhet edhe më i fortë gjatë ndjenjës së përgjakur, e cila në domenin diskursiv sintetizohet. Theksimi i çështjes së atdheut të humbur, del në thurjen me shenja po edhe klithmës, në trajtën e ligjërimit. Pakënaqësia subjektive sa vjen dhe shtohet, çdoherë në mbitheksimin e dramacitetit, që tani shënjon atdheun e humbur.

Toka e mbetur pa zot, në idenë e tekstit jepet si e shkretuar, sepse ajo tani ka mbetur pa mburojë, së cilës tani nuk ka kush t'i dalë zot. Andaj, toka e mbetur shkret dyfishon dramatiken, e cila bëhet rrjedhojë e një lamtumire të përgjakur:

Na e tregojnë drejtimin plumbat, që vërshëllejnë në errësirë.
Na e ndriçojnë rrugën flakët, që gjithë tokën kanë përpirë
Pas shpinave tona përplas tufani dyert e shkallmuara të shtëpive
dhe rrugët zgjaten e zgjaten si veri.
Ne, popull muhaxhir, ecim nëpër shi...
Lamtumirë, Çamëri!

Dhembja për atdheun në konceptimin autorial përjetohet rëndë, shihet se kjo shoqërohet me përshkrim të zisë, lemerisë. Këtë lemeri të atdheut e forcojnë edhe figurat, si: plumbat, errësira, flakët, tufani, shiu, të cilat përjetohen fuqishëm, që tani rikthehen në situatë të sprovuar e të ngarkuar jetësore. Mirëpo, paraqitjen e kësaj situate Bilal Xhaferri e shënjon nëpërmjet figurshmërisë, e cila realizohet dhe nxitet nga motivimet e jashtme. Pra, figura në tërësinë e shprehjes e të botëkuptimit, shtrihet dhe realizohet së bashku me emocionalitetin, apo, siç thotë S. Syla, në një kritikë të tij: "Shprehja e figurshme dhe emocionale njëkohësisht, procedimi i simbolizmit dhe metaforizimit, që e zgjeron dhe e thellon kuptimin".

Ky thellim dhe kjo paraqitje e gjendjes artikulohet edhe në poezinë "Natë çame", e cila në preokupimin autorial bëhet e rëndë, e cila, padyshim, reflektohet gjithashtu edhe në diskursin e tekstit, pra këtu bëhet një hapje totale ndaj realitetit të gjakuar nacional dhe individual.

S'dëgjohen të lehurat, s'dëgjohen blegërima,
Nuk duken më zjarret dremitnin çobanët.
Vetë deti rreh bregdetin me dallgë pa pushuar,
Vetëm hëna porsi dele e ndarë nga kopeja
Nëpër shtigjet e reve baret e vetmuar.
Ndali çapin kopeja e ujqve
Dhe përgjon e uritur në errësirën thinjoshe.

Rrethi tematik në relacion me kodin nacional, padyshim me një sistemim edhe të figurshmërisë, në vijën kryesore të tekstit bëhet ide për një raport skematikë: AUTOR- ATDHE I HUMBUR, pra çdoherë në idenë e identifikimit, e cila njëherësh e bën subjektin të numërojë mbi gjërat e shkretuara, që tani janë rikthyer në dëshpërim.

Duhet theksuar se përshkrimi i lemerisë, kryesisht subjektiv, merr kuptimin e theksimit, se çfarë është, kur atdheu mbetet pa njeri. Kjo mbetjeje vjen si shkak i dhunës dhe synimit për zhbërje të një populli të pafajshëm, nga i huaji. Tani çdo gjë është rikthyer në vajtim subjektiv, s'është më asgjë e njëjtë, siç ishte më parë, thjesht atdheu është i vetmuar dhe i kapluar nga errësira e paparë ndonjëherë. Kjo gjë tani transponohet dhe shprehet nga shpirti i shqetësuar, përballë një kodi të madh nacional. Shihet qartë se autori, tani i kodit të madh nacional, thur elegji të shtruar mbi dramatiken e përjetuar. Dramatika sa vjen e bëhet edhe më e rëndë, e cila në esencë bëhet bazë e parashtrimit të pyetjeve, të cilat, të parashtruara në vazhdimësinë e poezisë, lindin si rezultat i kësaj gjendjeje:

Ku ini ju çobanë me gunat e bardha?
Ku i kini delet që blegërinin kullotave?
Ku i kini qiprat, ku këmborët si këmbana?
Ku i kini qent e staneve që ulurinin si luanë?

Pyetjet subjektive, të parashtruara vendlindjes, përkatësisht Çamërisë, marrin kuptimin e nevojës, për një paraqitjeje sa më reale të atdheut. Kjo në planin e vetëdijesimit, shtrihet në përmasën e gjithëdijshme kombëtare, jo vetëm në atë çame, por për tërë popullin shqiptar.

Gjithnjë duke zgjeruar dhe argumentuar fatalitetin e vazhdueshëm etnik, po edhe atë historik, si në linjën tematike ashtu dhe në atë motivore, autori e forcon këtë, si në figurë ashtu edhe në emocionalitetin e gjakuar e të tendosur gjatë rikujtimit, që tani e shpreh edhe në poezinë "Janinë vjeshte", apo siç thotë Sabri Hamiti, "Aty përkujtohet historia çame e shqiptare dhe përhumbet në hijet, prerjet, në zmbrapsjen e karaktereve, në trajtën e identiteteve, shkurt: aty përmbyset, tjetërsohet dhe vdes një identitet kulturor dhe etnik".


Përmbysja dhe zhbërja e karakterit të etnisë, në preokupimin personal dhe kombëtar, deklamohet me dhembje dhe me përshkrim, i cili ka një retrospektivë çdoherë në ndërtimin e diskursit për tokën e humbur, që dikur ishte lavdi për secilin shqiptarë:

Liqeni i Janinës- lugin plotë me uji
Dergjet i përgjumur në mjegullën mëngjesore,
Shket krahu i pulëbardhës mbi nisinë si tunele,
Me letët rrepave mbulon era shëtitoret.

Janina në strukturën e poezisë shprehet si mosharrim, por që tani rindërtohet nëpërmjet variacioneve dramatike, si përhershmëri e gjakimit nacional, por edhe si njohje e brendësisë autoriale, që bëhet si diçka e domosdoshme, për rrjedhjen kohore, çdoherë mbi ndjenjën shprishur, e me shpirt të shqetësuar pakufi.

Një humbjeje e tillë shqiptohet si shtresim i papajtueshmërisë me fatin e trishtuar e të braktisur, siç thotë Kujtim M. Shala, "Humbja gjithnjë e prek plagën, andaj poezia e Xhaferrit për humbje është prekëse e rikujtuese e përhershme e plagës". Plaga çdoherë dëshmohet mbi emocionet e trishtuara në diskursin e identifikimit.

(vijon në numrin tjetër)



Poezi

Çdo natë kërkoj dashurinë e kësaj bote



Violeta KOKOLLARI

PA TITULL...

Të gjitha trillet fillojnë nga ju,
Më shumë se zjarri djegin,
Shigjeta të harqeve helmuese,
Janë fjalët tuaja për këtë njerëzi.
Sytë e tjerë ju shikojnë,
Mu ata janë në rrezik nga ju,
Mirëseardhje që dëmton zemrën,
Ju urojnë mituria!
Pa heshtur fare bien në grackën
E asaj që shohin,
Diç të bukur dhe joshëse,
Mospërfillja e vetëdijesimit tuaj
Dikur do bëhet ilaç infektues.
Ndërkaq pasioni vjen zgjerohet,
Zbukurohet flagranca,
Hapen kufijtë
Për fundin e çdo gjëje…

VONË

Kur të kthehem
Do bëhet vonë,
Nuk do më njohin
As njerëzit e gjakut tim,
Ngaqë dhe ta
Do treten si unë
Në një botë tjetër
Atje në amshim.

HESHTJA

Lirikë e dimrit tim,
Bashkë me juve,
Mysafir i dështuar,
Po, si duket, nuk kuptojmë.
Nga fjalët e thëna
Të nisura, por të mbetura në fyt,
Fillojani këngës
Që dikur fituat betejën;
Me një shqelm rrënuat
Fortesën e vetmisë.
Unë dua këngën,
Vetëm fjalët jo,
Ato që me bollëk i gjen
Kur nuk na bëjnë punë.
Po ia nisim poemës,
Poemës së dashurisë,
Megjithatë vetëm kjo
Na mbetet mike,
Kujtime, përjetime
Që ngopemi fare pa ngrënë.

RIKTHIMI

Unë jam në shtëpinë time,
Askush këtë nuk e di.
Si hije depërtova
Në atë dhomë
Ku ishte bërë hi.
Më kërkojnë, pyesin për mua,
Vitet që lash pas
Nuk po e dinë
Fshehtësinë e tretjes
Diku në Amsterdam.

DO TË SHKRUAJ

Do të shkruaj për Ty
Deri në frymën e fundit
Të jetës sime.
Nëse më kërkojnë
Të rri mbyllur,
Do sigurohem kjo të ndodhë;
Të qëndroj vetëm me vetveten
Larg atyre që më lëndojnë
Duke pritur një agim të ri,
Duke shkruar vetëm për Ty.

KËRKOJ

Me duar të zgjatura
Çdo natë kërkoj dashurinë e kësaj bote,
Nektarin pranveror.
Të jetojmë së bashku lule
Gjerë në pafundësi,
Ta thërrasim gjyqtarin të vejë drejtësi;
Me shekuj qëndruam
Kështu si gurë.
Tani përherë
Legjendë do mbesim,
Unë sfida,
Ti gëzimi.

Botime të reja nga Instituti Albanologjik i Prishtinës

Katër vepra epike-historike, dy monografi, tri seri të gjurmimeve nga fusha të ndryshme

Alban ZENELI

Instituti Albanologjik i Prishtinës në vitin 2007 ka botuar disa vepra me rëndësi të madhe për historinë dhe kulturën shqiptare.
Sipas prof. dr. Zymer Nezirit, Instituti Albanologjik i Prishtinës ka botuar katër vëllimet me këngë epike-historike të titulluar "Këngë popullore historike", të cilat përfshijnë periudhën nga Beteja e Kosovës (1389) e deri në Luftën e Dytë Botërore (1939).
Gjithashtu janë botuar edhe dy vëllime kumtesash: "Frang Bardhi, 400-vjetori i lindjes" dhe "Krijimtaria Shkencore dhe Letrare e Rexhep Qosjes", i cili është botuar pikërisht me rastin e 70-vjetorit të lindjes së tij. Ndërkohë, seritë e gjurmimeve kanë vazhduar me tri vëllime "Seria e Shkencave të Filologjisë", "Seria e Shkencave të Folklorit dhe Etnologjisë" dhe "Seria e Shkencave të Historisë". Të gjitha këto kanë numrin 36/2007. Përpos këtyre botimeve, këto ditë nga Instituti Albanologjik i Prishtinës është promovuar edhe revista "Gjuha Shqipe" (Nr.3). Kjo revistë, e cila botohet tri herë në vit, prin me studimin e prof. Emil Latës "Gjuha dhe Shkrimi".
"Mirëpo, shumë vepra dhe punime shkencore nuk e patën fatin e botimit, për shkak të mungesës financiare", ka theksuar prof. dr. Zymer Neziri.
"Disa vepra, studime monografike, të cilat nuk kanë pasur përkrahje të mjaftueshme financiare, kanë mbetur për planin botues të vitit 2008".

Në Festivalin e Pestë Ndërkombëtar të Studentëve për Film dhe Teatër "Skena UP"

BENAU YARROW DHE AGON MYFTARI MË TË MIRËT E FESTIVALIT

Filmi "Walking out of love" me regji të Benau Yarrow dhe shfaqja "…Të tjerat janë heshtje" nga regjisori Agon Myftari, janë shpërblyer si filmi dhe shfaqja më e mirë në Festivalin e Pestë Ndërkombëtar të Studentëve për Film dhe Teatër "Skena UP" që u mbajt në Prishtinë nga 21 deri më 28 nëntor.
Me 64 filma në konkurrim zyrtar dhe nëntë të tjerë jashtë konkurrencës, tetë shfaqjeje konkurrente dhe katër mysafire, 200 artistë nga vende të ndryshme të botës kanë qenë pjesë të festivalit për shtatë ditë me radhë.
Motoja e festivalit ishte "Shpirtin ma keni këputë", që mbahej për nder të aktorit të ndjerë të Kosovës, Faruk Begollit.

A. Zeneli

---

10 librat më të mirë të vitit 2007

Gazeta prestigjioze "The New York Times", ka publikuar 10 librat më të mirë për vitin që po lëmë pas. Librat janë të ndara në dy kategori: fiksion dhe jo fiksion.
Në vazhdim po i prezantojmë këto libra së bashku me shënimet bibliografike.

Fiksion

MAN GONE DOWN (Njeriu ra poshtë)
Nga **Michael Thomas**. Publikues: *Black Cat/Grove/Atlantic*. Romani i tij i parë zbulon histori të personale të shkurtra pas katër ditë dëshpëruese të jetës së tij të zezë.

OUT STEALING HORSES (Të jashtmit vjedhin kuajt)
Nga **Per Petterson**. Përkthyer në anglisht nga **Anne Born**. *Graywolf Press*. Në këtë roman të shkurtër norvegjez, një profesionist nga Oslo shpreson të shëron vetminë e tij me një futje në vetmi.

THE SAVAGE DETECTIVES (Detektivët e ashpër)
Nga **Roberto Bolaño**. Përkthyer nga **Natasha Wimmer**. *Farrar, Straus & Giroux*. Një roman autobiografik me shkathtësi për një bandë guerilësh që janë letrar.

THEN WE CAME TO THE END (Pastaj vijmë në fund)
Nga **Joshua Ferris**. *Little, Brown & Company*. Njoftimet pezulluese fluturojnë në mënyrë therëse në romanin e parë të Ferris-it, duke filluar nga një nëpunës menjëherë pas debaklit të dot-com (.com).

TREE OF SMOKE (Druri i tymit)
Nga Denis Johnson. Farrar, Straus & Giroux. Autori i "Jesus' Son" na ofron një roman të ndjeshëm për punët e rënda të njerëzve gjatë Luftës së Vietnamit.

Jo fiksion

IMPERIAL LIFE IN THE EMERALD CITY: Inside Iraq's Green Zone (Jeta mbretërore në qytetin e smeraldit: Brenda zonës së gjelbër të Irakut)
Nga **Rajiv Chandrasekaran**. *Alfred A. Knopf, Vintage*. Autori, një gazetar i Washington Post-it, shënon arrogancën dhe idiotësinë që ka lënë qeverisja amerikane e Irakut.

LITTLE HEATHENS: Hard Times and High Spirits on an Iowa Farm During the Great Depression (PAGANËT E VEGJËL: Kohët e vështira dhe gjallëria e lartë në një fermë në Iowa gjatë depresionit të madh)
Nga **Mildred Armstrong Kalish**. *Bantam Books*. Dashuria e lartë e Kalish-es për kujtimet e fëmijërisë ngjall kujtimet, të cilat zhvatin lexuesin në lojë, mrekulli madje dhe sfidë.

THE NINE: Inside the Secret World of the Supreme Court (NËNTËSHI: Brenda botës sekrete të Gjykatës Supreme)
Nga **Jeffrey Toobin**. *Doubleday*. Një e dhënë e punëve të brendshme nga një dijetar jashtë gjykatës me shtylla.

THE ORDEAL OF ELIZABETH MARSH: A Woman in World History (PËRVOJA E HIDHUR E ELIZABETA MARSH-it: Gruaja në historinë botërore)
Nga Linda Colley. Pantheon Books. Colley ndjek gjurmët e "shëtitëses së sëmurë" Marsh gjatë shekullit 18 dhe kontinente të ndryshme.

THE REST IS NOISE: Listening to the Twentieth Century (PREHJA ËSHTË TINGULLI: Dëgjimi në shekullin e njëzetë)
Nga **Alex Ross**. *Farrar, Straus & Giroux*. Në shkathtësinë e tij të orkestrimit, kritiku Njujorkez i muzikës paraqet një histori të shekullit të fundit, si thyerje përmes muzikës klasike.

PËRGATITI: OSMAN D. GASHI

Këshilla për një përkthyes të pavarur

SI TA ORGANIZOSH DITËN TËNDE TË PUNËS

Shumë njerëz ende nuk kanë një ide të qartë se çfarë është një përkthyes i pavarur dhe çfarë bën. Kur më pyesin për punën time, unë thjesht u them: "jam një përkthyes", dhe shumica e atyre që pyesin përgjigjen: Çfarë? Dhe çfarë bën një përkthyes? Dhe si mund të punosh nga shtëpia, vetëm, pa asnjë punonjës…?



Elda CENALIA

Çfarë është një përkthyes i pavarur? Një supozim i zakonshëm dhe i përhapur ndërmjet atyre që nuk janë familjarë me këtë punë, është se të jesh një i pavarur përfshin më shumë liri të lëvizjes sesa të punosh si një nëpunës. Në praktikë, ju mund të punoni "kur" dhe "në qoftë se" ju vendosni ta bëni.

Përse koha është thelbësore për një përkthyes të pavarur?

Se sa e vështirë është të fillosh si një përkthyes i pavarur, varet si nga eksperienca juaj dhe nga ekzistenca / mosekzistenca e ndihmës dhe mbështetjes nga jashtë që ju mund t'i besoni. Por kjo është një tjetër histori. Le të supozojmë se ju tashmë e keni filluar biznesin tuaj dhe të përqendrohemi te KOHA, që na drejton neve, në një tjetër fjalë thelbësore: ORGANIZIM.

Vetëm nëse ju i kushtoni kujdesin e duhur kësaj fjale magjike, unë mund t'ju them juve nga eksperienca ime se të jesh një i pavarur do t'ju kthejë juve në një rob! Të punosh si një i pavarur nuk do të thotë, as nuk duhet, që ju nuk duhet të keni orare ose asnjë program për të ndjekur. Përkundrazi, sa më shumë liri të keni nga ndonjë punësim tradicional, akoma më mirë ju duhet të planifikoni ditën tuaj të punës dhe jetën personale. Në të kundërtën, risku i parë që ju rrezikoni është të jeni i zhytur në punën tuaj sa për t'i thënë lamtumirë pjesës tjetër të jetës suaj.

Është shumë e zakonshme – dhe shpesh e justifikuar – për një përkthyes të pavarur në fillim të karrierës së tij/saj të mendojë se gjëja më e rëndësishme është "të punosh, të punosh dhe akoma të punosh". Dakord, ne e kemi zgjedhur këtë lloj pune, sepse "pasioni na udhëheq" shumica prej nesh nuk punojnë mirë me orare të fiksuara, në varësi të njerëzve të tjerë që bëjnë punën tonë, të shkojmë në zyrë çdo mëngjes e kështu me radhë. POR ju duhet të vendosni kufij edhe për këtë liri, kështu ju duhet të filloni të merrni në konsideratë disa lloj orësh hapje/mbyllje për zyrën tuaj të shtëpisë. E di që është e vështirë ta mbyllni PC-në tuaj në orën 6:00 pasdite, n.q.s., ju keni një punë ju jeni gati të plotësoni (vetëm 2 faqe!), por ju duhet të ndiqni rregullin.

Kur dhe sa herë duhet t'i kontrolloni e-mailet tuaja hyrëse?

Kontrollimi i e-maileve tuaja në mënyrë të shpeshtë është e rëndësishme, meqë puna juaj varet kryesisht nga këto. N.q.s., ju keni një lidhje ADSL, ju zakonisht nuk keni problem të kontrolloni mesazhet tuaja në mënyrë të shpeshtë, meqë shpesh nuk është e rëndësishme të vendosni një kontakt të ri çdoherë – dhe është më e lirë.

Një mendim tjetër i mirë do të ishte vendosja e një njoftuesi poste akustik (zanor), që ju informon juve për çdo e-mail të ardhur pa pasur nevojë të kontrolloni në mënyrë vizuale ikonën e-mail në traybar në krye të desktop-it tuaj.

Sigurisht, meqë klientët/agjencitë e përkthimit punë të pavarura mund të jenë të lokalizuara në pjesë të ndryshme të botës, ju duhet të merrni në konsideratë problemin e kohës së zonave: një zgjidhje e mirë është të vendosni një auto-përgjigjes për programin tuaj të e-mail që pohon se ju jeni përkohësisht i padisponueshëm dhe do të përgjigjet ASAP. Në këtë mënyrë, n.q.s., një klient dërgon një mesazh kur ju jeni në krevat në orën 1:00 të natës, ai/ajo do të marrë një përgjigje, megjithëse nuk do të jetë përgjigje nga ju personalisht!

Një tjetër rregull që ju duhet të ndiqni është: ju lutem MOS PUNONI NË FUNDJAVË: është më e lehtë ta thuash sesa ta bësh! Mirë, n.q.s., ndonjëherë ju jeni i detyruar të punoni të Dielën, sepse ju duhet të plotësoni një punë urgjente, atëherë duhet të përpiqeni të mos punoni të paktën të Hënën në mëngjes, në mënyrë që të çlodheni pak dhe të vendosni ekuilibrin e kohës së përfituar dhe të humbur.

Në praktikë, ju duhet të vendosni një farë "buxheti kohor" dhe ta ndani kohën tuaj profesionale në, për shembull, vetëtrajnim (të mësosh programe të reja software, të ndjekësh kurse, seminare gjuhe etj.), duke i dedikuar pak kohë forumeve1 profesionale dhe (më thelbësorja) të bërit tregti (marketingu). Pjesa tjetër e kohës tuaj duhet t'i dedikohet jetës private dhe sociale dhe shpresës për pushime.

Me fjalë të tjera, ju duhet të organizoni kohën tuaj si çdo biznes tjetër, në të cilin ka periudha pune të vështira, gjatë të cilave ju do te jeni i paaftë t'i dedikoheni marketingut, për shembull, por, në anën tjetër, do të ketë gjithashtu periudha, me punë hyrëse më të vogla. Kjo nuk është për t'u konsideruar si humbje kohe ose gjë negative: më mirë, ju duhet të përfitoni nga këto për të bërë çfarë ju nuk mund të merreni kur "punoni" – p.sh. marrëdhëniet me publikun, marketingun, përpilim fjalorësh, kontrolli i bazës së të dhënave të agjencive tuaja etj.

Një anë e rëndësishme e planifikimit konsiston në vendosjen e qëllimeve tuaja të ardhshme: të kaloni (merrni) një provim të veçantë për Shoqatën e Gjuhës XX, për të përfituar klientë të rinj, për ta përmirësuar ueb-siten tuaj – n.q.s., ju keni ndonjë– ose të vendosni nëse është koha të keni një ueb-sit tuajin, etj.

Ana administrative e punës tuaj

Një çështje e rëndësishme kur punoni si një i pavarur është të organizoni anën administrative të punës tuaj – p.sh., faturimin, punë ndjekëse etj. Nëse është e mirë organizuar, do të jetë një investim i mirë. Prandaj, ju duhet të vendosni një pro-

tokoll operativ, i cili përcakton çdo afat kohor, data skadimi etj. Si pjesë e këtij operacioni shpëtim – kohe, ju gjithashtu duhet të përgatisni dhe freskoni një bazë non-stop të listës së FAQ, që përmban të gjitha çështjet/koordinatat që ju keni të bëni. Kjo do t'ju parandalojë juve dhe/ose njerëzve të tjerë nga harxhimi i kohës gjatë përpjekjes për të rregulluar problemet, që tashmë janë zgjidhur në të shkuarën.
Si një rregull i përgjithshëm, ju duhet të vendosni që faturimi duhet të bëhet në fund të çdo muaji, kështu si për grupet e vogla dhe/ose punët e mëdha së bashku. Por, sigurisht, kjo ëndërr jo gjithmonë bëhet realitet, se rregullat mund të ndryshojnë sipas çdo klienti dhe kërkesave të tyre: njëri mund ta kërkojë faturën në përfundimin e ÇDO PUNE, një tjetër në fund të muajit, një i tretë në ditën e 15 ose të 30 të secilit muaj (Po, ju betohem, më ka ndodhur mua!). Dhe në fund klienti X do të faturohet pasi të ketë arritur shuma XXX dhe kështu me radhë. Dhe çfarë mund të themi për agjencitë e mëdha të përkthimit me menaxherë projektesh të shumta, secila duke kërkuar faturën e saj/tij VETËM për punën e kompetencës së tyre? Do të thotë se, n.q.s., thuaj, në korrik, meqë ju keni bërë tri punë të ndryshme për tri PM të ndryshme, ju duhet të lëshoni tri fatura të ndryshme! OK, jeni akoma i sigurt, që ju doni të jeni një i pavarur? Nëse po, atëherë le të lëvizim.
Sigurisht, gjëja më e mirë është të vendosni një model të faturës standarde, ose më shumë se një, p.sh., njëra për klientët ndërkombëtarë dhe një për ata shtëpiakë, që përmban të dhëna për secilin klient – emrin, adresën, emrin e menaxherit të projektit etj. Kështu, ju nuk do të keni nevojë të përgatisni një faturë të re çdoherë; përkundrazi, do t'ju duhet të ndërroni vetëm detajet e punës.
Duke qenë se faturimi është i rëndësishëm, ju duhet të përpiqeni ta thjeshtoni procesin, në mënyrë që të mos lini jashtë asnjë punë. Për ta bërë këtë, është me vlerë të mbani të gjitha PO-të mujore së bashku, të ndara sipas klientëve, kështu që ju mund të ndiqni të gjitha punët e bëra dhe t'i shtoni ato në faturën përkatëse. Jo çdo klient dërgon një PO zyrtar, kështu që ju duhet t'i pajisni ata me një model për ta mbushur dhe t'ua kthejnë juve. Një PO është thelbësore, jo vetëm për qëllime ndjekjeje, por, më e rëndësishmja, evidenca e punës që klienti është duke porositur. Kështu, ju lutem mbani në mendje se ju gjithmonë duhet të kërkoni një PO!
Ndonjëherë marrja me faturat, PO-të, bazën e të dhënave etj., mund të jetë e mërzitshme, sigurisht që nuk është mjaft krijuese dhe sidoqoftë e rëndësishme. Për të qenë profesional, ju duhet të investoni para së gjithash në kohën tuaj: çdo detyrë "e mërzitshme" që ju mund të kryeni tani ka mundësi të përmirësojë aftësitë tuaja, kështu që mos humbisni kurajën tuaj dhe mbani gjallë punën tuaj të mirë!
Shpresoj se këto këshilla do të jenë me vlerë për ju dhe do t'ju isha mirënjohëse të merrja përgjigjen tuaj (albanian_interpreteruk@hotmail.com) rreth këtij artikulli me çdo sugjerim, kritike dhe përshtypje rreth përmbajtjes së tij.
Ndërkohë, ju uroj të gjithëve juve të pavarurve një karrierë të suksesshme!



Shpjegimi i ëndrrave nga këndvështrimi kur'anor

Ëndrrat dëshmojnë për aktivitetin psikik gjatë gjumit. Ka mjaft raste kur në gjumë bëhet punë aktive krijuese. Shkencëtarët kanë zbuluar gjëra me rëndësi, poetët kanë thurur vargje, etj. Pikërisht në gjumë herë pas here vijnë aso zgjidhjesh çfarë nuk ka qenë e mundur të zgjidhen në gjendje të zgjuar

Dr.sci. Ali F. Iljazi

Një gjë është shumë interesante: si sheh njeriu kur flenë, kur sytë i ka të mbyllur ecën, kurse këmbët e tij nuk lëvizin? Si i përjeton gjërat, si e sheh vetën duke fluturuar nëpër hapësirën qiellore, ndonjëherë duke qeshur, ndonjëherë duke qarë? Me një fjalë, njeriu duke fjetur u nënshtrohet ligjeve të Allahut xh.sh. i cili i vendosi dhe i përsosi me mrekulli të veçantë për mirëqenien e njeriut, kurse shkenca dhe dituria njerëzore nuk arrin t'i kuptojë. Shkenca supozon se koha e angazhimit të trurit të njeriut në ëndërr zgjatë afër një orë apo edhe më shumë. Këtë transferim nga ligji në ligj e përjeton secili prej nesh.
Allahu i Madhërishëm, si gjest mëshire për robt e Tij, deshi t'u tregojë se kur ata flenë Ai i transferon në botën e vdekjes. Pra ne ia dorëzojmë Atij shpirtin tonë, kurse pas zgjuarjes nga gjumi na kthen përsëri shpirtin në jetë, kurse atyre që dëshiron ua ndalë e nuk ua kthen, siç dëshmon verseti kuranor: "Allahu i merr shpirtrat kur është momenti i vdekjes së tyre (i vdekjes së trupave të tyre), e edhe atë që është në gjumë e nuk ka vdekur, e atij që i është caktuar vdekja e mban (nuk e kthen), e atë tjetrin (që nuk i është caktuar vdekja, por është në gjumë), e lëshon (të kthehet) deri në një afat të caktuar. Vërtet, në këto ka argumente për një popull që mendon". (Ez Zumer, 42).
Pra, transferimi i të gjithë neve, siç thamë më lart, nga një ligj në ligjin tjetër natyror bëhet çdo natë, pa e diktuar fare me ndjenja tona, që pastaj prapë me fuqinë absolute të Allahut xh.sh. të kthehemi në ligjin e parë, të cilit i nënshtrohemi kur jemi të zgjuar. Pra, çdo qenie njerëzore i nënshtrohet ligjit të gjumit, përveç Allahut xh.sh. i cili në Kur'an thotë: "..Atë nuk e kapë as kotje as gjumë,…" (El Bekare, 255)
Nga kjo shihet qartë se gjatë gjumit në vetë qenien e njeriut ndikojnë shumë faktorë, të cilët i njohim fare pak, kryhen shumë veprime dhe procese të ndërlikuara biokimike, zbatohen shumë ligje e rregulla me ç'rast njeriu transferohet gjatë shtegtimit të tij jetësor.
Intelekti i njeriut është i kufizuar dhe nuk mund t'i tejkalojë mundësitë dhe kompetencat e veta, nuk mund të arrijë t'i njoh ato gjëra të cilat Allahu xh.sh. i la të fshehta me qëllim të caktuar.
...
Ëndrrat dhe përshkrimin e tyre të bukur e hasim në kaptinën Jusuf, siç thotë verseti i Kur'anit: "(përkujto), Kur Jusufi, babait të vet i tha: "O babai im, unë pashë (në ëndërr) njëmbëdhjetë yje dhe diellin e hënën, i pashë duke

më bërë mua sexhde!"(Jusuf, 4).
Jakubi a.s. ia tërheqi vërejtjen të birit të mos iu tregojë vëllezërve çka kishte parë ëndërr, sepse nga zilia mund ta dëmtonin Jusufin a.s. siç bën aluzion verseti i Kur'anit fisnik: "Ai (Jakubi) tha: "O biri im, mos u trego ëndrrën tënde vëllezërve tu, se po të bëjnë ndonjë dredhi, s'ka dyshim, djalli për njeriun është armik i hapët".(Jusuf, 5)

...

Kur'ani fisnik na tregon me përshkrime të bukura ëndrrën e Ibrahimit a.s. i cili nuk kurseu asgjë për të përmbushur premtimin që ia kishte dhënë Allahut të madhërishëm. Për këtë qëllim ai deshi të flijonte edhe të birin, djalin e vetëm që e kishte, vetëm për t'i qëndruar besnik Allahut xh.sh.
Lidhur me këtë, ja si thotë verseti i Kur'anit në vijim: "Dhe kur arriti ai (djali) që së bashku me të (me Ibrahimin) të angazhohet në punë, ai (Ibrahimi) tha: "O djali im, unë kam parë (jam urdhëruar) në ëndërr të të pres ty. Shiko pra, çka mendon ti?" Ai tha: "O babai im, punoje atë që urdhërohesh, e ti do të më gjesh mua, nëse do All-llahu, prej të durueshmëve!"(Es Saffat, 102).
Ky ishte realizimi i ëndrrës, ishte sakrifica më e lartë njerëzore, ishte sprova më e qartë, të cilën Allahu i madhërishëm e bëri shembull të besnikërisë dhe devotshmërisë për gjeneratat e ardhshme: "Ne e thirrëm atë: "O Ibrahim!" Ti tashmë e zbatove ëndrrën! Ne kështu i shpërblejmë të mirët!". (Es Saffat, 104 – 105).

Ndarja e ëndrrave të vërteta

Ëndrrat e vërteta ndahen në pesë grupe:
1. ***ëndrrat e vërteta të pejgambereve***, siç kemi theksuar më lart;
2. ***ëndrra e mirë***, e cila është gëzim dhe dhuratë nga Allahu i madhërishëm, sikurse thotë Muhammedi s.a.v.s.: "Më së miri që ndonjëri prej jush mund të ëndërrojë është ëndërrimi i Allahut, i të dërguarve të Allahut dhe i prindërve të vet besimtarë";
3. ***ëndrra, të cilën ta tregon meleku Siddikun***, e mësuar nga Levhi Mahfudhi (kozmokompjuteri) Hyjnor;
4. ***ëndrra e quajtur mermezeh***, d.m.th. ëndërr që bën aluzion në diçka. P.sh. kur njeriu sheh ëndërr melekun që thotë: "Bashkëshortja jote dëshirojë të të helmojë me dorën e filan mikut". Me këtë shpirti i melekut bën aluzion se miku i tij është duke bërë prostitucion me bashkëshorten e tij;
5. ***ëndrra, të cilën duhet shpjeguar***. P.sh. nëse dikush ëndërron duke i rënë ndonjë vegle muzikore në xhami ai do të pendohet dhe do t'i kërkojë falje Allahut të madhërishëm dhe do të heq dorë nga veprat e këqija, nga gjërat e shëmtuara dhe do të përmendet për të mirë. Apo, ai që sheh ëndërr duke lexuar Kur'an në banjo do të shquhet si njeri i prishur.

...

Shpjeguesit e ëndrrave kanë bërë një art special dhe një disiplinë të veçantë, për të cilën nevojitet njohuri, kuptime dhe meditime, e cila kërkon studimin e personit dhe rrethanat në të cilën jeton personi i cili ka ëndërruar, njohja e traditave, mentalitetit dhe zakoneve të popullit të cilit ai i takon.
Shpjeguesi i ëndrrës nuk mund të kufizohet në përkthimin e simbolit të caktuar me shpjegim përkatës ashtu siç bëjnë njerëzit e rëndomtë kur konsultojnë librat e shpjegimit të ëndrrave, por duhet bërë një operim të tërë, duke vendosur ëndrrën në kontekstin e tij të plotë dhe në kornizën e gjallë të tij.
Gjatë historisë së islamit, përveç shpjegimeve të ëndrrave të cilat i kanë bërë dijetarët islam, kanë ekzistuar edhe njerëz të rëndomtë të cilët me sukses kanë depërtuar në ndërdijen e njerëzve duke zbuluar fshehtësitë e tyre me shpjegimin e ëndrrave.
Njëri prej shpjeguesve më të njohur të ëndrrave ka qenë Ibn Sirini. Ai analizën e psikes njerëzore përmes ëndrrave e ka filluar para 13 shekujve.
Pas tij u paraqit imami i madh Abdul Gani en Nabulusiu, i cili me ndihmën e diturisë, të cilën ia dhuroi Allahu i madhërishëm, kësaj dicipline i dha një frymë shkëlqyese dhe bukuri të madhe.

"Ëndrra e vërtetë e besimtarit është një e dyzet e gjashta pjesë e profetësisë"...

Para se të flasim mbi shpjegimin e ëndrrave në islam në bazë të psikoanalizës, duhet të përqendrohemi në dy aspekte të kësaj çështje:
a) **lidhshmëria e gjumit dhe ndjenjave:**
Ndjenjat fetare dhe kulturore të pjesëtarëve të secilit popull dallojnë nga ndjenjat e popujve tjerë. P.sh. është dallimi tejet i madh në mes ndjenjave të një myslimani të edukuar në frymën islame dhe një japani budist... Personi i cili shpjegon ëndrrën mund ta kryej detyrën e tij me sukses vetëm nëse i njeh mirë ndjenjat fetare, kulturore dhe nacionale të personit i cili ëndërron. Për këtë shpjeguesit mysliman të ëndrrave bazohen së pari në versetet kuranore dhe hadithet e Pejgamberit s.a.v.s. me të cilët edhe bazohet gjendja emocionale e një myslimani.
b) **simbolet dhe aluzionet në gjumë:**
Për shkak të refleksit të papërshtatshëm në shoqëri si dhe normave moraloetike të përgjithshme, ndërdija nuk lejon që përmbajtja e saj të manifestohet në gjumë në formën e saj reale. Për këtë mendimet e fshehura paraqiten në forma të ndryshme, në forma të simboleve dhe aluzioneve. Shpjeguesi i ëndrrës duhet të jetë veçanërisht i ndjeshëm dhe i aftë që nga elementet e paraqitura të ëndrrës përplot simbole dhe aluzione, të jetë i suksesshëm të zbuloi të vërtetën e cila fshihet pas tyre duke i dhënë kuptim të vërtetë dhe të plotë shpjegimit të ëndrrës.
Nëse forma e brendshme kthehet dhe paraqitet në formën e dukshme, ne këtë e quajmë ëndërr, ndërsa në rastin e kundërt, kur imazhi i dukshëm ndryshon dhe kalon në formën e brendshme të fshehët këtë ne e quajmë analizë.
Aspekti jo materialistik dhe inspirimi shpirtëror në disa ëndrra janë aq të rëndësishëm, andaj Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: "Ëndrra e vërtetë e besimtarit është një e dyzet e gjashta pjesë e profetësisë". (Ahmedi, Tirmidhiu).
Mendojmë se për fenomenin e gjumit dhe të ëndrrave duhet të shkruhet edhe më tepër nga aspekti islam, sepse është mëkat për besimtarët që për shpjegimin e ëndrrave të kërkojnë përgjigje në komentet e mistifikuara dhe jo reale.
Në fund mund të konkludojmë se gjumi, si fenomen tejet interesant shkencor, duhet kuptuar si mrekulli dhe mëshirë të Allahut të madhërishëm, si pushim të organizmit, e veçanërisht si pushim të sistemit nervor, në mënyrë që të nesërmen të jemi të gatshëm për kreativitet të begatshëm, duke përfituar nga dhuntitë e shumta të Gjithëkrijuesit, por njëherit duke e falënderuar vazhdimisht, siç na mëson verseti i Kur'anit në vijim: "Po mëshira e Tij u bëri juve natën dhe ditën për të pushuar në të dhe për të përfituar nga begatitë e Tij, prandaj, të jini mirënjohës!."(Kasas, 73)

Homoseksualizmi - çrregullim hormonal apo psikik?

Marrëdhëniet seksuale të personave të gjinisë së njëjtë, sipas sociologëve, bartin sëmundjen e AIDS-it. Ata thonë se marrëdhëniet e tilla e pengojnë rritjen dhe zhvillimin e shoqërisë. Kurse, sipas psikologëve, marrëdhëniet e tilla konsiderohen më tepër tërheqje seksuale sesa një çrregullim psikik. Feja Islame e parandalon një dukuri të tillë duke e cilësuar si mëkatin më të madh që mund të bëjë njeriu në jetë



Florentina LATA

Xheloz kur e tradhton partneri, i dashuruar maksimalisht në të, kur bashkohen ndjen një emocion të fuqishëm përjetues, detyrohet t'i qëndrojë besnik lidhjes me të, dhe punët e shtëpisë i bëjnë në mënyrë spontane dhe të përbashkëta.

Kjo është mënyra e jetës dhe e dashurisë së homoseksualit A. N. (35) nga Prishtina. Ai thotë se ndjenjat e tij homoseksuale i ka vërejtur që në moshën shtatëvjeçare. Sipas tij, aktin e parë seksual me një person të gjinisë së njëjtë e ka përjetuar në moshën 25-vjeçare.

"Qysh në fëmijëri më kanë tërhequr disa gjëra më ndryshe prej moshatarëve të mi. Por asnjëherë nuk më është dhënë mundësia me e provu deri në moshën 25-vjeçare. Sepse komunikimi me një person të gjinisë së njëjtë në atëkohë ka qenë vështirë, prandaj është dashur një kohë më e gjatë për ta gjetur personin e duhur. Dhe në fund e kam gjetur".

Ai tregon edhe kohën kur kishte qenë në lidhjeje me një femër, ndaj së cilës nuk kishte ndjerë kurrë asnjë grimë dashurie, prandaj për mos ta lënduar, A. N. kishte vendosur që të ndahej prej saj. Ai rrëfen kohën e tij të adoleshencës dhe mundësinë për t'u futur në lidhjeje me një femër, por ai thjesht e kishte ndjerë veten pjesë të homoseksualizmit dhe nuk kishte mundur të krijonte marrëdhënie me të.

Sipas tij, dashuria e vërtetë kur ai e ndien është marrëdhëniet në mes të dy personave të gjinisë së njëjtë.

"Marrëdhëniet e dy sekseve të njëjta, munden me u bë në formë shtazarake, por unë konsideroj se vetëm atëherë më krijohet ndjenja dhe dashuria që mund të ndjejë ndonjëherë".

A. N. bashkëjeton që tetë vjet me partnerin e tij në Prishtinë. Sa i përket roleve në bashkëjetesën e tyre, ai thotë se ato janë rotative, që në bazë të spontanitetit dhe dëshirës ndryshohet edhe roli i tyre. Ai nuk mërzitet nëse e di familja e vet apo fqinjët e tij për përkatësinë e tij seksuale. "Familjen e vizitoj shpesh, por nuk jetoj me ta që nga mosha e re. Ndoshta e di për mua që jam homo, mirëpo nuk e kemi diskutuar këtë asnjëherë me anëtarët e familjes. As fqinjët e mi në banesë nuk më thonë kurrë kurrgjë, besoj se kam raporte të mira me ta".

Sabri Kiçmari (sociolog): Homoseksualizmi e pengon rritjen dhe zhvillimin e shoqërisë

Sociologu Sabri Kiçmari, thotë se një pjesë e madhe e botës tregon tolerancë me të ndjeshme duke e kuptuar homoseksualizmin si çrregullim hormonal të natyrshëm dhe prezent gjatë gjithë historisë së njerëzimit. Sipas tij, një prej problemeve që shtrohete aktualisht në kuadër të diskutimeve për homoseksualizmin është fakti se të dhënat shkencore dëshmojnë se sëmundja e AIDS-it si burim të saj ka kontaktin seksual në mes të personave të së njëjtës gjini.

Kiçmari mendon se homoseksualizmi e pengon në masë të madhe rritjen dhe zhvillimin e shoqërisë. "Personat që hyjnë në kuadrin e veprimeve ose ndjenjave, në homoseksualizëm ka diçka të lindur. Është një çrregullim hormonal, supozohet se një gjë e tillë ndodh gjatë shtatzënisë, kur nëna ka stres të theksuar ndodh një çrregullim hormonal i cili bartet te fëmija. Kjo është vetëm një teori, sepse ka raste kur një person nuk i njeh ndjenjat e tij homoseksuale. Dhe në rastin kur ai kontakton me një person të gjinisë së tij, ai i shpreh ndjenjat dhe komunikon lirshëm me të".

Shpresa Berisha (psikologe): Psikologjia nuk e jep një definim strikt në lidhje me homoseksualitetin

Psikologja Shpresa Berisha, homoseksualizmin e konsideron si një tërheqjeje seksuale në mes personave të gjinisë së njëjtë, sesa një çrregullim psikik.

Sipas saj, psikologjia nuk e jep një definim strikt në lidhje me homoseksualitetin e cila nuk është sëmundjeje, por, sipas saj, më shumë konsiderohet si një tërheqjeje seksuale në mes të gjinisë së njëjtë.

"Kjo nuk mund të zhvillohet vetëm në një moshë, por edhe moshat më të rritura mund të kalojnë nëse një person deri tash u afektu prej një femër tash mund të afektohet prej një mashkulli". Sipas Berishës, janë faktorët socialë dhe psikikë të cilët ndikojnë në personalitetin e njeriut, që një person të jetë homo.

Shefqet Krasniqi (teolog): Homoseksualiteti është njëri prej mëkateve më të mëdha

Shefqet Krasniqi, njohës dhe studiues i fesë Islame, thotë se homoseksualiteti në islam është njëri prej mëkateve më të mëdha që mund të bëjë njeriu në jetë. Sipas tij, njerëzit të cilët bëjnë marrëdhënie me gjininë e njëjtë janë të dënuar nga krijuesi i tyre (Allahu).

"Për herë të parë homoseksualizmi është paraqitur në kohën e luftës te një popull, i cili ka jetuar në Palestinën e sotme, diku para katër mijë vjetësh. Allahu kishte dërguar një pejgamber për t'u treguar se një vepër e tillë pasohet me dënime të mëdha dhe të pafalshme. Ata porosinë që ua kishte sjell ky Pejgamber, nuk e kishin dëgjuar, dhe Zoti, atë vend pastaj e kishte shndërruar në ujë të tërësishëm", ka thënë Krasniqi.

Sipas tij, dënimi i veprave të tilla është tepër i madh, ngaqë, siç ka thënë ai, Allahu prandaj ka krijuar dy gjini (femër-mashkull) për t'ia mundësuar njerëzimit shfryrjen e epsheve në mënyrë të ligjshme.

Ai thotë se ata njerëz që e hidhërojnë Allahun kurrë nuk do të mund të jenë të lumtur, sepse Zoti do t'i bëjë ata, një shtresë të ultë, të nënçmuar dhe të poshtër.

KARIESI

Artan BEJTA & Iliriana ALLOQI

Njëra ndër patologjitë e shpeshta të stomatologjisë bashkëkohore padyshim është kariesi, i cili paraqet procesin patologjik që karakterizohet me prishjen e pjesërishme ose të tërësishme të strukturës anatomike të dhëmbëve. Zakonisht prek indet e forta të dhëmbit dhe nëse nuk mjekohet me kohë, në stadet përfundimtare prek edhe pulpën (brendësinë) e dhëmbit.

Hapësira e gojës dhe sëmundjet e saj

Në hapësirën e gojës janë të pranishme një numër bakteresh specifike të cilat në kushte normale janë të pranishme në hapësirën e gojës tonë, por në momentin e prishjes së integritetit të mukozës së hapësirës së gojës mund të shkaktojnë infeksione të ndryshme. Kësaj i kontribuon padyshim edhe imuniteti (forcat mbrojtëse) i organizmit pasi që bakteret provokojnë një përgjigje të imunitetit (reagim mbrojtës dhe stimulim irritues) të organizmit në të cilin përhapen dhe në të shumtën e herëve kjo përgjigje është shkaktare e shkatërrimit të integritetit të mukozës së gojës, duke shkaktuar infeksione të ndryshme të gojës, mishit të dhëmbëve dhe shumë shpesh (ky stimulim irritues) prek edhe sipërfaqen e dhëmbit duke shkaktuar karies.

Çfarë është kariesi dhe kush e shkakton atë?

Kariesi me një fjalë përbën një proces shkatërrues për dhëmbin, shkaktarë të cilit janë bakteret e pranishme në sipërfaqen e dhëmbëve. Edhe pse numri i baktereve në hapësirën e gojës thamë që është i madh, bakteret që janë "fajtore" për paraqitjen e kariesit janë me numër të kufizuar dhe atë më së tepërmi streptokoku mutans lactobacili dhe actinomiceti. Mekanizmi i veprimit mbi dhëmbin nga këto baktere është ky: në dhëmb zakonisht kemi të pranishme bakteret, në qoftë se dhëmbët nuk pastrohen pas ngrënies së ushqimit atëherë në dhëmb kemi mjaft sheqerna që ne i kemi marrë me ushqim dhe pikërisht sheqernat janë ato që i japin baktereve forcën për ta filluar shpërbërjen e mineraleve të dhëmbit dhe në këtë mënyrë ato prishin integritetin e tij dhe jo rrallë duke arritur edhe deri në thellësi të tij.
Mosmbajtja e higjienës së gojës jo vetëm që është origjina e kariesit të dhëmbëve, por edhe i infeksioneve të ndryshme të gojës, posaçërisht mishrave të dhëmbëve.



Personat më të rrezikuar nga kariesi

Personat më tepër të rrezikuar nga kariesi janë ata që konsumojnë më tepër ushqim të ëmbël dhe zakonisht nuk i pastrojnë dhëmbët pas ngrënies së këtij ushqimi. Po ashtu të rrezikuara nga kariesi janë edhe gratë shtatzëna ngaqë gjatë shtatzënisë nevoja për marrjen e mineraleve dhe vitaminave është më e madhe ndërsa në shumicën e rasteve kjo nuk ndodh.

Shenjat klinike të kariesit

Pasi kariesi ka depërtuar dhe fillon të përhapet, në zonën e dhëmbit fillon të shfaqet dhimbja në formën e mpirjes dhe zakonisht kur konsumojmë ushqime me sheqer ose ushqime të nxehta ose të ftohta. Kurse në qoftë se kariesi ka depërtuar në pulpën (brendësinë) e dhëmbit, atëherë dhembjet janë të forta dhe të padurueshme sidomos gjatë natës dhe kur jemi shtrirë (për shkak të shtypjes së gjakut). Në këto raste dhëmbi është i infektuar dhe ekziston rreziku që infeksioni të përhapet edhe në pjesë të tjera të gojës.

Parandalimi


Pastërtia e dhëmbëve, ushqimi i pasur me minerale dhe vitamina janë baza të parandalimit të kariesit në veçanti dhe e të gjitha sëmundjeve të gojës (dhëmbëve dhe mishrave të tyre) në përgjithësi.

Si të bëhet pastrimi i dhëmbëve?

Gjatë pastrimit të dhëmbëve duhet të kemi kujdes që dhëmbët të pastrohen mirë jashtë, brenda, pas dhe në hapësirat midis tyre, pasi që pllakëza bakteriale (bakteret) mund të fillojnë të shkaktojnë karies në çdo pjesë të dhëmbit.
Është e këshillueshme që dhëmbët të fërkohen gjatë pastrimit në drejtimin vertikal duke filluar nga mishi i dhëmbëve kah dhëmbi dhe në këtë mënyrë si sipërfaqja e brendshme e tij, ashtu edhe ajo e jashtme pastrohen me një lëvizje gjysmërrotulluese (në këndin 45º) me drejtim nga jashtë. Duhet ta dini se lëvizja e furçës në drejtim horizontal nuk bën pastrim të plotë të dhëmbëve tuaj. Është shumë e rëndësishme që të bëhet pastrimi i dhëmbëve pas çdo shujte (racioni) e gjithsesi një herë para se të bimë në gjumë (natën), pasi që koha e veprimit të baktereve është më e gjatë.

Pasta e dhëmbëve

Pasta e dhëmbëve lehtëson lëvizjen dhe shkapërderdhjen e pllakëzave bakteriale dhe zakonisht në përmbajtjen e tyre përmbajnë, përveç elementeve freskuese edhe ato kurative (shëruese) ku bëjnë pjesë mineralet e ndryshme, si: kalciumi, fluori etj. Në qoftë se gjatë pastrimit të dhëmbëve kemi një gjakderdhje të lehtë, atëherë bëhet fjalë për krijimin e pllakëzave bakteriale në mishin e dhëmbëve dhe preferohet të shkohet te mjeku i dhëmbëve (stomatologu).




Ndikimi i ushqimit në shfaqjen e kariesit

Studiuesit kanë vërejtur se ka një lidhjeje në mes të konsumimit të karbohidrateve (sheqernave) dhe kariesit pasi karbohidratet janë ato që formojnë substratin fermentues për bakteret e kariesit. Mirëpo ky element negativ i karbohidrateve mund të ndryshohet nga prania e elementeve të tjera ushqyese si kalciumi, fosfori dhe fluori si elemente kyçe që luajnë rol në mbrojtjen e dhëmbit. Po ashtu rol negativ në paraqitjen e kariesit ka edhe marrja e ushqimeve me aciditet të lartë (pijet e gazuara).

Ushqimet që ndikojnë në mbrojtjen e dhëmbëve

Nga studiues të shumtë janë përmendur se ndër ushqimet që mbrojnë dhëmbët nga kariesi janë: arra dhe drithërat (duke ekuilibruar pH e pështymës dhe duke forcuar kalciumin e dhëmbëve), përdorimi i mjaltit në vend të sheqerit (pasi përmban vitamina dhe kripëra minerale të çmuara për shëndetin e gojës dhe të dhëmbëve), perimet dhe frutat e ndryshëm (detergjent mbi sipërfaqen e dhëmbëve); qumështi dhe kosi (burim i kalciumit dhe fosfori dhe shumë kripërave minerale përbërëse të dhëmbëve); vaji i ullirit (është i pasur me vitaminën E që ka një rol mbrojtës për mukozën e gojës dhe pengon zhvillimin e baktereve përgjegjës për shkaktimin e kariesit).



Këshillë për fund

Pasi që goja paraqet portën hyrëse të shumë baktereve, padyshim për të pasur një shëndet të mirë në gjithë organizmin, parakusht për këtë është higjiena orale (e gojës) pasi nga kjo mund të rrjedhin shumë sëmundjeje të tjera të organizmit në përgjithësi. Andaj mbajtja e një higjiene të mirë jo që parandalon kariesin, por edhe shumë sëmundje të tjera që vijnë si komplikim i tij.
Pastaj dhëmbët në njëfarë mënyre janë kartëvizita jonë dhe kanë shumë rëndësi, jo vetëm sepse tregojmë konsiderate për veten, por ndihmojmë edhe në krijimin e marrëdhënieve me të tjerët.

Fjalëkryqi

Autor: BENI	PASIONI PËR T'U VËNË ZJARRIN OBJEKTEVE	SHKRIMTARI SHKRELI (shq.)	AKTORJA AMERIKANE PORTMAN		FUTBOLLISTI I ARSENALIT ..... VAN PERSIE / QYTET NË FRANCË		LLOJ MINERALI / MARK ANTONI	ANTALYA		GAZ ME NGJYRË TË DOBËT DHE HELMUES	TAKINARDI (shk.)	MJET PUNE	SHUHEM / PËREMËR VETOR			BASHKËTINGËLLORE	DIKTATORI ITALIAN MUSOLINI
PEISAZHI NË NATYRË									SHTETE (huaj) / PERIUDHA, ETAPA						SHKRONJA TË NJËJTA / IRLANDA		
AKTORJA E FAMSHME ITALIANE ROSELINI								DIKTATOR RUS / EDEN SOLSTROM								ZANORE / AKTORI EGJIPTAS SHARIF	
PJESË E SYRIT							E MORALSHME / KËNGËTARJA JONË PIREVA						GRUPI MUZIKOR .... MAIDEN / ESTONIA, BELGJIKA				
SHTET AZIATIK / SHKRIMTARI ZOLA					NËNSHTRIM I PLOTË / KOD I TELEFONIT MOBIL										NOTË MUZIKORE / VRANËSIRË		
				PUBLIC EDUCATION DEPARTMENT / AKTORJA AMERIKANE .... FLYNN BOYLE				"DETROIT" / KËNGËTARJA FRANCEZE NË FOTO 1 PARADIS			... CAK	QYTET NË SHQIPËRI / SONDAZHI					
ANKONA		AKTORE E JONA / "L" pas dy "M"											AKTORJA AMERIKANE RENA				
SHKRONJA FQINJE			KËNGËTARJA SHQIPTARE MIMANI / EDUARD BONDER						"N" pas dy "I" / FUTBOLLISTI I BARCELONËS ERIK								
EMËR YNI MASHKULLI					KËNGËTARJA SHQIPTARE SHKODRA / ASCOLI					KUVENDI I KOSOVËS / KRYEHOXHA							
FUTBOLLISTI YNË DRAGUSHA						GAZETARI BEHLULI / LLOJ ZARZAVATEJE					ZANORE / AKTORJA E VJETËR SUEDEZE MARGRET						
2					KROSIMET E TOPIT NË FUTBOLL												
					ANDORA		QYTET I MADH NË TURQI / ARKEOLOGU YNË SKENDER										
					TONI ADAMS			ARTANA, MITROVICA / VIETNAMEZET E VJETRA			SHTET I MADH NË AFRIKË	VARG MALE NË ZVICËR (sh.shq.)					
					METODË STUDIMI								FOLTORET	LLOJ VETURE	METAL ME SHKËLQIM ARGJENDI	INDONEZIA	NË ÇFARË VENDI
					ARTAN (perkdh.)				NANTES	QYTET NË VERI TË KOSOVËS / CEJLONI, ENDOKIA							
					ÇLIRIMI NGA VARËSIA											URUGUAI QË MBËSHTETET NË TEORITË E UTOPIZMIT	
	KËNGËTARJA AMERIKANE NË FOTO 2		LLOJ ZOGU / FUTBOLLISTI ITALIAN ODDO (Milan)	INTERNATION. AIR TRANSPORT ASSOCIATION	PIKA MË E LARTË NË KUPËN E QIELLIT	AUSTRIA, MALTA / ZANORE			LUM NË KOSOVË / BASKETBOLLISTI YNË MEHMETI								SHTAZOR
ISH PRESIDENT I SHQIPËRISË										AKTORJA E VJETËR SLLOVENE RINA / EUROPIAN UNION				GUERILJA BASKE / ZAKONI			
PASURI E PATUNDSHME QË SJELLË TË ARDHURA (sh.pashq.)						INTENSITET, TON, RENIUM / INDIANA					TAJLANDA, BOLIVIA	TRISKË, KUPON / ALPHA OMEGA PUBLICATION					
PATRIOTI PRISHTINA (shq.)							E FRIKËSOVA / NËNË (turq.)						AKTORI I FAMSHËM XHONI (shq.) / DAMBARA (shk.)				
ATDHETARI NGA DRENICA HAZIRAJ (shq.)						PËREMËR VETOR / OHIO, FLORIDA				POLITIKANI SHQIPTAR RIDVAN / MOR, HEJ					INVA MULA / ILAZ KODRA		
NEONI, METRI / RADIATOR				TONELATË / RABATI				JO (ang.) / RUANDA			MBATHËSE SPORTIVE / SHKRONJA E 24-të						
									SHKRONJA TË NJËJTA			FUTBOLLISTI SPANJOLL SALGADO					



1